



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED PREMIJERA
AGJENSIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA / AGENCY FOR GENDER EQUALITY

PARANDALIMI I STEREOTIPEVE GJINORË DHE PROMOVIMI I BARAZISË GJINORE NË TEKSTET DHE MATERIALET SHKOLLORE

UDHËZUES METODOLOGJIK



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED PREMIJERA
AGJENSIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA / AGENCY FOR GENDER EQUALITY

PARANDALIMI I STEREOTIPEVE GJINORË DHE PROMOVIMI I BARAZISË GJINORE NË TEKSTET DHE MATERIALET SHKOLLORE

UDHËZUES METODOLOGJIK

Ky manual është hartuar në mbështetje të nismës së Agjensisë për Barazi Gjinore dhe në zbatim të Projektit “Forcimi institucional i Agjencisë për Barazi Gjinore dhe mekanizmave gjinore në Kosovë” financuar nga Qeveria Suedeze, Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar – Sida dhe zbatuar nga konsorcium: Niras & CPM International



NIRAS

CPMI
CORPORATE & PUBLIC MANAGEMENT INTERNATIONAL

LISTA E SHKURTESAVE

KEGjFDG..... Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave

KDF Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës

ApGJ Arsimi për të Gjithë

KKK Korniza Kurrikulare e Kosovës

QAK Qendra për Arsim e Kosovës

QKSGJ Qendra Kosovare për Studime Gjinore

MASHT Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

OZHM Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit

OJQ Organizatë Joqeveritare

OZHQ Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm

OKB Organizata e Kombeve të Bashkuara

OKBEShK... Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë

Tabela e Përmbajtjes

HYRJE	3
KAPITULLI I	5
TEKSTET SHKOLLORE DHE BARAZIA GJINORE	5
i. Tekstet shkollore - mjet për arritjen e arsimit cilësor	5
ii. Tekstet shkollore - ndihmë e jashtëzakonshme për mësimdhënien dhe mjet efikas në arsim	6
iii. Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut në tekstet shkollore si dhe barazia gjinore	10
iv. Tekstet shkollore - si instrumente të ndryshimit dhe transformimit shoqëror	11
v. Arsimi dhe barazia gjinore	13
KAPITULLI II	18
PËRFAQËSIMI GJINOR NË TEKSTET SHKOLLORE	18
i. Konceptet e gjinisë dhe seksit	18
ii. Qasjet metodologjike në analizimin e sistemit gjinor në tekstet shkollore	21
iii. Zhvillimi i sistemit egalitar gjinor në tekste shkollore	24
KAPITULLI III	27
MJETET PËR RISHIKIMIN GJINOR TË TEKSTEVE SHKOLLORE	27
I. RISHIKIMI I PËRMBAJTJES	27
i. Përfaqësimi gjinor – shpërndarja e individëve	27
ii. Përfaqësimi gjinor – shpërndarja e grupit	29
iii. Përfaqësimi gjinor – Citimi	30
iv. Shqyrtimi i fragmentit të tekstit – titujt, pjesa kryesore e tekstit, ushtrimet dhe shembujt	32
v. Shqyrtimi i aktivitetit dhe ndërveprimit	34
vi. Shqyrtimi i gjuhës	35
vii. Termat mashkullor për përshkrimet e përgjithshme	36
viii. Përdorimi i mbiemrave për profesionet/vendet e punës me gjini të përcaktuar	38
ix. Mbiemrat për tiparet personale	40
x. Barabarësia në përshkrime - Paralelizmi	43
xi. Dialogët	44
II. ILUSTRIMET	46
i. Shpërndarja gjinore në ilustrime	46
ii. Përfaqësimi gjinor i fëmijëve në lojëra dhe aktivitete	48
iii. Prezantimi i gjinisë në sferën publike (profesionet)	53
III. PËRMBLEDHJA PËRFUNDIMTARE DHE REKOMANDIMET	57
SHTOJCA 1 - KONCEPTET KRYESORE GJINORE	59
SHTOJCA 2 – PËRMBLEDHJE E LIGJEVE DHE POLITIKAVE TË KOSOVËS MBI GJININË	63
SHTOJCA 3 - NDRYSHIMET NË SISTEMIN E ARSIMIT ME POLITIKËN E RE TË KURRIKULËS	65
SHTOJCA 4 – LËNDËT DHE FUSHAT E TË NXËNIT TË KURRIKULËS SIPAS KLASËVE	66

Të nderuar/a,

Hartimi i teksteve shkollore me perspektivë gjinore është një nga obligimet e dala nga Ligji për Barazi Gjinore 0L/20, respektivisht Neni 21, i cili kërkon hartimin e teksteve shkollore, rishikimin e tyre nga perspektiva gjinore, si dhe eliminimin e stereotipeve gjinore në tekstet shkollore ekzistuese.

Jemi dëshmitarë të një realiteti të ri ku procesi i të nxënës bënhet çdo herë e më sfidues për nga prezenca dhe konkurrenca e pajisjeve të teknologjisë informative karshi teksteve shkollore të shtypura. Dhe kjo garës po bëhet çdo herë e më sfiduese, për të siguruar tekste shkollore cilësore, me vlera, parime, koncepte koncize mbi të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe qytetarinë në përgjithësi, duke synuar për të paraqitur në mënyrë harmonike përmbajtjen ideore, didaktike, të përcjellë me imazhe artistike vizuale, që përçojnë vlera me të cilat po edukojmë brezat e ri - vajzat dhe djemtë, e ardhmja e vendit tonë.

Prezantimi i koncepteve gjinore në tekste shkollore ndikon në krijimin e perceptimeve dhe qëndrimeve të fëmijëve mbi gjininë dhe rolet gjinore, të cilat do t'i mbartin gjatë gjithë jetës, dhe nëse ato nuk sqarohen në frymën e parimeve të barabarësisë atëherë humbim një nga mundësitë për të krijuar modele dhe role sociale që i mundësojnë individëve, vajzave dhe djemve në harmoni me vetveten, dhe të mos përfundojnë në role të stereotipizuara gjinore.

Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë vlerësoi se në procesin e rishikimit të teksteve shkollore, e iniciuar nga kjo e fundit, integrimi i perspektivës gjinore ishte më se i domosdoshëm. Prandaj, ndërmorëm iniciativën e hartimit të Manualit për përfshirjen e perspektivës gjinore në tekste shkollore. Ky manual synon të ofroj udhëzime konkrete për tekst-shkruesit, recezentet, dhe vetë arsimtarët/ët se si ta integrojnë perspektivën gjinore, të sfidojnë marrëdhëniet gjinore të mbingarkuara me role të stereotipizuara gjinore, që mbajnë vajzat larg proceseve zhvillimore, vendimmarrjes, zhvillimit të plotë intelektual dhe profesional, dhe eliminimin e pasojave që pabarazia gjinore ka në jetën e individëve dhe shoqërisë në tërësi.

Mbështetja e kësaj iniciative për hartimin e manualit, erdhi nga projekti për "Fuqizimin e Agjencisë për Barazi Gjinore dhe mekanizmave institucional për barazi gjinore" i financuar nga Sida, e realizuar përmes projektit - konsorciumit NIRAS-CPM International.

Me këtë rast falënderoj Sida'n për financimin e realizmit të manualit.

Uroj që ky manual të gjej zbatim dhe të jetë i dobiprurës për të gjithë ato/ata autore/ë, mësimdhënëse/ës që synojnë të përçojnë frymën e barazisë gjinore në procesin e të nxënës si një nga parakushtet e demokracisë dhe prosperitetit të vendit.

Faleminderit,

Edi Gusia



Kryeshefe Ekzekutive – Agjencia për Barazi Gjinore – Zyra e Kryeministrit

HYRJE

Studime të ndryshme tregojnë se normat, vlerat dhe besimet shoqërore në raport me gjininë, formëzojnë në një masë të madhe strukturën shoqërore dhe marrëdhëniet midis shoqërisë dhe individit ose grupeve. Ato shpesh ndikojnë në vendimet kryesore në jetën e individit, në vlerat, normat dhe rolin e tij apo saj. Shoqëritë i transmetojnë normat e tyre nëpërmjet institucioneve të ndryshme shoqërore, formale apo joformale. Shkollat janë një nga institucionet më të rëndësishme formale ku individët zakonisht shpenzojnë një sasi të konsiderueshme të jetës së tyre dhe janë një nga transmetuesit më me ndikim të normave dhe vlerave shoqërore.

Prandaj, është me rëndësi që edukuesit të sigurohet që stereotipat gjinorë në shoqëri të mos trashëgohen në mjediset arsimore dhe në komunitetin e tij. Paragjykimet gjinore duhet të sfidohen dhe barazia duhet të bëhet e njohur dhe të përforcohet në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies brenda shkollave dhe praktikave në klasë. Tekstet shkollore në veçanti, luajnë një rol të rëndësishëm për mësimdhënësit dhe nxënësit sepse ato përfaqësojnë një nga mjetet më të prekshme për shpërndarjen e përmbajtjes në mënyrë që të krijohet një kulturë e barazisë në procesin e mësimnxënies.

Në Kosovë, sistemi i arsimit ka kaluar përgjatë shumë sfidave dhe reformave për të sjellë ndryshime thelbësore në sistemin arsimor dhe për të përmirësuar cilësinë e tij. Procesi i ndërmarrë për reformën legjislative dhe zhvillimin e politikave ka bashkuar shumë aktorë për të siguruar që sistemi arsimor i Kosovës të ofrojë arsim cilësor për të gjithë. Në këtë proces, barazia gjinore njihet si një nga shqetësimet kryesore lidhur me të drejtat e njeriut, e cila kërkon vëmendje të veçantë nga profesionistët e arsimit dhe nga zhvilluesit e politikave. Për këtë arsye, nocioni i barazisë gjinore, si në legjislacionin aktual ashtu edhe në politika, ka marrë vendin që meriton.

Reforma e Kurrikulës së Re për arsimin parauniversitar, një nga politikat më gjithëpërfshirëse për zhvillimin e përmbajtjes dhe shpërndarjen e përmbajtjes, e ndërmarrë nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë e Kosovës, i konsideron konceptet e barazisë gjinore dhe të

përfshirjes si parime ndërsektoriale të kornizës së saj të politikave. Procesi i zbatimit kërkon që konceptet dhe praktikat e barazisë gjinore të depërtojnë më tej në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë dhe në lëndët e tyre përkatëse që mësohen në sistemin arsimor të Kosovës. Hartimi i teksteve të reja shkollore është një nga veprimet kryesore të ndërmarra për të sjellë një përmbajtje të re dhe moderne të kurrikulës në klasë.

Ky udhëzues që po prezantojmë, u pa si i domosdoshëm për zbatimin e plotë të kurrikulës së re nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT). Ai synon të jetë një mjet praktik, me një grup veprimesh sistematike, në ndihmë për shqyrtuesit e teksteve shkollore gjatë vlerësimit të drafteve të teksteve shkollore të paraqitura nga autorë të ndryshëm para publikimit të tyre.

Për më tepër, udhëzuesi i propozuar mund të jetë një burim i vlefshëm referimi dhe orientimi për autorët e teksteve shkollore para procesit të hartimit të teksteve shkollore. Ai synon të kontribuojë në eliminimin e stereotipave gjinorë në fazën fillestare të teksteve shkollore si dhe të sigurojë integrimin gjinor në tekstet shkollore dhe të kurrikulës shkollore. Ai pa dyshim do t'u shërbejë gjithë atyre që kërkojnë të promovojnë barazinë gjinore në sistemin dhe procesin edukativ, dhe përmes këtij sistemi e procesi arsimor të arrijnë progresin drejt një zbatimi gjithëpërfshirës të nismës së reformës arsimore.

Nga pikëpamja metodologjike, udhëzuesi shërben si një kornizë analitike që përdor instrumentet sasiore dhe ato cilësore për të zbuluar shprehjet delikate dhe ato më të dukshme të pabarazive gjinore dhe paragjytimeve në tekstet shkollore.

Udhëzuesi është zhvilluar në formatin si në vijim: pjesa e parë ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse mbi rëndësinë e teksteve shkollore si një mjet për ndryshimet shoqërore dhe barazinë gjinore. Më tej, ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të koncepteve të barazisë gjinore dhe të të drejtave të njeriut si dhe të rëndësisë së tyre në arsimin e përgjithshëm për të gjitha përmbajtjet dhe për qëllimin e arsimit cilësor të cilin synon ta arrijë reforma në arsim. Pjesa e dytë ofron një pasqyrë të koncepteve themelore gjinore dhe të rëndësisë së tyre në procesin e hartimit të teksteve shkollore, një vështrim

mbi metodologjinë e përdorur për hartimin e këtij udhëzuesi metodologjik dhe përshkruan parimet kryesore se si të arrihet përfaqësimi egalitar gjinor në tekstet shkollore. Së fundi, pjesa e tretë ofron mjete për vlerësimin e përfaqësimit gjinor në tekstet shkollore gjatë procesit të shqyrtimit dhe raportimin dhe vlerësimin përfundimtar mbi vlefshmërinë dhe cilësinë e tekstit shkollor.

KAPITULLI I

TEKSTET SHKOLLORE DHE BARAZIA GJINORE

i. Tekstet shkollore - mjet për arritjen e arsimit cilësor

Mësimnxënia është një nga komponentët themelorë të proceseve të arsimit. Në procesin e mësimnxënies, tekstet shkollore përfaqësojnë ndihmën më të pakrahasueshme të mësimdhënies si dhe instrumentin më me ndikim dhe më të spikatur në shpërndarjen e informacionit dhe në formimin e njohurive të nxënësit. Nga njëra anë, tekstet shkollore ndihmojnë në arritjen e objektivave të kurrikulës kombëtare dhe në lehtësimin e procesit të mësimdhënies dhe të

mësimnxënies. Nga ana tjetër, "tekstet shkollore dhe materialet mësimore e kanë aftësinë që të transmetojnë njohuri, të zhvillojnë aftësi dhe të formojnë mënyrën se si nxënësit bashkëveprojnë me botën. Tekstet shkollore dhe materialet mësimore përbëjnë një burim autoritativ informacioni, por gjithashtu funksionojnë si mjete parësore për formëzimin e qëndrimeve dhe të sjelljeve (UNESCO, 2005).¹

TEKST SHKOLLOR:

Mjet thelbësor i mësimnxënies, i përbërë nga tekste dhe/ose imazhe të projektuara për të arritur një numër specifik të rezultateve arsimore; tradicionalisht një libër i shtypur dhe i lidhur që përfshin ilustrime dhe udhëzime për të ndihmuar rrjedhën e aktiviteteve të mësimnxënies.

MATERIALE MËSIMORE:

Çfarëdo forme e mjeteve që përdoret për të mbështetur një program të mësimnxënies, shpesh si shtesë ndaj tekstit kryesor. Si shembuj mund të merren librat e punës, diagramet, lojërat edukative, kasetat audio dhe video, posterat dhe lexuesit plotësues.

Përkufizimet marrë nga: Strategjia Gjithëpërfshirëse për Tekstet Shkollore dhe Materialet Mësimore, Paris, UNESCO, (2005)

Tekstet shkollore me të drejtë konsiderohen si elementi kryesor i arsimit cilësor për të gjithë, një arsimi cilësor që "ngrihet mbi tri shtylla kryesore: sigurimi i mësimdhënësve cilësorë, sigurimi i përdorimit të mjeteve cilësore të mësimnxënies dhe i zhvillimit profesional, dhe krijimi i mjedisve të sigurta dhe mbështetëse për mësimnxënie cilësore." (Slade, 2016)² Edhe pse studimet mbi shkencën e arsimit e pranojnë gjerësisht se arsimi cilësor është një

"koncept i rrëshqitshëm" (Van Kemenade, Pupius dhe Hardjono, 2008, f. 176),³ ata bien dakord që tekstet shkollore dhe kurrikula, së bashku me shtyllat e tjera kryesore të arsimit cilësor, duhet të synojnë përtej rezultateve të thjeshta të mësimnxënies që kanë të bëjnë vetëm me përvetësimin e shkrim-leximit dhe numërtimit dhe me testet e aftësisë të lëndëve të ndryshme shkollore.

Arsimi cilësor është ai arsim i cili fokusohet në zhvillimin tërësor të fëmijës – në atë shoqëror, emocional, mendor, fizik dhe njohës të çdo nxënësi, pavarësisht nga gjinia, raca, etnia, gjendja socio-ekonomike ose vendndodhja gjeografike. Arsim që përgatit fëmijën për jetën, e jo vetëm për testim.

Deklarata e Shoqatës për Vlerësimin e Kurrikulës dhe Zhvillimin dhe Edukimin Ndërkombëtar, Washington D.C., (2016)

¹ UNESCO (2005). A Comprehensive Strategy for Textbooks and Learning Materials (shqip: Strategjia Gjithëpërfshirëse për Tekstet Shkollore dhe Materialet Mësimore) UNESCO, Paris. Marrë nga <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000143736>

² Slade, S. (2016). *What Do We Mean by a Quality Education?* (shqip: *Çka nënkuptojmë me arsim cilësor?*). Marrë nga

https://www.huffingtonpost.com/sean-slade/what-do-we-mean-by-a-qual_b_9284130.html

³ Van Kemenade, E., Pupius, M. dhe Hardjono, T. W. (2008). More Value to Defining Quality (shqip: Më shumë vlera për përcaktimin e cilësisë). *Quality in Higher Education* (shqip: *Cilësia në arsimin e lartë*), 14(2), 175-185.

Në procesin e gjatë dhe kompleks të mësimnxënies, nxënësit përballen me sfida të ndryshme. Nxënësi apo nxënësja duhet të përballen me pyetje dhe dilema, t'i ekspozohen në mënyrë rutinore ndaj mjedisit përreth dhe më larg dhe në fund të jetë nën trysinë për të mësuar dhe rimësuar. Në procesin e të nxënës, nxënësit duhet t'i analizojnë, t'i përvetësojnë dhe t'i akomodojnë njohuritë në mënyrë që të përqafojnë një qasje aktive të mësimnxënies dhe që të ndërveprojnë me të tjerët. Për më tepër, është e rëndësishme të nënvizohet se njohuritë fillimisht ndërtohen në një kontekst shoqëror dhe pastaj përvetësohen nga individët – nxënësit (Bruning, Schraw, & Ronning, 1999).⁴

Tekstet shkollore dhe materialet mësimore janë instrumenti kryesor përmes së cilit nxënësi dhe mësuesi bëjnë dialog, informacioni ndahet me të tjerët, si dhe transmetohen konceptet dhe vlerat. Përveç aftësive të numërimit dhe shkrim-leximit, tekstet shkollore si mjet për realizmin e mandatatit të shkollës, pritet t'u përgjigjen pyetjeve kyçe: *Çfarë njohurish? Çfarë aftësish? Çfarë vlerash?* ofrojnë. Përmbajtja e teksteve shkollore duhet t'u përshtatet të gjithë nxënësve. Së bashku me vendet, mjetet dhe sistemet tjera të arsimit, më shumë se kurrë më parë, tekstet shkollore duhet t'i

përdorin dhe t'i shqyrtojnë konceptet e të drejtave, të gjinisë, klasës, racës, shtetësisë, moralit, shoqërisë, drejtësisë, llogaridhënies dhe demokracisë.

Shqyrtimi i këtyre koncepteve pritet të bëhet në mënyrë të qartë dhe të hapur nëpërmjet lëndëve mësimore që janë formale dhe që ligjërohen në mënyrë specifike, si dhe nëpërmjet teksteve shkollore të tyre siç janë historia, gjeografia, letërsia, edukata qytetare etj., për t'i përmendur disa prej tyre. Për më tepër, këto koncepte pritet gjithashtu të shqyrtohen në mënyrë të nënkuptuar përmes lëndëve të tjera dhe teksteve shkollore të tyre siç janë për shembull shkencat natyrore, ku lidhja midis tyre dhe koncepteve të sipërpërmendura nuk është aq e dukshme dhe zakonisht mendohet të jenë neutrale kulturalisht dhe të konsiderohen si njohuri të pastra racionale. Një qasje e tillë siguron që jo vetëm rezultatet e identifikuar të mësimnxënies të arrihen në të gjitha lëndët e ligjëruara, por edhe që përmbajtja e teksteve shkollore të secilës lëndë që ligjërohet të jetë në harmoni të plotë me politikat zyrtare dhe politikat kombëtare të arsimit në mënyrë që të sigurojnë progresin drejt arritjes së qëllimit përfundimtar për një arsim cilësor për të gjithë dhe që është i bazuar në të drejtat e njeriut (UNESCO, 2005).⁵

ii. Tekstet shkollore - ndihmë e jashtëzakonshme për mësimdhënien dhe mjet efikas në arsim

Rëndësia e teksteve të duhura shkollore në përmirësimin e cilësisë së arsimit është theksuar gjithnjë e më shumë që nga vitet e 1990-ta (Braslavsky dhe Halil, 2006).⁶ Kohët e fundit, ndonëse profesionistët e arsimit dhe shoqëria e gjerë debatojnë lidhur me atë se njohuritë duhet të përcillen dhe të pranohen nga shumë burime, ende ekziston një mendim i përgjithshëm se tekstet shkollore mbeten një nga mjetet kryesore dhe më të përdorura në klasë dhe më gjerë, bazuar në përmbajtjen e cila përdoret si në mësimnxënien ashtu edhe në mësimdhënien. Nxënësit kalojnë shumicën e kohës së tyre në klasë duke përdorur tekste shkollore dhe në pjesën më të

madhe të mjediseve arsimore, mësimdhënësit i ofrojnë udhëzimet bazuar në tekstin shkollor.

Teksti shkollor është një libër i përdorur si një burim standard informacioni për studimin formal të një lënde dhe një instrumenti për mësimdhënien dhe mësimnxënien (Graves, 2000).⁷ Mësimdhënësit i përdorin tekstet shkollore si burim kryesor përmes të cilit mund të krijojnë dhe projektojnë korniza për mësimdhënien efektive në klasë, përshtatin metodologjitë e tyre të mësimdhënies në futjen dhe vendosjen e koncepteve përkatëse, si dhe krijojnë dhe

⁴ Bruning, Roger H.; Schraw, Gregory J.; Ronning, Royce R. (1999). *Cognitive Psychology and Instruction* (shqip: *Psikologjia njohëse dhe udhëzimet*) (botimi i 3-të). Prentice-Hall, Inc. ISBN 978-0-13-716606-0 – siç është cituar në dokumentin e Komitetit për Zhvillimet në Shkencën e Mësimnxënies (2000) të titulluar *How People Learn: Brain, Mind, Experience and School: Expanded Edition* (shqip: *Si mësojnë njerëzit: truri, mendja, përvoja dhe shkolla: botim i zgjeruar*). Marrë nga National Academies Press në: <http://www.nap.edu/catalog/9853.html>

⁵ UNESCO (2005). *A Comprehensive Strategy for Textbooks and Learning Materials* (shqip: *Strategjia Gjithëpërfshirëse për Tekstet Shkollore dhe*

Materialet Mësimore). UNESCO, Paris. Marrë nga <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000143736>

⁶ UNESCO (2016). *Every Child Should Have a Textbook. Policy Document*. (shqip: *Çdo fëmijë duhet të ketë një tekst shkollor. Dokument politikash*). UNESCO, Paris, Francë. Marrë nga: <http://unesdoc.unesco.org/images/0024/002433/243321E.pdf>

⁷ Graves, K. (2000). *Designing Language Course, A Guide for Teachers*. Boston. Heinle. Cengage Learning.

rikrijonjë materiale didaktike të nevojshme për të lehtësuar procesin e mësimdhënies dhe të përshtatura për nevojat e nxënësve. Ata shtojnë në materialin e tekstit dhe plotësojnë tekstin me materiale të tjera leximi si dhe mjete tjera që kontribuojnë në të menduarit kritik të nxënësve. Përveç kësaj, teksti shkollor krijon besim dhe siguri për një mësimdhënës të papërvujtë që e sheh si sfidë përshtatjen e teksteve ekzistuese, veçanërisht kur kërkohet përshtatja e teksteve sipas temës së orës së mësimi (Gak, 2011).⁸

Në vendet në zhvillim ku ekzistojnë burime të kufizuara dhe klasa të përmasave të mëdha, ku ka përqindje të lartë të mësimdhënësve të pakualifikuar, mungesë të mësimdhënësve të kualifikuar dhe mungesë të kohës mësimore, "tekstet shkollore në gjuhët e përshtatshme dhe në nivele të përshtatshme të vështirësive kanë provuar se janë të hyra me kosto relativisht të ulët por me kthime të larta për arritjet e nxënësve" (Boissiere, 2004).⁹

Një numër gjithnjë në rritje i dëshmimeve konfirmojnë se tekstet shkollore luajnë rol kritik në përmirësimin e mësimnxënies dhe të arritjeve të nxënësve dhe rrjedhimisht ndikojnë shumë në politikat e arsimit. Për shembull, Svazilandi ka siguruar libra falas për të gjithë nxënësit e shkollave fillore që nga viti 2003 (SACMEQ, 2011).¹⁰ Disa vende të tjera, duke përfshirë Guatemalën dhe Nikaraguan, gjithashtu kanë futur programe të teksteve shkollore falas që shënjestrojnë nxënësit më të pafavorizuar (Porta and Laguna, 2007).¹¹

Një analizë ndërshtetërore e bazuar në të dhënat nga vlerësimet rajonale në 22 vende afrikane subsahariane tregon se burimet pedagogjike, veçanërisht tekstet shkollore për lëndët bazë të leximit dhe matematikës janë efektive në përmirësimin e mësimnxënies; siguri i një teksti shkollor

për çdo nxënës në klasë rrit rezultatet e shkrim-leximit për 5-20% (Fehrler et al., 2009).¹² Në Afrikën e Jugut, nxënësit, sidomos vajzat, kanë rezultate më të mira në testet e leximit kur kanë kopjet e tyre të teksteve shkollore (Reddy et al, 2015).¹³

Përveç kësaj, e drejta për arsimim është një nga të drejtat themelore të njohura nga disa konventa ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe realizimi i të drejtave mes të tjerash nënkupton sigurimin dhe qasjen e barabartë në mjetet për realizimin e këtyre të drejtave. E drejta për arsimim nuk mund të arrihet në mungesë të sigurimit dhe qasjes në tekstet shkollore. Në shumë vende të botës, kur komunitetet përballen me mungesë të teksteve shkollore si dhe qasja dhe siguri i teksteve shkollore nga shkollat është i pabarabartë, komunitetet e shqyrtojnë seriozisht këtë fenomen dhe kur të gjitha mjetet e tjera dështojnë, ato e sjellin çështjen e mungesës së qasjes në tekstet shkollore para gjykatave për ta gëzuar këtë të drejtë, për të kërkuar drejtësi dhe për të siguruar kompensimet e duhura.

Kështu për shembull në vitin 2014, "Section 27", një qendër juridike për interesin publik e cila fokusohet në të drejtat për shëndet dhe arsimim në Afrikën e Jugut, duke vepruar në emër të klientëve të saj - një organizatë me bazë në komunitet e quajtur "Basic Education for All" (shqip: Arsim themelor për të gjithë) dhe një numër i shkollave në provincën e Limpopos, e paditi në gjykatë Departamentin e Arsimit Themelor të vendit për dështimin e dorëzimit të teksteve shkollore në shkollat e provincës të cilat kishin nevojë për to gjatë atij viti. Gjykata vendosi se departamenti kishte shkelur të drejtat e fëmijëve për arsimim themelor dhe

⁸ Gak, DM (2011). Gak, DM (2011). Textbook – An Important Element in the Teaching Process. НАСТАВА СТРАНИХ ЈЕЗИКА, Novi Sad. Marrë nga <https://www.epub.ff.uns.ac.rs/index.php/MV/article/download/771/781>

⁹ Boissiere, M.X. (2004/01/01). Determinants of primary education outcomes in developing countries (shqip: Përcaktuesit e rezultateve të arsimit fillor në vendet në zhvillim). Marrë nga: <http://documents.worldbank.org/curated/en/111011468162550538/pdf/391570educatio1eterminants01PUBLIC1.pdf>

¹⁰ SACMEQ (shtator 2011) Quality of Primary School Inputs in Swaziland. Policy Document Nr. 2 (shqip: Cilësia e inputeve të shkollave fillore në Svaziland. Dokument politikash nr. 2). Marrë nga http://www.sacmeq.org/sites/default/files/sacmeq/reports/sacmeq-iii/policy-brief/swa_school_inputs_15oct2011_final.pdf

¹¹ Porta, E. dhe Laguna, J.R. (2007). Monitoring Education for All in Guatemala. Country Profile (shqip: Monitorimi i "Arsimit për të gjithë" në Guatemalë. Profili i vendit). Education for All Global Monitoring Report 2008. Education for All by 2015: will we make it? (shqip: Raporti i monitorimit i vitit 2018 për "Arsimi për të gjithë". "Arsimi për të gjithë" deri

në vitin 2015: a do t'ia dalim?). Marrë nga <http://unesdoc.unesco.org/images/0015/001555/155575e.pdf>

¹² Fehrler, S., Michaelowa, K., Wechtler, A. (2009). The Effectiveness of Inputs in Primary Education: Insights from Recent Student Surveys for Sub-Saharan Africa. Journal of Development, Volume 45/9 (shqip: Efektshmëria e inputeve në arsimin fillor: vështrime nga anketat e fundit të studentëve për Afrikën Subsahariane. Gazeta e Zhvillimit, Vëllimi 45/9). <http://www.informaworld.com/smpw/pwreset?id=916960109&dt=4013467207843&ck=45D4B817970C96B072AD8BDBB7DD5A10>

¹³ Reddy, V. Zuze, T.L., Visser, M. Winnaar, L. Juan, A. Prinsloo, CH., Arends, F, Rogers, S. (2015). Beyond the Benchmarks: What Twenty years of TIMSS data tell us about South African education? (shqip: Përtej standardeve krahasuese: çka na mësojnë rreth 20 vjet të të dhënave të TIMSS për arsimin në Afrikën e Jugut?). Këshilli i Kërkimeve të Shkencave Njerëzore. Raport kombëtar. Marrë nga http://pub.iea.nl/fileadmin/user_upload/Publications/National_reports/TI_MSS_2011_report_SouthAfrica.pdf

u urdhërua që të ofrojnë tekste shkollore për çdo nxënës dhe për çdo lëndë në fillim të çdo viti shkollor (Veriava, 2015).¹⁴

"Tekstet shkollore kanë qenë pjesë e fondit në profesionin e mësuesit për shekuj me radhë. Libri është diçka e veçantë. Ai ka një jetë shumë të gjatë, shumë më të gjatë se jeta e lexuesit individual. Është një pajisje e teknologjisë së ulët. Është i arritshëm për këdo që mund të lexojë në gjuhën në të cilën është shkruar. Gjatë orëve të ditës mund të lexohet (qaset) pa ndonjë teknologji tjetër mbështetëse. Nuk ka nevojë për mirëmbajtje përveç, ndonjëherë, të shiritit ngjites."

Nga vendimi i Gjykatës së Lartë të North Guatengut për rastin "Section27" kundër Departamentit të Arsimit Themelor lidhur me dështimin në sigurimin e teksteve shkollore për shkollat në Limpopo

Mund të arrihet në përfundim se përdorimi i teksteve shkollore në mësimdhënie ka avantazhet e veta varësisht prej mënyrës se si përdoren dhe varësisht se cilat janë kontekstet për përdorimin e tyre. Disa nga përparësitë më të cituara mund të gjenden më poshtë:

- *Tekstet shkollore janë mjetet më dominuese arsimore në mbarë botën, por gjithashtu edhe ato më jetëgjatë. Pasi të jenë prodhuar dhe shtypur, ato mbeten një mjet i njohurive për një kohë të gjatë dhe për shumë gjenerata që do të pasojnë.*
- *Tekstet shkollore janë rezultat i kurrikulës apo thënë më saktë, përmbajtja e teksteve shkollore është rezultati më "i prekshëm" i kurrikulës (Blumberg, 2007, f. 7).¹⁵ Ato janë një nga mjetet më të përdorura për ta kthyer kurrikulën në përvoja praktike për t'i arritur objektivat e saj.*
- *Tekstet shkollore janë një nga burimet kryesore të përdorimit të përmbajtjes në klasa që promovojnë njohuritë, vlerat dhe qëndrimet të cilave nxënësit iu përshtaten dhe nga të cilat nxënësit zhvillohen.*
- *Përmes përmbajtjes së tyre, informacionit faktik, gjykimit të vlerave, gjuhës por edhe elementeve vizuale, dizajnit dhe qasjes pedagogjike, tekstet*

shkollore ndikojnë në njohuritë e nxënësve dhe në shoqërinë në përgjithësi (Georgescu et al, 2010).¹⁶

- *Tekstet shkollore ofrojnë siguri për nxënësit sepse u ofrojnë atyre një lloj udhërrëfyese lidhur me kursin: ata e dinë se çfarë duhet të presin nga lënda dhe e dinë se çfarë pritet nga ta.*
- *Tekstet shkollore u ofrojnë mësimdhënësve një bazë për vlerësimin e mësimnxënies nga ana e nxënësve. Disa tekste shkollore përfshijnë teste ose mjete vlerësimi dhe kështu ua mundësojnë atyre të bëjnë vlerësimin e duhur dhe të matin zhvillimin e aftësive të nxënësve.*
- *Tekstet shkollore sigurojnë konsistencë brenda një programi në një nivel të caktuar, nëse të gjithë mësimdhënësit përdorin të njëjtin tekst shkollor. Nëse tekstet shkollore ndjekin një sekuencë, sikur brenda një serie, atëherë kjo siguron konsistencë ndërmjet niveleve. (Graves, 2000).¹⁷*
- *Tekstet shkollore akomodojnë jo vetëm informacionin e dukshëm, por edhe "kurrikulën e fshehtë" (Georgescu et al, 2007, f. 13)¹⁸ (d.m.th. aty ku stereotipat gjinorë, ndër të tjera janë vështirë të dukshëm dhe nuk zbulohen lehtësisht.)*

¹⁴ Veriava, F. (9 nëntor 2015). Why textbooks are a crucial part of every child's learning journey? *The Conversation*. (shqip: Pse tekstet shkollore janë pjesë e rëndësishme e rrugëtimit të çdo fëmije drejt mësimnxënies? Biseda.). Marrë nga: <https://theconversation.com/why-textbooks-are-a-crucial-part-of-every-childs-learning-journey-50252>

¹⁵ Blumberg, Rae Lesser. (2007). "Gender Bias in Textbooks: A hidden obstacle on the road to gender equality in education" (shqip: "Animet gjinore në tekstet shkollore: pengesë e fshehur në rrugëtimin drejt barazisë gjinore në arsim"). UNESCO, Geneva EFA-GMR. siç është cituar në Georgescu et al., (2010) Guidelines for Textbook Reviews and Analysis from a Gender Perspective (shqip: Udhëzues për recensime dhe analiza të teksteve shkollore nga perspektiva gjinore), UNESCO, Gjenevë. Marrë nga <https://docs.iiep.unesco.org/peic/2748.pdf>

¹⁶ Georgescu D. et al (2010) Guidelines for Textbook Reviews and Analysis from a Gender Perspective (shqip: Udhëzues për recensime dhe analiza të teksteve shkollore nga perspektiva gjinore). UNESCO Hanoi, IBE dhe MOET, Gjenevë. Marrë nga <https://docs.iiep.unesco.org/peic/2748.pdf>

¹⁷ Graves, K. (2000). *Designing Language Course, A Guide for Teachers* (shqip: *Zhvillimi i një kursi të gjuhëve, udhëzues për mësimdhënësit*). Boston. Heinle Cengage Learning. Basturkmen, H. (2010). *Developing Courses in English for Specific Purposes* (shqip: *Zhvillimi i kurseve në anglishtën për qëllime specifike*). Nju-Jork: Palgrave Macmillan

¹⁸ Blumberg R.L. (2007). Gender bias in textbooks: A hidden obstacle on the road to gender equality in education (shqip: "Animet gjinore në tekstet shkollore: pengesë e fshehur në rrugëtimin drejt barazisë gjinore në arsim"). UNESCO, Paris. Marrë nga <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000155509>

- *Tekstet shkollore mbeten burimi kryesor i mësimdhënësve në mësimdhënie, planifikim, mësimnxënie dhe vlerësim pavarësisht nga konteksti i përdorimit të tyre.*
- *Tekstet shkollore ofrojnë mesazhe të rëndësishme për audiencën e tyre jo vetëm për nxënësit, por edhe për mësimdhënësit brenda shkollës. Edhe pas diplomimit, mesazhet e teksteve shkollore mbeten brenda njohurive që nxënësit i kanë marrë gjatë shkollimit të tyre.*
- *Qasja në tekstet shkollore kontribuon në mbylljen e boshllëkut gjinor dhe të pabarazive shoqërore në rezultatet e mësimnxënies*

Megjithatë, tekstet shkollore mund të paraqesin edhe kufizime në proceset e të mësuarit. Ato gjithashtu mund të paraqesin disavantazhe si për mësimdhënësit ashtu edhe për nxënësit, të cilat janë renditur më poshtë:

- *Përmbajtja ose shembujt e teksteve shkollore ka mundësi të mos jenë relevante ose të përshtatshme për grupin dhe ka mundësi të mos pasqyrojnë nevojat e nxënësve pasi tekstet shkollore shpesh shkruhen për tregjet globale dhe shpesh nuk pasqyrojnë interesat dhe nevojat e nxënësve.*
- *Tekstet shkollore mund të përmbajnë gjuhë joautentike meqë tekstet, dialogët dhe aspektet e tjera të përmbajtjes kanë tendencë të jenë të shkruara posaçërisht për t'i inkuorporuar pikat mësimore dhe shpesh nuk përfaqësojnë përdorimin e vërtetë të gjuhës.*
- *Tekstet shkollore japin përshtypjen e përgjithshme se ajo që shtypet është e drejtë dhe e vërtetë, veçanërisht duke qenë se memorizimi i njohurive është më i përhapur sesa të menduarit kritik (Georgescu et al, 2010).¹⁹*
- *Përmbajtja e teksteve shkollore ka mundësi të mos jetë në nivelin e duhur (Graves, 2000).²⁰*
- *Përmbajtja e teksteve shkollore mund të pasqyrojë realitetin ashtu siç është dhe të mos sigurojë bazë brenda përmbajtjes së tij për të sfiduar realitetin*

nëpërmjet një angazhimi konstruktiv të mësimdhënësve dhe nxënësve.

Për më tepër, tekstet shkollore e paraqesin kurrikulën në një mënyrë të prekshme, mesazhet e shtypura japin një ndikim të fuqishëm mbi nxënësit dhe mbi shoqërinë. Është e rëndësishme të theksohet se në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, informatat, besimet, qëndrimet dhe njohuritë e përgjithshme, qofshin të njëanshme apo jo, personalizohen nga nxënësit. Pasi të personalizohen përmes mjeteve institucionale, ato sfidohen dhe ndryshohen me vështirësi. Si të tilla, ato bëhen "e vërteta". Atëherë çfarë e

TEKST I MIRË SHKOLLOR:

"Një pikëpamje më aktuale dhe gjithëpërfshirëse identifikon materialet mësimore cilësore ato që angazhojnë në mënyrë aktive nxënësit në procesin e marrjes së njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve të nevojshme për t'u bërë qytetarë të përgjegjshëm të komuniteteve të tyre dhe të botës"

Përkufizimet marrë nga: Strategjia Gjithëpërfshirëse për Tekstet Shkollore dhe Materialet Mësimore, Paris, UNESCO, (2005)

bën një tekst shkollor të konsiderohet i mirë? (UNESCO, 2005)²¹

Përkufizimi i OKBESHK-së përcakton qartë se teksti shkollor nuk mund të jetë një instrument që i ngjan një shiriti transportues përmes të cilit informatat, faktet dhe opinionet i përcillen nxënësit për të përmbushur qëllimin përfundimtar të memorizimit në mënyrë që ta kalojë një provim dhe ta marrë një diplomë! Teksti i mirë shkollor është ai që stimulon si mësimdhënësin ashtu edhe nxënësin, që ushqen të menduarit kritik dhe inkurajon debatin dhe kjo nuk parafabron njohuri, por ua mundëson nxënësve dhe mësimdhënësve të reflektojnë në përmbajtjen e teksteve shkollore, ta formojnë dhe riformulojnë atë si pjesëmarrës aktiv në krijimin e një realiteti të ri, një realitet i bazuar në vlerat e përbashkëta universale dhe progresive.

¹⁹ Georgescu, D. et al (2010) Guidelines for Textbook Reviews and Analysis from a Gender Perspective (shqip: Udhëzues për recensime dhe analiza të teksteve shkollore nga perspektiva gjinore). UNESCO Hanoi, IBE dhe MOET, Gjenevë. Marrë nga <https://docs.iiep.unesco.org/peic/2748.pdf>

²⁰ Graves, K. (2000). *Designing Language Course, A Guide for Teachers* (shqip: *Zhvillimi i një kursi të gjuhëve, udhëzues për mësimdhënësit*). Boston. Heinle Cengage Learning. Basturkmen, H. (2010). *Developing*

Courses in English for Specific Purposes (shqip: *Zhvillimi i kurseve në anglishtën për qëllime specifike*). Nju-Jork: Palgrave Macmillan

²¹ UNESCO (2005). *A Comprehensive Strategy for Textbooks and Learning Materials* (shqip: *Strategjia Gjithëpërfshirëse për Tekstet Shkollore dhe Materialet Mësimore*). UNESCO, Paris, Francë. Marrë nga <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000143736>

Nga kjo pikëpamje, mund të arrihet në përfundim se tekstet shkollore mbeten platforma më e rëndësishme në të cilën gjinia si vlerë e të drejtave të njeriut duhet të promovohet në të gjitha lëndët e mësuara në shkollë "... në mënyrë që vlerat e kujdesit për të tjerët dhe e ndarjes së gjërave me të tjerët, parimet e dinjitetit të punës dhe të mësuarit për të jetuar së bashku, si dhe vlerësimi i kontributeve të grave dhe shumë të tjera të përkthehen në përmbajtjen, pamjet dhe ushtrimet e të gjitha disiplinave. Qasja e drejtë është që gjinia të jetë si pjesë integrale e materialit tekstual dhe jo si një shtojcë ndaj

qasjes. Fokusi i autorit duhet të jetë që të shihet nëse këto shqetësime janë të përfshira në të gjitha disiplinat në mënyrë që ato të transmetohen në mënyrë efektive tek fëmijët" (Srivastava, 2012).²² Në mënyrë që të zvogëlohet diskriminimi dhe të nxitet barazia dhe të drejtat e njeriut, kurrikula gjithëpërfshirëse duhet të shndërrohet në një tekst shkollore gjithëpërfshirës dhe tejet cilësor që u shërben si mësimdhënësve ashtu edhe nxënësve, si dhe gjithë shoqërisë në përgjithësi.

iii. Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut në tekstet shkollore si dhe barazia gjinore

Shkollat ka kohë që janë ngarkuar me formimin e qytetarisë për gjeneratat e ardhshme. Ato konsiderohen si vendet dhe mjediset institucionale më të mira ku individët me përkatësi të ndryshme politike dhe shoqërore bashkohen për të mësuar, debatuar dhe promovuar diskutim racional dhe tolerancë. Janë vende që kërkojnë ndryshim të vazhdueshëm në mënyrë që të përqafohen plotësisht nga ndryshimet shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore të shoqërisë.

Për më tepër, ato "krijojnë mjedise që respektojnë dhe mbrojnë pluralizmin dhe individualizmin duke adaptuar praktika udhëzuese që promovojnë agjencinë qytetare, mendimin kritik dhe përvojat pjesëmarrëse (Rebell, 2018)."²³ Në dekadat e fundit, arsimi i bazuar në të drejtat e njeriut

është konsideruar gjerësisht si një instrument përforcues dhe mundësues për shkollat në përpjekjet e tyre për të promovuar dhe forcuar respektimin e të drejtave të njeriut, njohjen dhe gëzimin e dinjitetit njerëzor, qasjen e barabartë dhe pjesëmarrjen në sistemin arsimor që nxit gjithëpërfshirjen, mosdiskriminimin, respektin dhe praktikimin e vlerave universale, dhe kujdesin për diversitetin.

Tekstet duhet të konsiderohen si "një kontribut në kohezionin shoqëror dhe parandalimin e konflikteve duke mbështetur zhvillimin shoqëror dhe emocional të fëmijës dhe duke përfshirë qytetarinë dhe vlerat demokratike (World Programme for Human Rights Education)."²⁴

²² Srivastava, G. (2012). *Gender and Peace in Textbooks and Schooling Processes; The Maldivian Experience* (shqip: *Gjinia dhe paqja në tekstet shkollore dhe në proceset e shkollimit; përvoja maldiviane*). Nju-Delhi. Concept Publishing Company. Marrë nga https://books.google.com/books?id=19xfgkfuapAC&pg=PA22&dq=textbook+s+as+main+vehicle+of+gender+values&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEwiCzsnop_eAhVEp4sKHcm5AKAQ6AEITjAH#v=onepage&q=textbooks%20as%20main%20vehicle%20of%20gender%20values&f=false

²³ Rebell A. M., (October, 2018). Preparation for capable citizenship: The school's primary responsibility (shqip: Përgatitja për shtetësi të aftë: Përgjegjësia primare e shkollës). *Phi Delta Kappan – The professional journal for educators*. Marrë nga: <https://www.kappanonline.org/rebell-preparation-capable-citizenship-schools-primary-responsibility/>

²⁴ World Programme for Human Rights Education (shqip: Programi botëror për arsimin për të drejtat e njeriut). Marrë nga <https://www.ohchr.org/EN/Issues/Education/Training/WPHRE/FirstPhase/Pages/Firstphaseindex.aspx>

PËRKUFIZIMI I ARSIMIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE I QASJES SË BAZUAR NË TË DREJTAT E NJERIUT NË ARSIM

Bazuar në instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, arsimit për të drejtat e njeriut (ADNJ) mund të përkufizohet si arsimim, trajnim dhe informim që ka për qëllim ndërtimin e një kulture universale të të drejtave të njeriut përmes shkëmbimit të njohurive, komunikimit të aftësive dhe formimit të qëndrimeve për veprim të menjëhershëm drejt forcimit të respektimit të të drejtave të njeriut, lirive themelore, tolerancës, barazisë dhe paqes, midis individëve, brenda shoqërive dhe midis kombeve. Një arsim i tillë kërkon adaptimin e një qasjeje të bazuar në të drejtat e njeriut në arsim, e cila promovon si "të drejtat e njeriut përmes arsimit", duke siguruar që të gjithë komponentët dhe proceset e arsimit - duke përfshirë këtu edhe kurrikulat, materialet, metodat dhe trajnimet - janë të favorshme për t'i mësuar të drejtat e njeriut, ashtu edhe "të drejtat e njeriut në arsim", duke siguruar që të drejtat e njeriut të të gjithë anëtarëve të bashkësisë shkollore të respektohen dhe të drejtat e njeriut të praktikohen brenda sistemit arsimor.

Plani i Veprimit për Fazën e Parë të Programit Botëror për të Drejtat e Njeriut në Arsim (2005 – 2009)

Tashmë të njohura si një nga instrumentet kryesore të procesit të arsimit dhe sistemit shkollos, tekstet shkollore duhet të përfshijnë një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut. Institucionet ndërkombëtare dhe edukatorët kanë shprehur vazhdimisht konsensusin e tyre për kontributin e rëndësishëm të arsimit për të drejtat e njeriut dhe për vendin e tyre në kurrikulat shkollore dhe tekstet shkollore.

UNESCO prej kohësh ka qenë e përkushtuar që të ketë tekste shkollore që integrojnë qasjen e bazuar në të drejtat dhe që eliminojnë paragjykimet, mungesën e tolerancës, stereotipizimin dhe pabarazinë për të mos nxitur qëndrime dhe sjellje negative dhe të dhunshme (UNESCO, 2005).²⁵

Në promovimin e arsimit për të drejtat e njeriut nëpërmjet politikave dhe qasjeve për zhvillimin e teksteve shkollore, jo vetëm në shkencat shoqërore por në të gjitha lëndët, UNESCO synon "të ndërtojë paqe në mendjen e burrave dhe grave.

Kjo qasje siguron që përmbajtja e teksteve shkollore të bëhet një kontribuues në krijimin e një kulture të të drejtave të njeriut përtej vetëm dhënies së informatave. Njëkohësisht, i fuqizon nxënësit me aftësitë dhe mjetet për veprimet transformuese dhe si mbrojtës të kulturës universale të të drejtave të njeriut.

iv. Tekstet shkollore - si instrumente të ndryshimit dhe transformimit shoqëror

Arsimi është hapësira autentike për zhvillimin e demokracisë. Arsimit demokratik duhet të sigurojë se ekzistojnë mundësi të barabarta për të gjithë, pavarësisht nga gjinia, përkatësia etnike, feja, statusi shoqëror dhe ekonomik për të nxjerrë dhe zhvilluar nxënës me potencial të plotë si individë. Pikërisht brenda mureve të shkollës promovohen vlerat demokratike, ndërsa mësimdhënia dhe mësimnxënia e pavarur inkurajohen përmes promovimit të interpretimeve të shumfështa të informatave, debateve dhe praktikave të

hapura dhe konstruktive drejt proceseve të jetës dhe zhvillimit të shoqërisë. Qëllimi i arsimit është t'i instalojë vlerat e bashkëpunimit, korrektësisë dhe drejtësisë në formimin e nxënësve, pavarësisht nga zhvillimi i shoqërisë ku ata veprojnë.

Është pikërisht roli i shkollave që t'i sfidojë normat e shoqërisë dhe të jetë përpara normave të shoqërisë nëpërmjet prodhimit të njohurive. Shkollat shihen si vendi i të menduarit dhe dialogut, ku, siç përshkruhet nga UNESCO²⁶

²⁵ UNESCO (2005). A Comprehensive Strategy for Textbooks and Learning Materials (shqip: Strategjia Gjithëpërfshirëse për Tekstet Shkollore dhe Materialet Mësimore). UNESCO, Paris. Marrë nga <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000143736>

²⁶ Meyer-Birsch, P. (1995). *Culture of democracy: a challenge for schools* (shqip: *Kultura e demokracisë: një sfidë për shkollat*). UNESCO Paris. Marrë

nga https://unesdoc.unesco.org/in/rest/annotationSVC/DownloadWatermarkAttachment/attach_import_2ac583e6-d666-46e7-928b-4fac406e20b7?_=099812engo.pdf

"...kultura e demokracisë, duke marrë çdo qenie njerëzore në zemër të kontigjencës së tyre, vlerat dhe horizontet e tyre të caktuara, i vendos ato në kontakt me vlerat absolute dhe një përgjegjësi që mund të zgjatet pafundësisht. Kultura e demokracisë i vendos njerëzit në një situatë paradoksale, e cila i stimulon dhe ua mundëson të hedhin një vështrim të ri mbi strukturat..."

Në këtë mënyrë, tekstet shkollore dhe materialet mësimore që përfshijnë vlerat njerëzore bëhen mjet qendror për ofrimin e arsimit cilësor, i cili nga ana tjetër synon të përmbushë premtimin që të gjithë anëtarët e familjes njerëzore të jetojnë në dinjitet dhe paqe.

Strategjia Gjithëpërfshirëse për Tekstet Shkollore dhe Materialet Mësimore, Paris, UNESCO, (2005)

Megjithatë, sistemi arsimor shumë shpesh e kopjon shoqërinë aktuale. Janë pikërisht tekstet shkollore ato që i reflektojnë normat politike dhe shoqërore të një shoqërie dhe "përcjellin një të kuptuar të historisë dhe të rregullave të shoqërisë, si dhe normave të jetesës me njerëzit e tjerë (Pingel, 2007, f. 7)."²⁷ Tekstet shkollore shënojnë kufijtë e traditave që shpesh nuk janë sfiduar, kundërshtuar, kritikuar apo ndryshuar për dekada të tëra apo më gjatë. Ata janë, pa dyshim, një mjet që nxitin ndryshimet shoqërore. Përmes tyre, njohuritë dhe vlerat universale transmetohen dhe shpërndahen në komunitetin arsimor, por edhe në shoqëri.

Se cilat njohuri, qëndrime dhe aftësi transmetohen përmes arsimit në përgjithësi dhe teksteve shkollore në veçanti përcakton se cilat njohuri, aftësi dhe qëndrime i marrin dhe i praktikojnë nxënësit. Si të tilla, tekstet shkollore mund të bëhen pa dyshim mjetet kryesore për ofrimin e arsimit cilësor dhe mund të sigurojnë nëpërmjet përmbajtjes dhe ofrimit st tyre që të gjithë anëtarët e familjes njerëzore të jetojnë në dinjitet dhe paqe. Procesi i prezantimit dhe interpretimit të

njohurive në tekstet shkollore, si të tilla, shërben si një mjet për normat, vlerat dhe modelet e sjelljes shoqërore, dhe siç përcaktohet nga UNESCO: ²⁸ "Krijimi i një teksti shkollor është i njëjtë me zgjedhjen e vlerave, normave dhe përfaqësimeve që mbështesin shpresat për ruajtjen e kohezionit shoqëror dhe një marrëdhënie harmonike midis njeriut dhe institucioneve".

Roli i rëndësishëm i teksteve shkollore në sjelljen e transformimit shoqëror dhe bërjen e ndryshimeve shoqërore qëndron në kompleksitetin e përmbajtjes. Megjithatë, përmbajtja shpesh nxjerr në pah shoqërinë aktuale dhe determinizmin. Tekstet shkollore përmbajnë sasi të madhe të fakteve, të dhënave dhe informacione të tjera, por edhe tekste imagjinare, përralla, tregime dhe shembuj. Përtej kësaj, ato paraqesin rregulla, norma dhe modele të sjelljeve njerëzore të cilat të rriturit dhe shoqëria duan t'i instalojnë tek brezat e rinj (Pingel, 2010).²⁹

UNESCO pohon se tekstet shkollore duhet t'ua mundësojnë nxënësve të marrin përgjegjësi për jetën e tyre, të bëjnë ndryshime thelbësore dhe kontribute të rëndësishme për komunitetet e tyre, të marrin pjesë në krijimin e kulturave të paqes dhe të bëhen qytetarë të informuar të botës (Pingel, 2010).³⁰ Prandaj, tekstet shkollore, përmes përmbajtjes së tyre komplekse përmes koncepteve, informacionit faktik, gjykimit të vlerave dhe gjuhës, si dhe dizajnit të tyre, elementeve vizualë dhe qasjes pedagogjike mes tjerash (Georgescu et al, 2010),³¹ duhet të përpiqen të sjellin ndryshime dhe transformime në mënyrën se si nxënësit e shohin dhe e analizojnë veten dhe shoqërinë, dhe të sjellin ndryshime të mundshme që ata duan t'i shohin në të ardhmen e shoqërisë së tyre.

Zhvillimi i përmbajtjeve dhe teksteve shkollore që çojnë në ndryshime shoqërore është sfidë. Autorët që krijojnë tekste të reja shkollore dhe shqyrtuesit që i shqyrtojnë ato duhet të

²⁷ Pingel, F., (2010) Guidebook on Textbook Research and Textbook Revision (shqip: Udhëzues për hulumtimin e teksteve shkollore dhe për recensimin e teksteve shkollore). Botimi i 2-të dhe i rishikuar. UNESCO, Paris. Marrë nga <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000117188.pdf>

²⁸ Pingel, F., (2010) Guidebook on Textbook Research and Textbook Revision (shqip: Udhëzues për hulumtimin e teksteve shkollore dhe për recensimin e teksteve shkollore). Botimi i 2-të dhe i rishikuar. UNESCO, Paris. Marrë nga

<https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000117188.pdf>

²⁹ Pingel, F., (2010) Guidebook on Textbook Research and Textbook Revision. 2nd and Revised Edition. (shqip: Udhëzues për hulumtimin e teksteve shkollore dhe për recensimin e teksteve shkollore). Botimi i 2-të

dhe i rishikuar. UNESCO, Paris. Marrë nga <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000117188.pdf>

³⁰ Pingel, F., (2010) Guidebook on Textbook Research and Textbook Revision. 2nd and Revised Edition. (shqip: Udhëzues për hulumtimin e teksteve shkollore dhe për recensimin e teksteve shkollore). Botimi i 2-të dhe i rishikuar. UNESCO, Paris. Marrë nga <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000117188.pdf>

³¹ Georgescu, D. et al (2010) Guidelines for Textbook Reviews and Analysis from a Gender Perspective (shqip: Udhëzues për recensime dhe analiza të teksteve shkollore nga perspektiva gjinore). UNESCO Hanoi, IBE dhe MOET, Gjenevë. Marrë nga <https://docs.iiep.unesco.org/peic/2748.pdf>

marrin parasysh rëndësinë e perspektivave të ofruara dhe vlerat që gjenden në një përmbajtje të caktuar. Vëmendja e tyre duhet të jetë në atë se *çfarë duhet shmangur dhe çfarë duhet pasqyruar* në mënyrë që të harmonizohet përmbajtja me vlerat demokratike që duhet të pasqyrohen në çdo tekst shkollor të secilës fushë të studimit. Ata duhet të përpiqen t'i përfshijnë vlerat dhe të drejtat e njeriut dhe t'i sfidojnë nxënësit me ide progresive brenda kurrikulës, përmbajtjes së teksteve shkollore dhe materialeve mësimore që transformojnë kurrikulat në praktikë (Meyer-Bisch, 1995).³²

v. Arsimi dhe barazia gjinore

Konteksti ndërkombëtar

Për dekada me radhë, agjencitë ndërkombëtare janë afuar sfidës së edukimit dhe të drejtave të njeriut me anë të shumë konventave të ndryshme, programeve ndërkombëtare normative dhe zbatuese që synojnë zhvillimin e një edukimi të bazuar në të drejtat e njeriut. Vëmendje e posaçme në kuadër të të drejtave të njeriut u kushtohet të drejtave gjinore për të arritur barazinë gjinore.

Arsimimi si e drejtë e njeriut garantohet me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut të 1948 dhe qëndron në themel të të drejtave të njeriut si standard i përbashkët i arritshmërisë për të gjithë njerëzit dhe popujt, për çdo individ dhe çdo organ të shoqërisë për të promovuar respektimin e të drejtave dhe lirive përmes masave progresive. Në nenin 26³³ "Gjithkush ka të drejtën e shkollimit" ajo thotë:

1. *Gjithkush ka të drejtën e shkollimit. Arsimi duhet të jetë falas, të paktën në shkollat fillore dhe të ulëta. Arsimi fillor është i detyrueshëm. Arsimi teknik dhe profesional do të jetë përgjithësisht i qasshëm, ndërsa arsimi i lartë duhet t'u bëhet i mundshëm të gjithëve në bazë të meritës.*
2. *Arsimi duhet të orientohej drejt zhvillimit të plotë të personalitetit të njeriut dhe forcimit të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ai duhet të promovojë të kuptuarit, tolerancën dhe miqësinë mes gjithë popujve, grupeve të racave dhe besimeve, si dhe*

Meqë padrejtësia shoqërore ka shumë aspekte të ndryshme, shqyrtimi i teksteve shkollore kërkon njohuri të duhura, qëndrime të caktuara, vullnet të mirë, aftësi të zhvilluara mirë dhe gjithashtu mjete praktike për t'i shmangur të gjitha llojet e përmbajtjeve ekzistuese diskriminuese dhe të njëanshme dhe për t'i zhvilluar aftësitë e nevojshme njohëse dhe të menduarit kritik të nxënësve, të cilat më vonë mund t'i shfrytëzojnë gjatë përpjekjeve të tyre për ndryshime shoqërore.

të avancojë veprimtarinë e Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes.

3. *Prindërit e kanë në radhë të parë të drejtën për të zgjedhur llojin e arsimit për fëmijët e tyre.*

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEDKG) e miratuar në vitin 1979 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe që zakonisht përshkruhet si kartë ndërkombëtare e të drejtave të grave, Neni 1 përkufizon diskriminimin ndaj grave si:

"...çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e seksit, e që ka për pasoje ose për qëllim të komprometojë ose të asgjësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër pavarësisht nga gjendja e tyre martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas."³⁴

Neni 10 i KEDKG-së³⁵ bën thirrje për të drejta të barabartë të grave dhe burrave në fushën e arsimit dhe në veçanti për të siguruar barazinë mes burrave dhe grave në të gjitha nivelet dhe format e arsimit, programet, plan programet, tekstet mësimore, metodat e mësimdhënies dhe të tjera.

³² Meyer-Bisch, P. (1995) Culture of Democracy, A Challenge for Schools (shqip: Kultura e demokracisë: një sfidë për shkollat). UNESCO, Paris. Marrë nga: <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000099812>

³³ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (1984) Kombet e Bashkuara. Marrë nga: <http://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights/>

³⁴ Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (2003) UN WOMEN. Marrë nga:

<http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/text/econvention.htm>

³⁵ Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (2003) UN WOMEN. Marrë nga

<http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/text/econvention.htm#article10>

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF)³⁶ e vitit 1989 njeh të drejtën e fëmijës për arsimim dhe me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, neni 28 parasheh si në vijim:

- (a) *Arsimi fillor të bëhet i detyrueshëm dhe falas për të gjithë;*
- (b) *Të inkurajohet zhvillimi i formave të ndryshme të arsimit të mesëm duke përfshirë atë të përgjithshëm, dhe profesional, të bëhen ato të hapura e të mundshme për çdo fëmijë dhe të merren masa të përshtatshme, si vendosja e arsimit falas dhe dhënia e një ndihme financiare në rast nevojë;*
- (c) *T'u sigurohet të gjithëve arsimi i lartë, sipas aftësive të secilit, me të gjitha mjetet e përshtatshme;*
- (d) *Të bëhet i mundshëm dhe i arritshëm për çdo fëmijë informacioni dhe orientimi shkollor e profesional;*
- (e) *Të merren masa për të inkurajuar vijueshmërinë e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.*

Që atëherë, e drejta për arsimim është njohur gjerësisht dhe është zhvilluar më tej nga një numër instrumentesh normative ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara.

Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim e miratuar në Konferencën e Katërt Botërore për Gratë në Pekin më 1995, ishte zotim ndaj të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave *“për të siguruar zbatimin e plotë të të drejtave njerëzore të grave dhe të vajzave të mitura si pjesë e patjetërsueshme, tërësore dhe e pandashme e të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”*.³⁷ Pjesë qenësore e këtyre teksteve është e drejta për arsimim, pasi qasja në arsimim është një parakusht për arritjen e barazisë dhe të drejtave të tjera themelore të njeriut.

Korniza e Dakarit për Veprim e vitit 2000 e miratuar nga Forumi Botëror i Arsimit u zotua për arritjen e **Arsimit për të Gjithë**. Për realizimin e arsimit si e drejtë themelore e njeriut, u vendosen synimet e mëposhtme:³⁸

- (i) *zgjerimi dhe përmirësimi i kujdesit dhe arsimit gjithëpërfshirës në fëmijërinë e hershme, në veçanti për fëmijët më të lëndueshëm dhe më të pa-favorizuar;*

(ii) *sigurimi që deri në vitin 2015 të gjithë fëmijët, në veçanti vajzat, fëmijët në rrethana të vështira dhe ata që u përkasin pakicave etnike, të kenë qasje dhe të përfundojnë shkollimin e detyrueshëm fillor të cilësisë së mirë;*

(iii) *sigurimi që nevojat e të nxënësve të të gjithë rinjve dhe të rriturve të plotësohen me përmes qasjes së barabartë në programe të përshtatshme të të nxënësve dhe të aftësive për jetë;*

(iv) *arritja e përmirësimit prej 50 për qind në nivelet e shkrim-leximit të të rriturve deri në vitin 2015, në veçanti për gratë, si dhe e qasjes së barabartë në arsimin themelor dhe të vazhdueshëm për të gjithë të rriturit;*

(iv) *eliminimi i pabarazive gjinore në arsimin fillor dhe të mesëm deri në vitin 2005, si dhe arritje e barazisë gjinore në arsim deri në vitin 2015, me theks në sigurimin e qasjes së plotë dhe të barabartë të vajzave, si dhe arritshmërinë e tyre, në arsim themelor të cilësisë së mirë; (vi) përmirësimi i të gjitha aspekteve të cilësisë së arsimit dhe sigurimi i ekselencës së të gjithëve ashtu që rezultatet e njohura dhe të matshme të të nxënësve të arrihen nga të gjithë, veçanërisht në shkrim-lexim, njohuri themelore matematikore dhe aftësitë themelore për jetë*

Më 10 dhjetor të vitit 2004, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara shpalli **Programin Botëror mbi Edukimin për të Drejtat e Njeriut (2005-në vazhdim)** për të avancuar zbatimin e programeve të arsimit për të drejtat e njeriut në të gjithë sektorët. Ai synon të promovojë të kuptuarit e përbashkët të parimeve themelore dhe metodologjive të arsimit për të drejtat e njeriut, të ofrojë një kornizë konkrete për veprim dhe të fuqizojë partneritetet dhe bashkëpunimin nga niveli ndërkombëtar deri në nivelet më rrënjësore.³⁹

Arsimimi për të drejtat e njeriut mund të përkufizohet si arsimim, trajnim dhe informim që synon krijimin e një kulture universale të të drejtave të njeriut përmes bashkëndarjes së njohurive, dhënies së aftësive dhe formësimit të qëndrimeve të cilat synojnë:

- *forcimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore,*

³⁶ Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës 1989). Marrë nga <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.asp>

³⁷ Konferenca e Katërt Botërore për Gratë në Pekin (1995) Marrë nga <http://www.un.org/womenwatch/daw/daw/index.html>

³⁸ Korniza për Veprim e Dakarit 2000, (2000) UNESDOC, UNESCO. Marrë nga <http://unesdoc.unesco.org/images/0012/001211/121147e.pdf>

³⁹ Programi Botëror për Arsimin për të Drejtat e Njeriut (2005) UNHCR. Marrë nga <https://www.ohchr.org/en/issues/education/training/pages/programme.aspx>

- zhvillimin e plotë të karakterit të njeriut dhe të ndjesisë së dinjitetit të tij,
- promovimin e mirëkuptimit, tolerancës, barazisë gjinore dhe miqësisë ndërmjet të gjithë popujve indigjenë të kombeve dhe grupeve raciale, kombëtare, etnike, fetare dhe gjuhësore,
- mundësimin e të gjithë personave që të marrin pjesë në mënyrë efektive në një shoqëri të lirë dhe demokratike të qeverisur nga sundimi i ligjit,
- ndërtimin dhe mbajtjen e paqes ,
- promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe drejtësisë sociale që vendos njeriun në qendër.

Deklarata e Mijëvjeçarit e Kombeve të Bashkuara e nënshkruar në shtator të vitit 2000 i obligon udhëheqësit botërorë që të luftojnë varfërinë, urinë, sëmundjet, analfabetizmin, shkatërrimin e mjedisit dhe diskriminimin ndaj grave. OZHM-të përbënin një kornizë të ndërvarur të objektivave dhe treguesve specifikë, që janë dizajnuar për të ndikuar dhe mbështetur njëri-tjetrin, për shembull, barazia gjinore të ndikojë, mes të tjerave, në arsimin fillor universal dhe në shëndet. Tetë objektiva zhvillimore të mijëvjeçarit u identifikuan, me caqe dhe indikatorë specifikë:⁴⁰

1. zhdukja e varfërisë së skajshme dhe urisë,
2. arritja e arsimit fillor universal,
3. promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave,
4. zvogëlimi i vdekshmërisë të foshnjat e porsalindura,
5. zvogëlimi i vdekshmërisë së nënave gjatë lindjes,
6. lufta kundër HIV/AIDS, malaries dhe sëmundjeve të tjera,
7. sigurimi i qëndrueshmërisë së mjedisit, dhe
8. zhvillimi i partneritetit global për zhvillim.

Duke u bazuar në suksesin dhe dështimet e OZhM-ve, Kombet e Bashkuara përcaktuan më tej **Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ)** në kuadër të të cilave përfshihen 17-të objektiva që pasqyrojnë sfidat globale e të cilat duhet arritur deri në vitin 2030-të. Në mesin e tyre, objektivat 2, 3 dhe 6 janë të ndërlidhura me arsimin, si në vijim:⁴¹

2. sigurimi që deri në vitin 2015 të gjithë fëmijët, në veçanti vajzat, fëmijët në rrethana të vështira dhe ata që u përkasin pakicave etnike, të kenë qasje dhe të

përfundojnë shkollimin e detyrueshëm fillor të cilësisë së mirë,

3. sigurimi që nevojat e të nxëniet të gjithë të rinjve dhe të rriturve të plotësohen me anë të qasjes së barabartë në programe të përshtatshme të të nxëniet dhe të aftësive për jetë,
6. përmirësimi i të gjitha aspekteve të cilësisë së arsimit dhe sigurimi i përsosmërisë së të gjithëve ashtu që rezultatet e njohura dhe të matshme të të nxëniet të arrihen nga të gjithë, veçanërisht në shkrim-lexim, njohuri themelore matematikore dhe aftësitë themelore për jetë.

Për arritjen e qëllimit të barazisë gjinore duhet të zbatohen dhe të monitorohen një numër i caktuar masash, programesh, politikash dhe projektesh për të siguruar që gratë të mos jenë në pozitë më pak të favorshme sesa burrat. OKBESHK-ja luan një rol të madh për promovimin e të drejtës për arsimim dhe mbështetjen e përmblotjes së Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ). Me anë të Kornizës për Veprim në Arsim 2030, OZhQ 4 synon të sigurojë arsimim cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë, si dhe të promovojë mundësitë e të mësuarit gjatë gjithë jetës për të gjithë dhe që OZhQ 5 të arrijë barazinë gjinore dhe të fuqizojë të gjitha gratë dhe vajzat. Agjenda për Arsim 2030 e merr parasysh që barazisë gjinore i duhet një qasje e cila siguron që “vajzat dhe djemtë, gratë dhe burrat jo vetëm të kenë qasje dhe të përfundojnë ciklet e arsimit, por edhe të fuqizohen në mënyrë të barabartë përmes arsimit.”⁴²

Konteksti kombëtar

Ndonëse Kosova nuk është ende pjesë e organizatave ndërkombëtare dhe kërkesave ndërkombëtare për shkak të statusit të saj, përpjekjet drejt barazisë gjinore kanë zënë vend në kornizën e saj legjislativë dhe politike, në aktivitetet e organizatave të shoqërisë civile, agjendën e ndihmës për zhvillimin e komunitetit ndërkombëtar dhe përfaqësimin medial 11 (Shih Shtojcën 2-Përmbledhje e Ligjeve dhe Politikave të Kosovës mbi Gjininë). Kushtetuta e Republikës së Kosovës e vitit 2008 në nenin 7 [Vlerat]⁴³ përcakton qartë se:

⁴⁰ Objektivat zhvillimore të mijëvjeçarit të OBSH-së (2000). Marrë nga http://www.who.int/topics/millennium_development_goals/about/en/

⁴¹ Objektivat për zhvillim të qëndrueshëm (2016) Kombet e Bashkuara. Marrë nga <https://www.un.org/sustainabledevelopment/sustainable-development-goals>

⁴² UNESCO Arsimit dhe Barazia Gjinore. Marrë nga <https://en.unesco.org/themes/education-and-gender-equality>

⁴³ Kushtetua e Republikës së Kosovës 2008. Marrë nga <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>

“Republika e Kosovës konsideron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat e tjera të jetës shoqërore.”

Gjithashtu, Ligji për Barazi Gjinore i vitit 2015 përcakton në nenin 21⁴⁴ rolin e arsimit dhe barazisë gjinore si vijon:

1. Në shkolla dhe institucione të tjera arsimore mjetet mësimore të përdorura duhet të bazohen në barazinë gjinore dhe edukimin për barazinë gjinore duhet përfshirë në kurrikulat shkollore në të gjitha nivelet.
2. Përgatitja, miratimi dhe zbatimi i programit arsimor – edukativ, hartimit të materialeve, teksteve shkollore dhe rishikimit të materialeve dhe teksteve ekzistuese duhet të bëhet me përfshirjen e perspektivës gjinore dhe eliminimin e stereotipave negativë, paragjyimeve, praktikave zakonore dhe praktikave tjera, që janë në kundërshtim me parimin e barazisë gjinore.
3. Përfshirja në programet e shkollave aktivitete edukative dhe trajnuese që synojnë sensibilizimin e të rinjve për barazinë gjinore dhe përgatitjen e tyre për qytetari demokratike.
4. Të ketë përfshirje të barabartë të femrave dhe meshkujve në trajnime të arsimit profesional dhe joprofesional dhe këshillimit për ato profesione të cilat konsiderohen tradicionalisht vetëm për femra dhe vetëm për meshkuj.⁴⁵

Gjinia dhe barazia janë pjesë e kornizës ligjore edhe në fushën e arsimit në Kosovë. Njëra prej objektivave strategjike kryesore të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021⁴⁶ me masa dhe indikatorë të qartë për bartësit e arsimit. Në kuadër të objektivit të pjesëmarrjes dhe gjithëpërfshirjes thuhet:

“Arsimi, përveç tjerash, është mjet për parandalimin e varfërisë, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, për fuqizimin e femrës dhe integritetin e secilit në shoqëri. Sipas OKBESHK-së, arsimi gjithëpërfshirës shihet si proces që adreson dhe i përgjigjet nevojave të ndryshme të të gjithë nxënësve, përmes rritjes së pjesëmarrjes në të nxënë duke reduktuar përjashtimin në arsim dhe nga arsimi.”

⁴⁴ Ligji Nr. 05/L-20 për Barazi Gjinore (2015), marrë nga <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/05-L-020%20a.pdf>

⁴⁵ Ligji Nr. 05/L-20 për Barazi Gjinore (2015), marrë nga <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/05-L-020%20a.pdf>

⁴⁶ Planit Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021 (2016) Marrë nga <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-kesp-2017-2021.pdf>

⁴⁷ Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (2011) Ligji Nr. 04/L-032 Marrë nga

Ligji për Arsimin Parauniversitar ⁴⁷ e përcakton barazinë gjinore jo vetëm si qëllim, por edhe si parim të përgjithshëm që ndihmon sipas nenit 4 në planifikimin, menaxhimin dhe organizimin e sistemit të arsimit para-universitar. Ministria, komunat dhe institucionet e arsimit dhe/ose të aftësisimit duhet t’u kushtojnë rëndësi normave të pranuar ndërkombëtarisht të *Arsimit për të Gjithë*, të drejtave të fëmijës, mbrojtjes së grupeve të cënueshme brenda shoqërisë dhe promovimit të barazisë gjinore. Për më tepër, Ligji për Botimin e Teksteve Shkollore dhe Standardet për Tekstet Shkollore⁴⁸ theksojnë rëndësinë e analizës gjinore dhe të shmangies së animeve gjinore në tekstet shkollore në standardin 11.

“Teksti shkollor kontribuon në edukimin për barazinë e gjinive dhe në shmangien e diskriminimit të lidhur me gjininë si dhe roleve të ndërlidhura me gjininë. Në mënyrë të drejtpërdrejtë, kjo ndihmesë mund të jepet nga tekstet shkollore të disa lëndëve (libra leximi, tekste shkollore të etikës, historisë, të shkencave shoqërore) nëpërmjet zgjedhjes së përshtatshme të shkrimeve, pyetjeve dhe detyrave. Në mënyrë të tërthortë, të gjitha tekstet shkollore mund dhe duhet ta plotësojnë këtë standard duke u kujdesur a) nga ana gjuhësore të respektohen të dyja gjinitë (përdorimi i trajtave femërore dhe mashkullore; p.sh. nxënës/e) dhe b) që në tekstet, ilustrimet, detyrat etj. femra dhe meshkuj të jenë përfaqësuar në mënyrë të barabartë dhe jo sipas stereotipeve të roleve tradicionale.”

Korniza e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar Kosovës (KKK)⁴⁹ është një nga politikat më të rëndësishme të miratuara në vitin 2011. Është reforma më gjithëpërfshirëse sa i përket përmbajtjes dhe strukturës së arsimit parauniversitar nga klasa e parë deri në klasën e 12-të. (shih Shtojcën 3, Ndryshimet në Sistemin e Arsimit me Kurrikulën e Re dhe Shtojcën 4, Rezultatet e Mësimnxënies).

Ndryshimi kryesor në kurrikulën e re është kalimi nga kurrikula e bazuar në njohuri në atë të orientuar kah rezultatet për të zhvilluar aftësitë e nxënësve, para së gjithash të menduarit kritik. Kurrikula e bazuar në kompetenca shkon përtej konceptit tradicional të njohurive, në një kapacitet të përgjithshëm për të mësuar dhe zbatuar njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet, shprehitë, vlerat dhe emocionet në mënyrë të pavarur, praktike dhe kuptimplote. Nga

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20preuniversity%20education.pdf>

⁴⁸ Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë UA (2011) Standardet për Tekste Shkollore. Marrë nga <http://masht.rks-gov.net/uploads/201>

⁴⁹ Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (2011) Marrë nga <https://masht.rks-gov.net/korniza-e-kurrikules-e-arsimit-parauniversitar>

këndvështrimi i përqendruar tek nxënësi dhe i bazuar në kompetenca, ajo synon ta shndërrojë mësimdhënien dhe mësimnxënien në një proces më kritik dhe krijues, si dhe vënien në përdorim të materialeve dhe burimeve të ndryshme për të motivuar dhe stimuluar përparimin e nxënësit në mënyrë më kuptimplote. Kompetencat kryesore të parapara si qëllime për sistemin e arsimit parauniversitar në të gjitha nivelet, klasat dhe lëndët janë (f.15):

- *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit*
- *Kompetenca e të menduarit*
- *Kompetenca e të mësuarit*
- *Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis*
- *Kompetenca personale*
- *Kompetenca qytetare.*

Një nga parimet që mbështet zhvillimin dhe zbatimin e Kornizës Kurrikulare të Kosovës është gjithëpërfshirja, si parim që i referohet të drejtës së çdo fëmije për qasje të barabartë në arsim (f. 22).

- *Mësimnxënia që reflekton përvojat dhe informacionet paraprake të nxënësve; interesimet, potencialin dhe mundësitë e tyre;*
- *Mësimnxënia kuptimplote (p.sh. mësimnxënia e orientuar në zgjidhje të problemeve praktike nga përditshmëria jetësore), dhe*
- *Përfshirja aktive e nxënësve në përzgjedhjen dhe planifikimin e përvojave të të nxënësve, duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e përvojave të caktuara dhe në gjendje për të vlerësuar dhe për të vetëvlerësuar rezultatet vetjake të të nxënësve.*

Kurrikula e re gjithashtu ka përcaktuar fushat e kurrikulës që përbëjnë bazën për organizimin e procesit edukativo-arsimor në shkollë në nivele dhe shkallë përkatëse të Kurrikulës të renditura më poshtë (shih Shtojcën 3, Ndryshimet në Sistemin e Arsimit me Kurrikulën e Re).

- *Gjuhët dhe komunikimi*
- *Arti*
- *Matematika*
- *Shkencat natyrore*
- *Shoqëria dhe mjedisi*
- *Edukimi fizik, Sporti dhe Shëndeti*
- *Jeta dhe puna.*

Secila fushë e kurrikulës ka rezultatet e saj mirë të përcaktuara të mësimnxënies që shërbejnë si bazë për ndryshimin e përmbajtjes dhe procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies si dhe arritjen e kompetencave kryesore. Ndonëse konsiderohet se librat nuk janë burimi i vetëm i njohurive, megjithatë institucionet arsimore në Kosovë, ofrojnë burime të pakta ose nuk ofrojnë burime të tjera për zhvillimin e njohurive.

Për momentin, ato mbeten burimi kryesor dhe më i rëndësishëm për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Përderisa përgatitjet për tekstet e reja shkollore vazhdojnë dhe gjithmonë do të ketë zhvillime në këtë lëmi, është e udhës që t'i përcjellim përmbajtjet e tyre me vëmendje dhe të shmangim paragjykimet gjinore dhe diskriminimin, si dhe të integrojmë barazinë gjinore në to, duke ndikuar kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë në mësimdhënien dhe mësimnxënien e re në përputhje me kërkesat e reja të kurrikulumit⁵⁰. (Shih Shtojcën 4, Rezultatet e të Nxënësve.)

Në Kosovë, ekzistojnë edhe manuale të cilat ofrojnë informacion dhe udhëzime mbi konceptet gjinore dhe barazinë të hartuara nga GIZ dhe CARE International për të ndihmuar bashkësinë arsimore për të kuptuar konceptet gjinore dhe zbatimin e tyre. Manuali udhëzues përgatitur nga Care International në Ballkan, Programi “R – Të Rinjtë” është një udhëzues për arsimtarët dhe punonjësit për punë me të rinjtë. Është një mjet i fokusuar në adresimin e pabarazive gjinore, praktikave të dëshme shëndetësore dhe dhunës së përditshme për djem dhe vajza në komunitet dhe shkollë nga mosha 14-19 vjeç.

Manuali “R- për të rinjtë”, si manual trajnues ka si qëllim promovimin e e barazisë gjinore dhe një stili jete të shëndetshëm për të rinjtë dhe të rejat dhe adreson disa prej ndërtime sociale të maskulinitetit dhe feminitetit. Manuali shërben trajnimin të të rinjve dhe të rejave nga mosha 14-të deri në 19-të vjet. Është i dobishëm për arsimtarët e arsimit të mesëm, punonjësit e punës me të rinj dhe profesionistët që punojnë me djem e vajza, burra dhe gra që kanë si qëllim të japin një kontribut ndaj atyre që punojnë për realizimin e zhvillimit të shëndetshëm të të rinjve dhe të të rejave.

⁵⁰ Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (2011) Marrë nga <https://masht.rks-gov.net/korniza-e-kurrikules-e-arsimit-pauniversitar>

KAPITULLI II

PËRFAQËSIMI GJINOR NË TEKSTET SHKOLLORE

i. Konceptet e gjinisë dhe seksit

Në mënyrë që të kemi një proces të planifikuar mirë dhe të kujdesshëm të analizës së teksteve shkollore nga perspektiva gjinore, është e rëndësishme që fillimisht aspektet konceptuale lidhur me gjininë në arsim të kuptohen plotësisht (Georgescu et al, 2010).⁵¹ Në shumicën dërmuese të shoqërive, gjinia pa dyshim paraqet një diferencim dhe kategorizim që ndodh që nga lindja. Pavarësiht nga kjo,

dallimet dhe kategorizimet ngrihen mbi bazën e dallimeve anatomike/biologjike si dhe ato sociale. Për të kuptuar më mirë kategorizimin themelor të grave dhe burrave në të gjitha shoqëritë, duhet të kuptojmë dy konceptet kryesore; seksin dhe gjininë (Brugailles dhe Cromer, 2009, f.27) ⁵² të cilat tregojnë dallimet kryesore në të cilat bazohen kategorizimet gjinore. (shih Shtojcën 1, Fjalorth mbi Konceptet Gjinore)

“Seksi” u referohet dallimeve biologjike në mes të femrës dhe mashkullit. Ai përshkruan dallimin e dukshëm në mes të organeve të tyre gjinitale dhe funksioneve fiziologjike të tyre në shumim.

“Gjinia” ndërlidhet me kulturën dhe me ndarjen shoqërore në “mashkullor (maskulin)” dhe “femëror (feminin)”. Prandaj, gjinia ka të bëjë me cilësitë, shijet, dhuntitë, rolet dhe përgjegjësitë që u vishen burrave dhe grave në një shoqëri. Përkufizimet për “mashkullor” dhe “femëror” ndryshojnë shumë, duke treguar origjinën e tyre sociale, pasi që çdo shoqëri krijon klasifikimin e saj në bazë të kriterëve dhe parimeve të veta. Konceptet e maskulinitetit dhe feminitetit nuk zhvillohen në mënyrë të pavarur, por varen reciprokisht nga njëri-tjetri.

Promovimi i Barazisë Gjinore përmes Teksteve Shkollore, Udhëzues Metodologjik i UNESCO-së (f.27)

Përderisa koncepti i seksit lidhet në veçanti me dallimet biologjike dhe anatomike, gjinia është koncept më kompleks. Gjinia ka të bëjë me përkufizimet shoqërore që lidhen me të qenit femër apo mashkull, me marrëdhëniet ndërmjet burrave dhe grave, djemve dhe vajzave, si dhe marrëdhënieve në mesin e vetë grupit të grave dhe vetë burrave krijohen nga shoqëria dhe mësohen nëpërmjet shoqërizimit. Gjinia nuk përshkruan karakteristikat biologjike dhe seksuale që identifikojnë burrat dhe gratë, por shërben për të përcaktuar rolet, qëndrimet dhe vlerat shoqërore të burrave dhe grave të cilat shoqëria ia mveshë dhe/ose atribuon përfaqësuesve të saj duke marrë për bazë gjininë e tyre.

Për shkak të kategorizimit gjinor, gratë dhe burrat dhe/ose vajzat dhe djemtë pritet të bëjnë gjëra të caktuara, të kenë qëndrime dhe sjellje të caktuara që i ndjekin gjatë gjithë jetës së tyre. Të drejtat e tyre dhe pozitat e tyre sociale, ekonomike

dhe politike ndryshojnë dhe shpesh bëhen ekskluzive nga fëmijëria e tyre deri në moshën madhore. Bazuar në modelet gjinore, detyrat dhe rolet e tyre janë të qarta, aftësitë e tyre etiketohen si femërore apo mashkullore, ato nuk pozicionohen në mënyrë të drejtë në sferën private dhe publike dhe i përkasin pozitës superiore ose inferiore në një shoqëri.

Dallimet gjinore kanë të bëjnë me kulturën dhe rrjedhimisht me një gjuhë, religjion dhe traditë specifike, por edhe me një etnicitet, racë, moshë, prejardhje sociale dhe gjeografike specifike dhe së fundi, por jo më pak e rëndësishme, me edukimin individual. Dallimet gjinore shpesh bazohen në perceptimet që kemi në lidhje me të tjerët që në të shumtën e rasteve janë paragjykime, gjykime dhe perceptime. Për këtë arsye, dallimet gjinore përforcojnë diskriminimin, marginalizimin dhe dhunën bazuar në bindjen se 'tjetri' është inferior ose kërcënues ose në disa raste, të dyja bashkë.

⁵¹ Georgescu, D. et al (2010) Guidelines for Textbook Reviews and Analysis from a Gender Perspective. (Udhëzime për Recensimin dhe Analizën e Teksteve Shkollore nga Perspektiva Gjinore) UNESCO Hanoi, IBE dhe MOET, Gjenevë. Marrë nga <https://docs.iiep.unesco.org/peic/2748.pdf>

⁵² Brugailles, C., & Cromer, S. (2009) Promoting Gender Equality Through Textbooks, A Methodological Guide (Promovimi i Barazisë Gjinore përmes Teksteve Shkollore, Udhëzues Metodologjik). UNESCO, Paris. Marrë nga https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000158897_eng

Njëanshmëritë shpesh konsiderohen si gabime në gjykim që mund të shkaktohen nga tendencat për të nxjerrë konkluzione të parakohshme në bazë të informatave të pamjaftueshme ose jorelevante, opinioneve të atypëratyshme të padiskutueshme (Georgescu et al, 2011)⁵³ dhe bindjeve të ngulitura thellë e të padiskutueshme.

Pabarazia gjinore ka një ndikim negativ tek individët. Pabarazia ndaj individëve mund të sjellë vetëbesim të ulët, irritim dhe fyerje dhe të pengojë një djalë ose një vajzë, një grua ose një burrë që të arrijë potencialin e tij/saj të plotë dhe të luajë rolin e tij/saj në familje dhe shoqëri për shkak të pritjeve të paragjykuara që u janë mveshur atyre. Pabarazia pengon në lirinë e individit për të qenë të vërtetë ndaj vetes dhe për të bërë zgjedhje drejt zhvillimit dhe mirëqenies së tyre personale. Pabarazia gjinore ndikon edhe më shumë në marrëdhëniet midis individëve dhe si rrjedhim ndikon në masë të madhe funksionin dhe rritjen familjare, dhe çdo përparim të komunitetit dhe shoqërisë. Në një familje, ajo mund të japë shembuj negativë dhe të legjitimojë trajtimin ose shfrytëzimin e padrejtë të anëtarëve të familjes nga njëritjetri. Në nivel të shoqërisë, pabarazia mund të pengojë rritjen ekonomike, kohezionin social dhe drejtësinë sociale (Georgescu et al, 2010).⁵⁴

Rolet dhe identitetet gjinore shprehin besime dhe bindje që sigurisht janë të nxitura nga kultura, sepse ato pasqyrojnë interpretimet e ndryshme të shoqërive të ndryshme. Siç edhe theksojnë studimet gjinore: "...gjinia, përderisa përbën një konstrukt shoqëror, nuk është diçka e palëvizshme, por diçka që ndryshon sipas kohës, vendit dhe kulturës. Të qenit grua dhe të qenit burrë në ditët e sotme nuk është e njëjtë si në kohën e Egjiptit të lashtë ose të Evropës mesjetare; as marrëdhëniet midis gjinive nuk janë të njëjta në Britani, në Arabinë Saudite apo në Indi (Bradley 2013)."⁵⁵ Më tej, studimet shoqërore, antropologjike dhe gjinore tregojnë, mes disiplinave të tjera, se komunitetet anëmbanë botës kanë bindjet e tyre mbi burrat dhe gratë, "feminitetin" dhe "maskulinitetin". Pë shembull, gjatë studimit të shoqërive tradicionale, M. Mead vuri re se "... një fis filipinas (beson) se

asnjë burrë nuk mund të mbajë një sekret, apo se supozimin e etnisë Manus që vetëm burrave u pëlqen të luajnë me foshnjat, ose supozimet e etnisë Toda se të gjitha punët shtëpiake janë shumë të shenjta për gratë, apo për insistimin e Arapeshëve se gratë janë më kokëforta se burrat."⁵⁶ Ndërkohë, e kundërta mund të thuhet në rastin e shoqërive perëndimore dhe shoqërive bashkëkohore që besojnë se gratë flasin më shumë se burrat, kanë ndjenjë amënore dhe janë më të mira në punët shtëpiake, etj. (Brugilles dhe Cromer 2009).⁵⁷ Duke qenë kështu, bindjet gjinore, rolet dhe identitetet gjinore ndikohen nga faktorë të shumtë siç janë ndryshimi i kushteve në mjedis, zhvillimet historike, regjimet politike, zhvillimi socio-ekonomik, proceset kulturore, normat fetare dhe zhvillimi i teknologjisë të cilat i përjetojnë shoqëritë.

Rolet dhe marrëdhëniet e individëve në shoqëri diktojnë se kush përfshihet dhe kush përjashtohet nga shoqëria dhe se si vlerësohen nga shoqëritë aktivitetet që kryejnë individët. Kjo përcakton shkallën dhe llojet e përjashtimit të burrave dhe grave në shoqëri dhe shkallën e aftësive të tyre për të gëzuar të drejtat e tyre të qytetarisë dhe për të përmbushur detyrimet e tyre. Duhet të theksohet se rolet dhe marrëdhëniet gjinore përcaktojnë marrëdhëniet e pushtetit dhe balancat midis anëtarëve të shoqërisë. Këto marrëdhënie ndryshojnë dhe zhvendosen vazhdimisht. Megjithatë, gratë në nivel global, kur krahasohen me burrat, janë në pozicione të pafavorshme si në pushtet, ashtu edhe në qasjen në burime. Gjithashtu, kur aspekti gjinor kombinohet dhe me përkatësinë e tilla si etnike, racore, fetare, aftësitë e kufizuara dhe dallimet klasore, gratë vuajnë nga përjashtimi i dyfishtë ose i shumëfishtë dhe diskriminimi. Meqenëse konceptet gjinore janë formime kulturore, ato gjithashtu janë objekt i ndryshimit dhe transformimit. Ndryshimi për të pasur barazi gjinore matet më së miri nga barazia e mundësive për gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë dhe barazia e rezultateve. Barazia gjinore në përgjithësi synon të sigurojë që të diskriminuarit, qofshin gra apo burra, të jenë të barabartë. Në veçanti, fokusi i saj është tek gratë për të vetmen arsye se në

⁵³ Georgescu, D. et al (2010) Guidelines for Textbook Reviews and Analysis from a Gender Perspective (Udhëzime për Recensimin dhe Analizën e Teksteve Shkollore nga Perspektiva Gjinore). UNESCO Hanoi, IBE dhe MOET, Gjenevë. Marrë nga <https://docs.iiep.unesco.org/peic/2748.pdf>

⁵⁴ Georgescu, D. et al (2010) Guidelines for Textbook Reviews and Analysis from a Gender Perspective (Udhëzime për Recensimin dhe Analizën e Teksteve Shkollore nga Perspektiva Gjinore). UNESCO Hanoi, IBE dhe MOET, Gjenevë. Marrë nga <https://docs.iiep.unesco.org/peic/2748.pdf>

⁵⁵ Bradley, H. (2013) *Gender. Key Concepts (Gjinia. Konceptet kyçe)*.

⁵⁶ Mead, M. (1977). *Seksi dhe temperamenti në tri shoqëri primitive*, London dhe Henley, Routledge & Kegan Paul, f. xix, siç citohet në Brugilles, C., & Cromer, S. (2009) Promovimi i Barazisë Gjinore përmes Teksteve Shkollore, Udhëzues Metodologjik, UNESCO, Paris. Marrë nga https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000158897_eng.


⁵⁷ Brugilles, C., & Cromer, S. (2009) Promoting Gender Equality Through Textbooks, A Methodological Guide (Promovimi i Barazisë Gjinore përmes Teksteve Shkollore, Udhëzues Metodologjik), UNESCO, Paris. Marrë nga https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000158897_eng

shumicën e shoqërive, gratë janë vendosur në një rol të dorës së dytë dhe janë tejësisht të përjashtuara. Barazia gjinore synon të sjellë barazi duke i vendosur gratë në atë pozitë që të kenë një pjesë të barabartë në përfitime dhe përgjegjësi sociale, trajtim të barabartë sipas ligjit, qasje të barabartë në shërbimet sociale, arsim, punë dhe çdo aspekt të jetës që ende paraqet si një sfidë. Sidoqoftë, barazia nuk i lë mënjanë burrat në rastet kur ka diskriminim ndaj burrave. Për më tepër, edhe të folurit për burrat dhe gratë si një kategori e vetme është tejte i thjeshtëzuar pasi këto kategori nuk duhen parë si monolitike.

Prandaj, politikat kombëtare dhe iniciativat lokale shpesh përbëjnë arenën dhe instrumentet më efektive për promovimin dhe arritjen e barazisë gjinore dhe të drejtave qytetare të grave. Politikat e arsimit dhe instrumentet e tyre të ndërlidhura me politikat, në veçanti shkollat dhe tekstet shkollore janë vendet dhe mjetet më të spikatura ku transformimi i roleve gjinore, identiteteve dhe marrëdhënieve të pushtetit mund të adresohen në mënyrë adekuate. Mësimdhënësit dhe nxënësit mund të përdorin hapësirën dhe përmbajtjen për të demonstruar besimet dhe normat e tyre, për të marrë informata, për të debatuar konceptet dhe faktet dhe për të sfiduar bindjet e tyre për rolet dhe identitetet gjinore. Ata kanë mundësi të mjaftueshme që të krijojnë njohuritë e tyre dhe t'i praktikojnë ato. Proceset e mësimdhënies dhe mësimnxënies janë thelbësore për të qartësuar mëdyshjet, për të mësuar dhe/ose rimësuar lidhur me barazinë e burrave dhe grave dhe përfaqësimin e drejtë të kategorive gjinore. Në aspektin e të

kuptuarit të njerëzve dhe kategorizimin e tyre sipas gjinisë, ata duhet të shmangin paragjykimet (karakterizim i rremë dhe i padrejtë i bazuar në gjini), stereotipet, bindjet e ngulitura dhe të padiskutueshme në mënyrë që të arrihet barazia. Në këtë mënyrë, tekstet shkollore duhet të shmangin 'pikëpamjet e thjeshtuara të karakteristikave që u atribuohen personave, grupeve, objekteve dhe situatave, bazuar në përgjithësime të rreme' dhe, në vend të kësaj, duhet të promovojnë një koncept të nuancuar 'shumështresor' të identitetit/identiteteve që shkaktohen nga faktorë të shumfaktshëm individual dhe kolektiv, të tillë si gjenet, mjedisi, zhvillimet historike dhe proceset socio-ekonomike dhe kulturore (Georgescu et al, 2010).⁵⁸

Në shumicën e rasteve, përmbajtja e teksteve shkollore bëhet strehë e animeve gjinore, paragjytimeve dhe besimeve në përmbajtje, por gjithashtu rivendosin dhe përfaqësojnë norma dhe rregulla të shoqërisë pa njohuri dhe mundësi të barabarta mes nxënësve. Për më tepër, ato ndikojnë dhe kufizojnë vizionin e nxënësve, të djemve dhe të vajzave, mbi atë se kush ata janë dhe se çfarë mund të bëhen në të ardhmen. Megjithatë, të zbuluarit, ndryshuarit dhe të këmbëgullurit për të përfshirë të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore në tekstet shkollore nuk është diçka e lehtë për t'u kryer. Njëanshmëria dhe diskriminimi nuk paraqiten në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të qartë në përmbajtje. Në të shumtën e rasteve, elementët e pabarazisë fshihen përgjatë gjithë përmbajtjes së teksteve shkollore dhe shfaqen në forma të ndryshme të listuara më poshtë (Blumberg, 2007, f. 11):⁵⁹



⁵⁸ Georgescu, D. et al (2010) Guidelines for Textbook Reviews and Analysis from a Gender Perspective (Udhëzime për Recensimin dhe Analizën e Teksteve Shkollore nga Perspektiva Gjinore). UNESCO Hanoi, IBE dhe MOET, Gjenevë. Marrë nga <https://docs.iiep.unesco.org/peic/2748.pdf>

⁵⁹ Blumberg, R. L. (2007). "Gender Bias in Textbooks: A hidden obstacle on the road to gender equality in education" (Animi gjinor në tekstet shkollore:

Një pengesë e fshehur në rrugën drejt barazisë gjinore në arsim). UNESCO, Gjenevë EFA-GMR. Cituar në Georgescu, D. et al (2010) Udhëzime për Recensimin dhe Analizën e Teksteve Shkollore nga Perspektiva Gjinore. UNESCO Hanoi, IBE dhe MOET, Gjenevë. Marrë nga <https://docs.iiep.unesco.org/peic/2748.pdf>

Tekstet shkollore nuk duhet të japin idenë se arsimimi i një grupi është më i rëndësishëm se arsimimi i një grupi tjetër, duke favorizuar djemtë. Kjo mund të ndikojë në arritjet e tyre akademike, zgjedhjet dhe përvojën arsimore në tërësi (Brugilles dhe Cromer 2009).⁶⁰ Tekstet shkollore duhet t'i ofrojnë secilit nxënës mundësinë për të kuptuar konceptet gjinore dhe modalitetet e tyre ekspozuese në të gjitha lëndët e mësuara dhe në tekstet shkollore përkatëse. Për më tepër, ata kanë mundësi të mësojnë, të jenë të hapur dhe tolerantë ndaj identiteteve të tjera të ndryshme nga ato të tyre.

ii. Qasjet metodologjike në analizimin e sistemit gjinor në tekstet shkollore

Analizimi i teksteve shkollore nga perspektiva gjinore dhe ekspozimi i seksizmit, stereotipeve gjinore dhe zbulimin ekzistenca e njëanshmërive ndaj grave është një detyrë komplekse. Qasja metodologjike më e përdorur deri në fillim të viteve 1990-ta përqendrohej kryesisht në ekspozimin e stereotipave gjinorë, njëanshmërisë gjinore dhe elementëve diskriminuesë gjinorë. Analiza e teksteve shkollore është arritur përmes përdorimit të analizës kontekstuale, instrumenteve të kërkimit sasior dhe cilësor kryesisht duke u fokusuar në "të dukshmet" si karakteristikat dhe tiparet eksplicite të individëve të bazuar në gjini, duke numëruar numrin e karaktereve mashkullore dhe femërore dhe duke analizuar rolet në të cilat ato karaktere përshkruhen (Hartman dhe Judd, 1978)⁶². Në mënyrë të ngjashme, Porreca (1984) zhvilloi një analizë cilësore dhe sasore të përmbajtjes duke u përqendruar në proporcionin mashkull-femër në tekste dhe imazhe, në renditjen e referimit të burrave dhe grave, në profesione, dhe në shpeshtësinë e përdorimit të emrave dhe mbiemrave mashkullor dhe femëror.⁶³

Prandaj, zhvillimi i teksteve shkollore me bazë gjinore që nxisin barazinë gjinore mund të jetë një nga mënyrat kryesore për të ndërtuar një sistem arsimor më human, më tolerant dhe më egalitar. Tekstet shkollore, të cilat përfshijnë perspektivën gjinore, sigurojnë që barazia gjinore bëhet një "realitet në çdo mjedis mësimor, duke përfshirë diskutimet, marrëdhëniet mësimdhënës-nxënës, aktivitetet, detyrat dhe vlerësimet. Mësimdhënësi/mësimdhënësja duhet gjithashtu të jetë një shembull në promovimin e barazisë gjinore dhe në reduktimin e stereotipave të bazuara në gjini."⁶⁴

Sidoqoftë, siç na tregon dhe literatura, nga vitet 1990-ta pati një zhvendosje nga analiza e përmbajtjes në analizën gjuhësore. Analizat gjuhësore, të përdorura nga Hussain dhe Afsar (2010)⁶⁴, Gharbavi (2012)⁶⁵ dhe Hameed (2014)⁶⁶ përqendrohen në fjalorin e përdorur dhe në gramatikë, pra vetë gjuha - mënyra 'si' shprehet diçka - për të ekspozuar paragjykimin gjinor. Kjo metodë i mundëson analistëve që të përcaktojnë se cilët emra dhe përemra, mbiemra dhe folje përdoren për të përshkruar meshkujt dhe femrat dhe në çfarë pozite shfaqen ata në fjali për të zbuluar marrëdhëniet ndërmjet karaktereve. Analiza të tjera lidhur me konstatimin e njëanshmërisë gjinor përfshijnë ndër të tjera, analizën kritike të diskursit në të cilën, për shembull, analizohen dialogët (p.sh. Mustedanagic, 2010)⁶⁷ dhe analizën vizuale duke u fokusuar në përfaqësimin gjinor në imazhe (p.sh. Giaschi, 2000).⁶⁸

Vlen të theksohet se OJQ-të lokale në Kosovë janë përfshirë gjithashtu në analizën e teksteve shkollore dhe përfaqësimin gjinor duke përdorur metodat e mësipërme. Në vitin 2007,

⁶⁰ Brugilles, C., & Cromer, S. (2009) Promoting Gender Equality Through Textbooks, A Methodological Guide (Promovimi i Barazisë Gjinore përmes Teksteve Shkollore, Udhëzues Metodologjik), UNESCO, Paris. Marrë nga https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000158897_eng

⁶¹ UNESCO (2015) . A Guide for Gender Equality in Teacher Education Policy and Practice (Udhëzues për Barazinë Gjinore në Politikat dhe Praktikën e Arsimit të Mësimdhënësve.). Marrë nga <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000231646>

⁶² Hartman, P., & Judd, E. (1978, dhjetor). Sexism and TESOL Materials (Seksizmi dhe materialet TESOL). *TESOL Quarterly*, 12(4), 383-393. Marrë nga http://203.72.145.166/teso/teso%20I/TQD_2008/VOL_12_4.PDF#page=17

⁶³ Porreca, K.L., (1984). Sexism in current ESL textbooks (Seksizmi në tekstet aktuale shkollore ESL). *TESOL Quarterly*, 18(4), 705-724.

⁶⁴ Hussain, M. N., & Afsar, A. (2010). Language and Gender: Linguistic Analysis of Intermediate English Textbooks in Pakistan (Gjuha dhe gjinia: Analiza gjuhësore e teksteve shkollore të gjuhës angleze të nivelit të ndërmjetëm në Pakistan). *Gjuha në Indi*, 10, 26-36. Marrë nga <http://www.languageinindia.com/nov2010/gendertextbookpakistan.pdf>

⁶⁵ Gharbavi, A. (2012, mars). The Application of Functional Linguistics in Exposing Gender Bias in Iranian High School English Textbooks (Aplikimi i gjuhësisë funksionale në ekspozimin e animit gjinor në tekstet shkollore në shkollën e mesme iraniane). *Studime të Gjuhës dhe Letërsisë Angleze*, 2(9), 85-93.

⁶⁶ Hameed, A. (2014). Language and Gender: An Analysis of English Textbooks Produced by Punjab Textbook Board for Elementary Level in Pakistan (Gjuha dhe Gjinia: Një Analizë e Teksteve Shkollore të Gjuhës Angleze të përgatitura nga Bordi për Tekste Shkollore të Punjab për nivelin fillor në Pakistan). *Gazeta për Arsim dhe Praktikë*, 5(11). Marrë nga <https://iiste.org/Journals/index.php/JEP/article/download/12380/12695>

⁶⁷ Mustedanagic, A. (2010). *Gender in English Language and EFL Textbooks (Gjinia në gjuhën angleze dhe në tekstet shkollore EFL)*. (Tezë e studimeve të nivelit BA). Marrë nga <http://www.diva-portal.org/>

⁶⁸ Giaschi, P. (2000). *Gender Positioning in Education: A Critical Image Analysis of ESL Texts (Pozicionimi gjinor në arsim: Një analizë kritike e imazhit të teksteve ESL)*. Marrë nga baza e të dhënave ERIC (EJ616535)

Qendra për Arsim e Kosovës (QAK)⁶⁹ ndërmorri një studim me titullin “Barazia gjinore në libra e leximit në arsimin e detyrueshëm nëntëvjeçar”. Gjatë studimit u rishikuan librat e leximit të gjuhës shqipe të arsimit të detyrueshëm të klasave 1- 8. Nga 323 tekste të analizuara, vetëm 23 ose 7.12% prej tyre ishin të shkruara nga autore gra, ndërsa 233 ose 72.14% ishin të shkruara nga autorë burra, ndërkohë që 67 tekste nuk kishin autorë të cilësuar ose ishin anonimë (f.10). Për më tepër, analiza e portreteve, auto-portreteve dhe individëve tregonte epërsinë e meshkujve me 97.6% meshkuj dhe vetëm 2.4% femra (f. 14). Rolet profesionale të burrave në librat e leximit kishin një shkallë më të lartë të përfaqësimit, të pasqyruar në 187 raste ose 57.89% të totalit të teksteve shkollore të analizuara. Pas përpunimit statistikor u konstatua se nga 323 tekste të analizuara, në 278 apo 86.1% tekste nuk kishte asnjë paraqitje figurative të roleve profesionale të personazheve gra (f.15).⁷⁰

Një studim i kryer nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) në vitin 2007⁷¹ në tekstet shkollore për të identifikuar shkallën deri në të cilën pabarazia gjinore ishte e pranishme në tekst dhe ilustrim, përdori kryesisht metoda cilësore (grupeve të fokusit, intervistave dhe vëzhgimeve). Studimi synonte të përpikën të vlerësonte përfaqësimin gjinor në lëndë të ndryshme, si *Edukata Qytetare, Njeriu dhe Natyra, Aftësitë Jetësore, Gjuha dhe Letërsia Shqipe, Historia, Edukata Fizike, Matematika, Biologjia, Jeta dhe Puna, Abetarja të klasës 1, 3, 6, 9, 10, 12* përmes rishikimit të përmbajtjes së teksteve shkollore. Gjetjet e përgjithshme treguan se:

- në të gjitha tekstet shkollore të analizuara se profesionet dhe pozitat më të njohura për burrat dhe djemtë janë: doktorë, historianë, filozofë, matematikanë, shkrimtarë, punëtorë krahut, policë të trafikut, shoferë, zjarfikës, ushtarë, ndërsa profesionet në të cilat paraqiten gratë dhe vajzat janë mësimdhënëse, valltare, laborante, pastruese, këngëtare etj.,
- aktivitetet e fëmijëve të paraqitura në tekste shkollore reflektojnë pozita favorizuese dhe disfavorizuese

varësisht prej gjinisë. P.sh. vajza e vogël në shumicën e rasteve në tekstet shkollore është e prezantuar afër nënës së saj, ndërkohë që obligimet e saj rreth shtëpisë janë shumë më të mëdha krahasuar me vëllain e saj,

- në ilustrimet e teksteve shkollore më shumë i jepet hapësirë figurave të meshkujve se sa femrave. Në “Edukata Qytetare III” prej 151 figurave të përgjithshme të gjinive, 100 janë figura mashkullore, 51 femërore. “Edukata Qytetare V”, nga gjithsej 137, 89 prej tyre janë figura të gjinisë mashkullore, 48 janë të gjinisë femërore. “Edukata Qytetare VII”, 78 figura të gjinisë mashkullore, 32 të gjinisë femërore. “Historia VI”, 47 meshkuj, 4 femra. “Leximi VIII”, 24 figura meshkujsh, 13 femra. “Historia VIII”, 137 figura meshkujsh, 15 femrash etj.,
- edhe në ato tekste shkollore ku femra dominon në paraqitje të ilustrimeve me figura është kryesisht në rolin e mësueses dhe nën përkujdesjen e fëmijëve si në rastin e “Abetares”. Prej 215 figurave, 106 figura janë të meshkujve kundrejt 109 të femrave. Në faqet e para të këtij teksti shkollor, mungon plotësisht figura e prindit - mashkull. Prandaj, nëna është subjekti më i përmendur në këto ilustrime, të cilat reflektojnë figurën e nënës të përcaktuara nga kushtet sociale patriarkale (f. 7).⁷²

Duhet vlerësuar se të dy studimet kanë kontribuar në fillimin e hulumtimeve kombëtare dhe problemeve të barazisë dhe përfaqësimit gjinor në përmbajtjen e teksteve shkollore të Kosovës dhe ndërgjegjësimin mbi paragjykimet gjinore dhe pabarazitë e përfaqësimit në përmbajtjen e teksteve shkollore. Ato sigurojnë një bazë për të kuptuar deri në ç'masë janë paragjykimet dhe diskriminimi të pranishme në tekstet shkollore. Duhet nëvizar se të dy studimet kanë kufizimet e tyre pasi përdorin metodologjitë që synojnë ekspozimin e stereotipeve gjinore, karakteristikave të caktuara që i atribuohen një individ ose një grupi si dhe analizojnë informacionet në bazë të kategorive të paracaktuara, si "roli tradicional/jo-traditional" ose "roli i statusit të lartë/statusit të ulët". Për më tepër, studimet identifikojnë vetëm stereotipet dhe situatat e dukshme diskriminuese të cilat ka gjasa të vihen në dukje dhe të

⁶⁹ Hyseni, H. et al (2007). Barazia gjinore në librat e leximit, në arsimin e detyruar nëntëvjeçar në Kosovë. Qendra për Arsim e Kosovës. Marrë nga <http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2016/03/Gender-equality-in-the-reading-textbooks-during-the-nine-years-of-compulsory-education-in-Kosovo-1.pdf>

⁷⁰ Halimi, S. et al (2007) Auditimi i Çështjeve Gjinore në Sistemin Arsimor, Qendra Kosovare për Studime Gjinore. Marrë nga

<http://www.kgscenter.net/site/assets/files/1466/auditimiiceshtjevegjinorenesisteminarsimor.pdf>

⁷¹ Qendra Kosovare për Studime Gjinore. Marrë nga <http://www.kgscenter.net/en/publications/>

⁷² Halimi, S. et al (2007) Auditimi i Çështjeve Gjinore në Sistemin Arsimor, Qendra Kosovare për Studime Gjinore. Marrë nga <http://www.kgscenter.net/site/assets/files/1466/auditimiiceshtjevegjinorenesisteminarsimor.pdf>

ekspozohen. Kjo paraqet një paragjykim metodologjik, që ngre pyetjen nëse është e mundur të evidentohen lëshimet apo përjashtime që po ashtu çojnë në seksizëm ose diskriminim për shkak të informacionit që mungon (f. 28).⁷³

Duhet të theksohet se qasjet e mëparshme metodologjike të përdorura në shqyrtimin e barazisë dhe përfaqësimit gjinor në tekstet shkollore paraqesin një sërë problemesh. Për të përmendur disa, ato kanë të bëjnë me paraqitjen e karakteristikave të kufizuara të diskriminimit gjinor dhe seksizmit që ishin të nënkuptuara, të fshehura ose qëllimisht të lëna jashtë, pikëpamjen e thjeshtë dhe kategorizimin e roleve dhe tipareve që nuk ishin të bazuara ose që nuk nxorrën asnjë rëndësi të kontekstit kulturor ku operonin karakteret e teksteve shkollore, kategorizimi dhe rolet e grave dhe burrave u kufizuan në disa prej tyre, duke dështuar që të marrin parasysh shumëllojshmërinë e roleve, karakteristikat dhe tiparet e përfaqësimit gjinor të burrave dhe grave. Po ashtu, analizat sasiore dhe cilësore rrallë janë shoqëruar së bashku, ose analizat sasiore kanë qenë shumë të kufizuara në numërimin e thjeshtë të burrave dhe grave që përfaqësohen në përmbajtjen e teksteve shkollore.

Një qasje e re e propozuar nga OKBESHK ka të bëjë me përdorimin edhe të metodologjive të analizës sasiore edhe cilësore që lehtësojnë rishikimin, studimin dhe krahasimin e materialeve me përmbajtje të madhe të identiteteve gjinore dhe roleve gjinore si tërësi kundrejt thjeshtë identifikimit të seksizmit ose diskriminimit kundër një seksi (f.29),⁷⁴ që siguron identifikim më të mirë të meritave të barazisë gjinore ose jo të përmbajtjes së teksteve shkollore. Kjo metodë bazohet në një kuptim të asaj se si janë të zhvilluara përfaqësimet e meshkujve dhe femrave në një tekst shkollor dhe mbështetet në dy parime themelore.

- *Përfaqësimet gjinore janë të mishëruara në karaktere, dhe prandaj duhet të promovohet barazia gjinore përmes këtyre. Karakteret përdoren edhe në tekste të shkurtra si ushtrimet e teksteve shkollore, që përbëjnë histori miniaturë. Ato kanë aftësi, role, statuse, mënyra të aktrimit dhetribute; ato lëvizin në mjedise ose terriore të caktuara dhe janë të kapura në një rrjet ndërveprimesh me karakteret tjera. Në të gjitha këto*

karakteristika të marra së bashku, zbulohet se çfarë do të thotë të jesh një burrë, grua, vajzë apo djalë në një shoqëri të caktuar,

- *Përfshirja e një karakteri në një tekst shkollor kontribuon në zhvillimin e përfaqësimeve të ndara sipas gjinisë. Prandaj, duhet të merret parasysh struktura e brendshme dhe qëllimi i ndihmës. Një karakter mund të paraqitet në tekste ose ilustrime dhe karakteristikat do të shprehen më ndryshe me fjalë sesa në imazhe. Ilustrimet mund të kenë një profil më të lartë, të zënë më shumë hapësirë dhe janë më të lehta për t'i monitoruar. Ideja është që t'i kushtohet vëmendje teksteve dhe ilustrimeve dhe të bëhen lidhje ndërmjet tyre, p.sh. një karakter që paraqitet në një mësim mund të ketë më shumë vëmendje sesa një që paraqitet në ilustrim.*

Llogaritja e personazheve duhet të marrë në konsideratë seksin dhe moshën (p.sh. burra, gra, djem, vajza, nxënës/fëmij, të paspecifikuar nga aspekti i moshës dhe seksit. Për më tepër ata duhet të kenë të gjitha tiparet e përshkrimit gjinor.⁷⁵

- *llojin e karakterit: individ ose grup ("fëmijë", për shembull);*
- *funksionin arsimor: "figurë shoqëruese", që i mbështet nxënësit në tërë tekstin shkollor, "piktogram", që i ndihmon nxënësit për ta gjetur vetën në tekstin shkollor, ose "zëvendësim" që përfaqëson mësimdhënësin ose nxënësin në ilustrime;*
- *roli: "hero" ose figurë e vogël;*
- *funksionet sociale, profesionale dhe/ose familjare, të demonsttruara në mënyrën se si është emërtuar personi (emri, mbiemri, marrëdhënia familjare, statusi, profesioni etj.);*
- *atributet me specifikim të gjinisë në aspektin e stilit të frizurës, zbulimeve të tilla si bizhuteri dhe makiazh, rroba dhe kështu me radhë;*
- *atributet në aspektin e karakteristikave fizike ose gjësendeve;*
- *personazhi dhe tiparet e karakterit; aktivitetet dhe veprimet;*

⁷³ Brugges, C., & Cromer, S. (2009) Promoting Gender Equality Through Textbooks, A Methodological Guide (Promovimi i Barazisë Gjinore përmes Teksteve Shkollore, Një Udhëzues Metodologjik), UNESCO, Paris. Marrë nga https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000158897_eng

⁷⁴ Brugges, C., & Cromer, S. (2009) Promoting Gender Equality Through Textbooks, A Methodological Guide (Promovimi i Barazisë Gjinore përmes

Teksteve Shkollore, Një Udhëzues Metodologjik), UNESCO, Paris. Marrë nga https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000158897_eng

⁷⁵ Brugges, C., & Cromer, S. (2009) Promoting Gender Equality Through Textbooks, A Methodological Guide (Promovimi i Barazisë Gjinore përmes Teksteve Shkollore, Një Udhëzues Metodologjik), UNESCO, Paris. Marrë nga https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000158897_eng

- bashkëveprimi me personazhe tjera;
- zonat gjeografike dhe kulturore dhe vendet në të cilat vendoset personazhi.

Ky udhëzues ndjek qasjen e OKBESHK-së dhe ofron mjete specifike për të identifikuar, ekspozuar dhe analizuar personazhet në bazë të kategorive të mësipërme. Ai

iii. Zhvillimi i sistemit egalitar gjinor në tekste shkollore

Tekstet shkollore duhet të standardizojnë, përforcojnë dhe legjitimojnë egalitarizmin. Promovimi i marrëdhënieve egalitare gjinore do të thotë që në përmbajtjen arsimore të gjithë njerëzit janë të barabartë dhe meritojnë të drejta dhe mundësi të barabarta. Për ta bërë këtë të dukshme në përmbajtje dhe për ta reflektuar në praktikën e mësimdhënies dhe mësimnxënies në klasë, është e rëndësishme të kuptohet se si arrihet egalitarizmi. Në bazë të punës dhe hulumtimit ekzistues lidhur me zhvillimin e teksteve shkollore, ekzistojnë disa sugjerime/kritere për promovimin e marrëdhënieve gjinore (Brugilles dhe Cromer, 2009, f. 4).⁷⁶

- Eliminimi i stereotipeve dhe seksizmit është i nevojshëm, por i pamjaftueshëm. Duhet të ketë monitorim të përfaqësimit të burrave, grave, djemve dhe vajzave,*
- Personazhet shprehin përfaqësimet dhe duhet të ndërmerren veprime për përfaqësimin e personazheve në tekstin shollor,*
- Të gjitha përfaqësimet me specifikim gjinie të meshkujve dhe femrave duhet të monitorohen në përputhje me rrethanat, duke shtjelluar çdo pjesë të tekstit shollor, si fragmentet e tekstit, mësimet, ushtrimet dhe shtojcat, si dhe ilustrimet për të siguruar që teksti dhe ilustrimet nuk janë kontradiktore por në përputhshmëri.*

Është e rëndësishme të theksohet se zgjedhja e personazheve të paraqitura në tekstin shollor përçon porosi gjinore. Përdorimi i personazheve me specifikim dhe pa specifikim gjinie është i lidhur ngushtë me pabarazinë gjinore, për shembull personazhet me specifikim gjinie mund t'i referohen përgjithësimeve të karakteristikave dhe të ngrenë çështjen e barazisë. Varësisht nga përmbajtja, për shembull

fokusohet në përmbajtjen, ilustrimin dhe i kushton një vëmendje të veçantë gjuhës si një formë përmes së cilës eksplorohehen më tej tiparet dhe atributet e personazheve dhe kuptohen si të vetme dhe në ndërveprim me të tjerët nëpërmjet dialogut dhe përdorimit të formave specifike të të folurit.

nëse flasim për individë (p.sh. nxënësi, fëmija, personi) mund të jetë i gjinisë asnjëanëse. Në vend të kësaj, një emër mund të përdoret për t'u dhënë atyre një identitet gjinor. Ngjashëm me këtë, kur paraqitet një grup, duhet t'i kushtohet vëmendje grupit me gjini të specifikuar ose grupit të individëve (p.sh. vajzat) ose pa specifikim gjinie (p.sh. klasa, familja).

Për të shmangur përgjithësimin dhe universalitetin e karakteristikave, vëmendja duhet të vendoset në identifikimin e hollësishëm të grupit p.sh. çfarë përfaqëson grupi, a është i përzier apo jo apo ka vetëm një identitet kolektiv. Gjinia e personazheve, në fund të fundit, është një përfaqësim i shoqërisë, prandaj personazhet duhet të jenë me specifikim të gjinisë në tekst dhe ilustrim duke iu dhënë atyre një element të emërimit si p.sh. (përmri ai ose ajo, emri, marrëdhënia familjare, një marrëdhënie tjetër (mik, fqinj, kolegë), profesion, zyrë politike apo fetare ose ndonjë status tjetër (Brugilles and Cromer, 2009, f.43-44).⁷⁷

Ku duhet të shohim për të sjellë egalitarizmin? Për të sjellë egalitarizmin, recensimi i teksteve shkollore duhet të sigurojnë që të arrihet barazi midis burrave, grave, vajzave dhe djemve duke i kushtuar vëmendje të gjitha pjesëve në vijim:

- në tekst dhe ilustrime
- në të gjitha pjesët e ndryshme të teksteve shkollore (p.sh. mësimet, fragmentet e tekstit dhe ushtrimet)
- në caktimin e personazheve "hero" dhe figurave të vogla
- në pozicionin dhe madhësinë e personazheve në ilustrime.

⁷⁶Brugilles, C., & Cromer, S. (2009) Promoting Gender Equality Through Textbooks, A Methodological Guide (Promovimi i Barazisë Gjinore përmes Teksteve Shkollore, Një Udhëzues Metodologjik), UNESCO, Paris. Marrë nga https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000158897_eng

⁷⁷Brugilles, C., & Cromer, S. (2009) Promoting Gender Equality Through Textbooks, A Methodological Guide (Promovimi i Barazisë Gjinore përmes Teksteve Shkollore, Një Udhëzues Metodologjik), UNESCO, Paris. Marrë nga https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000158897_eng

Për të pasur përshkrime egalitare të promovuara në tekst, shqyrtuesit duhet të sigurohen që përshkrimi egalitar në tekst të ketë (f. 44 - 45):

Barazi gjatë prezantimit të personazheve:

- përfaqësim të barabartë në statusin profesional, familjar, social dhe politik, përshkrime të përcaktuara nga veprimet, atributet (karakteristikat, gjësendet, etj.) dhe mjediset (publike apo private)
- përfaqësimi i barabartë i të dy personazheve (grave dhe burrave) më vete
- marrëdhënie të barabarta dhe ndërveprim midis dy personazheve (gra dhe burra)
- aspektet e përbashkëta dhe jo dallimet e personazheve pa bërë përjashtime apo preferenca
- ndërkëmbyeshmëri të roleve të personazheve në vend të plotësueshmërisë
- identitete të shumëfishta të personazheve p.sh. (një sërë karakteristikash, si p.sh. një nënë që është mjeke dhe një baba që është punëtor i ndërtimit).

Personazhet duhet të kenë këto karakteristika fizike dhe psikologjike:

- nuk duhet të kenë atribum të veçorive psikologjike, defekteve apo cilësive morale specifike për gjininë (p.sh. djem që frikësohen apo që qajnë, apo vajza që janë të guximshme)
- nuk duhet të ketë lidhje të aftësive të caktuara intelektuale me njërin gjini (p.sh. personazhet femra që zotërojnë jo vetëm teknikat dhe teknologjinë tradicionale, por edhe ato më të avancuarat).

Përshkrimi i të drejtave të barabarta duhet t'iu jap të gjitha personazheve:

- të drejta të njëjta në çdo fushë të jetës së tyre, e mbi të gjitha, të drejta të njëjta politike (për pjesëmarrje në politikë, ushtrim të pushtetit, e kështu me radhë);
- të njëjtën autonomi për të marrë vendime për veten dhe për rrethin e tyre të ngushtë.

Fusha e punësimit duhet:

- të përfshijë burra dhe gra në një shumëllojshmëri të profesioneve të ngjashme
- të shmang izolimin e punësimit të grave si zgjatje të aktiviteteve të tyre shtëpiake dhe amënore
- të shmang profesionet për gjininë femërore, si ato tradicionale me statusin më të ulët dhe më së paku

të paguara, me cilësi/aftësi që ndërlidhen ngushtë me sferën shtëpiake

- të vendosi theks në statusin e barabartë profesional të grave dhe burrave në punë dhe pagesë
- të shmang mungesën e statusit profesional të grave dhe puna e tyre pa pagesë apo me pagesë të ulët është faktor i statusit të tyre më të ulët.

Ndërveprimi i personazheve duhet të paraqitet në tekst dhe ilustrim:

- paraqitja e anëve të forta dhe pavarësinë e personazhit burrë ose grua
- ndërveprimi i personazheve të moshave dhe gjinive të ndryshme (p.sh. jo vetëm personazhet femra me personazhet meshkuj, jo gratë në lidhje me fëmijët)
- marrëdhëniet ndërmjet personazheve të të dyja gjinive si plotësuese dhe jo si rivale apo krahasuese
- mosatribuimi i aftësive tradicionale një gjinie të veçantë (p.sh. paraqitni personazhet femra duke këshilluar personazhet meshkuj për çështje shkencore)
- në shkollë dhe familje të përfaqësuar me kujdes në harmoni me profesionet e prindërve
- detyrat dhe të drejtat të jenë të ndërkëmbyeshme (p.sh. ndërveprimi ndërmjet mësimdhënësit dhe nxënësit të jetë i barabartë, të ketë interesim në të gjitha lëndët pavarësisht a është djalë apo vajzë, etj.)

Të eliminohet përfaqësimi dhe portretizimi gjinor diskriminues nëpërmjet:

- shpërndarjes së barabartë të roleve të të folurit dhe dëgjimit
- promovimit të imazhit pozitiv të grave për kontributin e tyre në zhvillimin e vendit (në aspektin historik, ekonomik, social, kulturor dhe artistik: gratë politike, figurat simbolike të historisë)
- shmangies së stereotipeve seksiste (gratë më të buta, më të ndjeshme dhe më të mira se sa burrat për t'u kujdesur për fëmijët dhe shtëpinë; më të dobëta se burrat; më pak të zgjuara; jo autoritative) duke portretizuar modelet pozitive të grave dhe burrave në situatat jo tradicionale për të kundërshtuar pohimet e tilla
- Situatat aktuale që përmbysin idetë e mësuara janë në kundërshtim me normat shoqërore (për shembull gratë pa fëmijë) dhe janë në kundërshtim me

proverba të caktuara dhe këngë të popullarizuara që diskriminojnë vajzat dhe gratë.⁷⁸

Megjithatë, çka u përmend më lartë, arrihet përmes mjeteve dhe mënyrave specifike që ndihmojnë në zbulimin dhe matjen e nivelit të paragjytimeve dhe diskriminimit të pranishëm në një tekst shkollor për barazinë dhe paritetin që duhet të integrohen dhe të rrënjosen në tekstet shkollore në seksionin më poshtë.

⁷⁸Brugilles, C., & Cromer, S. (2009) Promoting Gender Equality Through Textbooks, A Methodological Guide (Promovimi i Barazisë Gjinore përmes

Teksteve Shkollore, Një Udhëzues Metodologjik), UNESCO, Paris. Marrë nga https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000158897_eng

KAPITULLI III.

MJETET PËR RISHIKIMIN GJINOR TË TEKSTEVE SHKOLLORE

I. RISHIKIMI I PËRMBAJTJES

i. Përfaqësimi gjinor – shpërndarja e individëve

Përshkrimet e mësipërme janë paraqitur për të siguruar një të kuptuar të koncepteve gjinore në tekstet shkollore dhe për të zbuluar shkallën në të cilën është e pranishme pabarazia gjinore në një tekst të caktuar shkollor. Më konkretisht, rishikimi i një libri shkollor nga perspektiva gjinore duhet të zbulojë *sistemin gjinor* brenda një përmbajtjeje specifike. Roli i shqyrtuesit është që të nxjerr një pasqyrë të qartë të përfaqësimit dhe/ose nënpërfaqësimit gjinor, anshmërisë dhe diskriminimit, stereotipeve dhe paragjykimeve, brenda përmbajtjes dhe ilustrimeve në tekstet shkollore. Duke pasur parasysh këtë, shqyrtuesi duhet të orvatet të identifikojë se cilat elemente në tekstet shkollore pengojnë barazinë gjinore dhe të sugjerojë se si të ndryshohen ato në mënyrë që në tekstin shkollor të zhvillohen qëndrime dhe qasje që janë të ndjeshme ndaj aspektit gjinor, por edhe të krijohen praktika dhe besime të barazisë dhe të të drejtave gjinore tek lexuesit.

Identifikimi i sistemit gjinor në tekstin shkollor kërkon nga shqyrtuesi që të analizoj hollësisht të gjitha pjesët e tekstit dhe ilustrimeve ku paraqitet pabarazia gjinore përmes formave të fjalëve dhe fotografive. Përvoja dëshmon që pabarazia gjinore nuk zbulohet lehtë dhe kërkon analiza të hollësishme të të gjitha pjesëve të teksteve shkollore dhe vëmendje të veçantë në *identifikimin e stereotipeve* që mund të jenë të pranishme dhe të dukshme por gjithashtu të fshehura në përmbajtje, gjuhë dhe ilustrime; *identifikimi i një prezantimi të çekuilibruar dhe selektiv* në bazë të gjinisë; *anshmëria sipërfaqësore* si dhe *fragmentimi dhe izolimi i një gjinie* në krahasim me tjetrën. Prandaj, ekzistojnë mjete dhe tabela të shumta për të ndihmuar në identifikimin e pabarazisë dhe për të kontribuar në zhvillimin e një teksti shkollor cilësor që përgatit lexuesit për të menduar dhe për të vepruar në një mënyrë kritike, analitike dhe konstruktive.

Për të identifikuar përfaqësimin dhe/ose nën-përfaqësimin gjinor, shqyrtuesi/ija/recensensuesi/ija duhet të marrë në konsideratë kategoritë kryesore gjinore; *burra, gra, djem dhe vajza*. Sidoqoftë, për shkak të kompleksitetit të identitetit

gjinor siç u shtjellua më sipër, përfaqësimi dhe/ose nën-përfaqësimi duhet të përqendrohen gjithashtu në *moshë, racë, fe, përkatësi etnike dhe vend*, të listuara si nënkategori të mjetit. Identifikimi i kategorive pa specifikim gjinie si të individëve ashtu dhe grupeve duhet të jetë pjesë e analizës së përfaqësimit gjinor. Në kategorinë e përgjithshme, shqyrtuesi mund të shënoj gjetjet e përgjithshme bazuar në renditjen e mësipërme.

Identifikimi i përfaqësimit gjinor bazohet në llogaritjen e kategorive dhe nën-kategorive më lartë. Megjithatë, jo vetëm duke llogaritur formulimin gjinor, por duke llogaritur edhe elementet që caktojnë gjininë e personazhit (p.sh. *emrat e përveçëm, përemrat, imazhet dhe përshkrimet tjera, marrëdhëniet familjare nënë, vëlla dhe marrëdhëniet tjera*). Brenda tekstit, shqyrtuesit duhet të analizojnë të gjitha pjesët e përmbajtjes së një teksti shkollor, duke filluar nga, *kopertina te paraqitja e librit tek titulli, teksti, ushtrimet, shembujt, burimet e cituara dhe ilustrimet* në secilin kapitull dhe secilin mësim. Kategoritë e shënuara këtu janë të gjitha pjesë e tabelave më poshtë që ndjekin të njëjtat modele. Si mjete për grumbullimin e të dhënave, ato ndihmojnë për evidentimin e numrave në bazë të kategorive dhe nën-kategorive të përmendura më lartë për t'u përgjigjur në pyetjet:

- *Sa herë përmenden/përfaqësohen gratë dhe burrat dhe djemtë dhe vajzat në tekstin shkollor (tekst, ushtrime, ilustrime dhe citime)?*
- *Sa herë përmenden/përfaqësohen gratë dhe burrat dhe djemtë dhe vajzat si individë dhe grupe?*
- *Sa herë përmenden grupet pa specifikim gjinie në tekstin shkollor?*
- *Sa herë prezantohen autorët meshkuj dhe femra në listën e citimeve/referencave të teksteve shkollore?*

Tabela 1. Përfaqësimi gjinor i individëve në tekst

PËRFAQËSIMI I INDIVIDËVE NË TEKST											
Numri i Përgjithshëm i individëve	Kategoritë kryesore	Numri i nën-kategorive									
		Moshë		Përkatësia etnike		Racë		Vendbanimi		Religjioni	
		I/e ri/re	I/e moshuar	Shumicë	Pakicë	E bardhë	Jo e bardhë	Urban	Rural	Fetar	Jofetar
	Gratë										
	Burrat										
	Vajzat										
	Djemtë										
	Pa gjini Seksi i paspecifikuar										
GJITHSEJ Shënime për nënkategoritë (p.sh. gratë më të moshuara, grup dominues)											
p.sh. Shënim mbi prezantimin për orientimin seksual (grupi LGBT)											

ii. Përfaqësimi gjinor – shpërndarja e grupit

Përderisa tabela e mësipërme ndihmon në llogaritjen e individëve për qëllime të rishikimit, është e rëndësishme të kuptohet numri i grupeve dhe nëse janë grupe me gjini të specifikuar apo me gjini të paspecifikuar. Përdorimi i personazheve transmeton mesazhe gjinore dhe ndihmon për të kuptuar nëse emërtimi i grupit (shpesh asnjans/pa gjini të specifikuar, p.sh. klasa, familja) dhe grupi i individëve (p.sh. vajzat) shfaqin barazi ose pabarazi. Më së miri është të bëjmë përpjekje dhe të *harmonizojmë përputhshmërinë e anëtarëve dhe emrin e*

grupit (p.sh. grup i nxënësve pa gjini të specifikuar, ku të gjithë mund të jenë djem, një grup i politikanëve, ku të gjithë mund të jenë burra, etj.). Identifikimi i nënkategorive duhet të rishikohet dhe paraqitet në bazë të grupeve dominuese dhe grupeve të nënkategorive, përmes rishikimit të secilit libër (titulli, pjesa kryesore e tekstit, ushtrimet, shembujt) dhe ilustrimeve në secilin kapitull dhe mësim duke përdorur tabelën e mëposhtme.

Tabela 2. Përfaqësimi gjinor i grupeve në tekst

PËRFAQËSIMI I GRUPIT NË TEKST						
Kategoritë kryesore						
	GRATË	BURRAT	DJEMTË	VAJZAT	PËRZIER	PA GJINI TË SPECIFIKUAR (Ju lutemi specifikoni, p.sh. nxënësit, klasa, familja)
Numri i përgjithshëm në tekst						
NËNKATEGORITË						
Të moshuar/të rinj						
Shumicë/pakicë						
Raca e bardhë/jo e bardhë						
Urban/Rural						
Fetar/jo-fetar						
Komente për nënkategoritë p.sh. grupi i inxhinierëve, grupi LGBT, gratë infermiere, fëmijë të racës së bardhë që luajnë, vajza që luajnë me kukulla, etj.						

iii. Përfaqësimi gjinor – Citimi

Është e rëndësishme që për çdo rishikim të teksteve shkollore të kontrollohet citimi.⁷⁹ Ekzistojnë dy arsye për këtë, e para është që përmbajtja e teksteve shkollore mund të ofrojë fakte dhe dëshmi pa asnjë referencë ose citim të autorëve gra dhe burra, dhe e dyta të kuptohet çfarë është cituar (nga autorët burra ose gra) duke iu referuar dëshmive të paraqitura në përmbajtje dhe emrat e renditur tek lista e fusnotave dhe eferencave. Shqyrtuesi duhet të sigurohet që referencat nuk pasqyrojnë dominancë të njëjës gjini, dhe mungesë të tjetrës. Në rast se citohen vetëm autorë burra, atëherë anashkalohet zëri,

përvojat dhe gjetjet e grave, dhe kjo gjë pengon barazinë në përmbajtje. Megjithatë, në varësi të temës, rishikimi i autorëve të cituar nuk kërkon barazi gjinore të pasqyruar 50-50% në referenca, por vetëm ka për qëllim shmangien e dominimit të një grupi autorësh kundrejt tjetrit. Gjithashtu shqyrtuesi duhet t'i shikojë me kujdes secilën referencë përgjatë teksteve shkollore, fusnotat dhe referencat e përmbajtjes (tekstin, ushtrimet, shembujt) dhe ilustrimet në secilin kapitull dhe mësim duke përdorur tabelën e mëposhtme.

Tabela 3. Përfaqësimi gjinor i citimit/burimeve

CITIMI	
Numri i përgjithshëm i burimeve të citimit	
GRATË	BURRAT
Nr.	Nr.
%	%
Mungesa e citimit (kur është e nevojshme)	Komenti / numri / %

Numrat e mbledhur në tabelat e mësipërme do të japin një pamje të qartë të numrit të djemve dhe vajzave dhe burrave dhe grave në tekstin shkollor, si individë dhe grupe. Tabela jep një hartëzim të numrave dhe jep pamje të qartë të pranisë së gjinive të specifikuar dhe gjinisë së paspecifikuar në numra apo përqindje për kuptim të thjeshtë të tyre në tekstin shkollor. Numrat do të tregojnë nëse ka dominim apo përfaqësim jo të duhur të njërit grup kundrejt grupit tjetër. Me përfshirjen e numrave dhe komenteve në nën-kategori, do ketë

informacione mbi tendencat e përfaqësimit se kujt i jepet përparësi tek nën-kategoritë e caktuara gjinore p.sh. shumica e grave të përfaqësuara janë urbane apo gra nga shumica, asnjë djalë nga pakica dhe i racës tjetër nuk përfaqësohet në mjedisin shkollor, mungojnë përfaqësues të komunitetit roma, ashkali dhe egjiptas, etj.). Këto duhet të shtohen si shënime/vërejtje shtesë që duhet të merren parasysh dhe të vendosen në tabelën e mëposhtme në kuadër të shënimeve cilësore.

⁷⁹ Ju lutem vini re se citimi në tekstet shkollore në Kosovë, sipas zyrtarëve të MASHT-it, nuk kanë qenë praktikë deri më tani dhe nuk janë të listuara në kuadër të kërkesave për autorët e teksteve shkollore. Është shumë e rekomandueshme të përfshihet ky kriter në mënyrë që të kërkohet nga autorët dhe shqyrtuesit.

Tabela 4. Përmbledhje për individët dhe grupet në tekstin shkollor

PËRMBLEDHJE E PËRFAQËSIMIT GJINOR						
Individët	Gjithsej	Gra	Meshkuj	Djem	Vajza	Gjinia e paspecifikuar
<i>p.sh. gjithsej 800 gra, 150 të racës së bardhë, 200 rurale, etj.</i>						
Teksti						
Komente mbi nënkategoritë <i>përfshirë orientimi seksual</i>						
Grupet	Gjithsej	Gra	Meshkuj	Djem	Vajza	Gjinia e paspecifikuar
Teksti						
Komente mbi nënkategoritë						

iv. Shqyrtimi i fragmentit të tekstit – titujt, pjesa kryesore e tekstit, ushtrimet dhe shembujt

Që të arrihet barazia, të gjitha kategoritë e personazheve duhet të trajtohen fillimisht si njerëz dhe jo si anëtarë të sekseve të kundërta. Përmbajtja e teksteve shkollore duhet të ndajë *humanitetin dhe atributet e përbashkëta, aktivitetet dhe profesionet e tyre në terme të barabarta* dhe të shmangë theksimin e dallimeve gjinore. Përderisa shpërndarja e mësipërme jep një pamje të pjesshme të sistemit gjinor në tekste shkollore, përgjigja për pyetjet e mëposhtme ofron një kuptim më të thellë.

- Si janë të përshkruar burrat dhe gratë në tekste?
- Deri në çfarë mase janë favorizuar apo diskriminuar në tekste?
- Deri në çfarë mase përmbajtja e tekstit lidhur me gjininë është e njëanshme?

Për të marrë përgjigje për pyetjet e mësipërme, shqyrtuesi duhet t'i nënshtrohet një rishikimi të hollësishëm të

fragmenteve të tekstit duke filluar nga titujt, pjesët kryesore dhe shembujt. Fokusi kryesor duhet të jetë tek aktivitetet e personazheve, rolet, detyrat dhe ndërveprimet e tyre në çdo kapitull dhe mësim. Për të kryer këtë pjesë të analizës, shqyrtuesi duhet të kuptojë se si duket prezantimi i njëanshëm në titujt, në pjesën kryesore të tekstit, në shembujt dhe në ushtrimet.

Titujt ofrojnë informata sipërfaqësore lidhur me përmbajtjen dhe e drejtojnë lexuesin tek ajo, prandaj shpeshherë në tituj mund të hasen elemente të pabarazisë, edhe pse pjesa kryesore e tekstit mundet mos ta ketë. Për të identifikuar elementet e pabarazisë, në tabelën 5 mund të shihen titujt e njëanshëm, dhe si mund të duken ato. Shembujt e dhënë më poshtë, ose ato të ngjashme, duhet të identifikohen dhe të shmangen.

Tabela 5. Shembuj të titujve të njëanshëm

Heronjtë (vetëm forma mashkullore) e Luftës Kombëtare në vendin tonë
Trupi i burrave dhe karakteristikat e tij kryesore (trupi i grave dhe burrave)
Zhvillimi i biologjisë e njeriut (biologjia e grave dhe burrave)
Adoleshenti mesatar dhe zhvillimi i tij në trup dhe në mendje
Burrat, kreu i familjes (shmangni termin burra)
Politikanët më me ndikim të dekadës së fundit (vetëm forma mashkullore)
Arritjet më të larta shkencore të burrave (vetëm termi burra)
Matematikanët (burra) e mëdhenj të kombit tonë
Aplikimet e matjes: Inxhinierët (burra) ndërtojnë ura dhe rrugë

Titujt mund të pasohen nga një përmbajtje që mund, ose mund të mos jetë e njëanshme. Kështu, rishikimi i titullit duhet të shoqërohet edhe me rishikimin e pjesës kryesore të tekstit. Përmes leximit të shpejt dhe sipërfaqësor, dhe duke pasur parasysh pyetjet e mësipërme për identifikimin e formulimit specifik gjinor, siç pasqyrohet në titujt e njëanshëm, shqyrtuesi mund të dalë në përfundimin nëse përmbajtja është me bazë gjinore apo jo. Teksti i njëanshëm përfshin *përdorimin e stereotipave* që çojnë në pabarazinë gjinore, *favorizon* dukshmërinë e një grupi që është i ekzagjeruar, kurse grupi tjetër merr pjesë në *aktivitete* inferiore, të padukshme dhe të pabarabarta, cakton kush vendoset si *personazh hero*, dhe cakton *tiparet personale gjinore bazuar në stereotipa*. Ato mund të identifikohen nga

mënyra se si është përcaktuar pjesa kryesore e tekstit, si po paraqiten personazhet në përmbajtje, atributet që u jepen atyre personazheve, rolet e ndara midis tyre, favorizimet e dhëna për njërin gjini në fusha të ndryshme të shoqërisë, favorizimet e dhëna për vetëm një zë, ose nga mospërfshirja e një grupi në pjesën kryesore të tekstit. Roli i shqyrtuesit është të sigurojë që brenda pjesës kryesore të tekstit ka paraqitje të barabartë në të gjitha fushat e jetës, attribute personale dhe karakteristika psikologjike të barabarta, ndërveprim ndërmjet roleve të personazheve, përfshirje të barabartë në jetë, familje, shoqëri, pavarësisht gjinisë së personazhit. Më poshtë mund t'i shihni disa shembuj specifikë bazuar në lëndët specifike dhe fushat e studimit.

Tabela 6. Shembuj të pjesës kryesore të njëanshme të tekstit

Mësimi për shtëpinë dhe familjen që përshkruan gratë dhe burrat, djemtë dhe vajzat me role me specifikim gjinie (burrat si shtylla e familjes, gratë si nëna, motrat tepër të ndjeshme në lidhje me vëllezërit, vëllezërit si indiferentë dhe të fortë, etj.) në mësimin e lëndës shoqërore
Atributet e ndryshme dhe ekskluzive të personalitetit që u jepen djemve dhe vajzave (burrat si të fortë, vendimmarrës dhe superior dhe gratë e kundërta e këtyre) në mësimin e lëndëve shoqërore/psikologjike
Bërja e grave heroína pothuajse të padukshme ose të dukshme vetëm në lidhje me burrat heronj në mësimin e lëndëve shoqërore/historike
Përmendja e matematicienëve burra dhe neglizhimi i grave në mësimin e lëndëve shkencore/matematikore
Mësimet për lavdërimin e grave vetëm për sakrifikimin e tyre në familje ose shoqëri në mësimet e lëndëve shoqërore
Përshkrimi i vetëm një modeli të familjes së lumtur, tradicionale (bashkëshortja, burri dhe fëmijët) dhe neglizhimi i plotë i shembujve të tjerë si të familjes me një prind(p.sh: një nënë të vetme, babai të vetëm, prindër nga grupi LGBTI) etj. në jetë dhe punë në mësimin e lëndës shoqërore
Përshkrimi i burave/grave në aktivitete, ku gratë janë të stereotipizuara si nëna amvisa dhe kryesisht të angazhuara në punët e shtëpisë dhe jo në jetën publike, në mësimet e lëndëve shoqërore
Neglizhimi i grave politike kur prezantohet situata politike e vendit në mësimin e lëndës shoqërore
Mungesa e figurave simbolike femërore të historisë në mësimin shoqëror/historik
Heroizmi dhe përsosmëria e burrave dhe jo e grave në mësimin e lëndëve të shkencës dhe teknologjisë
Përmbytja e ndërlidhur me shëndetin ku vetëm mjekët (meshkuj) referohen në mësimet e klasës së biologjisë
Prezantimi i rasteve individuale si rregulla siç sugjerohet se në raste të lidhshme ose arritjeve të grave (shumë rrallë) në shoqëri janë rregulla e përgjithshme

Përmbytja e tekstit përmban shumë ushtrime dhe shembuj ilustruese. Nëse ekzistojnë elemente të pabarazisë atëherë përmbytja e tekstit bëhet e njëanshme. Shembujt dhe ushtrimet duhet të mos jenë të njëanshme dhe të jenë në

përputhje me përmbytjen e tekstit. Elementet e anshmërisë janë të njëjta sikurse në pjesën kryesore të tekstit në përmbytje të ndryshme sic janë dhënë në shembujt në tabelën e mëposhtme:

Tabela 7. Shembuj të ushtrimeve dhe shembujve të njëanshëm

Nëse dikush iu pyet “ku po shkoni?”, ju ... (duke e ndërlidhur përgjithësimin vetëm me ai/atij) - duhet të jepni një përgjigje të vërtetë - duhet t’i tregoni atij se ku jeni duke shkuar - nuk duhet t’i tregoni atij se ku jeni duke shkuar - mund të jepni një përgjigje të shpejtë
Ju lutem përmendni tre shkencëtarë (vetëm gjinia mashkullore në vend të të dy gjinive edhe femërore edhe mashkullore) që kontribuan më së shumti në shkencë në shekullin e 20-të?
Kur një person shikon në laborator, ai e kupton që eksperimentet e kryera aty do të sjellin rezultate për shkak të:... (ndërlidhja e “një personi” në laborator vetëm me gjininë mashkullore “ai”)
Shtylla e familjes është personi i cili siguron jetesën për familjen. Ai është i përfshirë në mundësi të ndryshme punësimi për të siguruar një jetë të mirë për të gjithë në familje. Gj M (ndërlidhja e “shtyllës së familjes” vetëm me burrat)
Në krahasim me burrat , gratë janë më të ndjeshme? Pse? (shmangia e krahasimit me burrat bazuar në stereotipet ekzistuese)
Një infermiere trajnohet për t’i kuptuar emocionet e pacientëve të saj si dhe simptomat fizike. GjF (Infermieret ose termi femëror dhe mashkullor)
Adoleshenti mesatar shqetësohet për shëndetin e tij fizik (Adoleshenti mesatar shqetësohet për shëndetin fizik ose për shëndetin e saj/tij fizik)
Prindi që i lexon foshnjës së saj , ajo përkujdeset për rritjen intelektuale të foshnjës së saj. (Prindi që i lexon foshnjës përkujdeset për rritjen intelektuale të foshnjës. Ose forma ai/ajo)

Kërkoni ndihmë nga një **zjarrfikës** dhe **ai** do ta zbresë kotelen tuaj nga pema. Ju duhet... . (Kërkoni ndihmë nga një zjarrfikës, dhe **zjarrfikësi/zjarrfikësja** do të zbresë kotelen tuaj nga pema.)⁸⁰

Gratë punojnë në shtëpi, gatujnë ushqim, kujdesen për kafshët dhe pastrojnë rrobat. **Vajzat** përkujdesen për foshnjat e vogla. **Djemtë** shkojnë në shkollë. **Burrat** shkojnë për të punuar. (shpërndarje diskriminuese gjinore e punës në familje)

Është shumë e rëndësishme që shqyrtimi i përmbajtjes të marrë parasysh të lartpërmendurat dhe të shënohet teksti i njëanshëm dhe i paanshëm bazuar në anshmërinë e titujve, shembujve, ushtrimeve dhe përmbajtjes së përgjithshme në pjesën kryesore të tekstit. Shënimi i tyre në tabelën e

mëposhtme dhe komentet në pjesën e shënimeve do të ofrojnë qartësi për përmbajtjen e teksteve shkollore por me anë të shqyrtimit dhe përputhshmërisë së tyre në aspektin e cilësisë mund të arrihet barazia gjinore.

Tabela 8. Përfaqësimi gjinor në fragmentin e tekstit

PËRMBAJTJA NË FRAGMENTET E TEKSTIT			
Kategoria	Gjithsej	Të njëanshme	Të paanshme
Titujt			
Pjesa kryesore e tekstit			
Ushtrimet			
Shembujt			
Shënimet:			

v. Shqyrtimi i aktivitetit dhe ndërveprimit

Analiza e përmbajtjes duhet të marrë parasysh rishikimin e personazheve dhe ndërveprimit të tyre në aktivitete. Ekziston një gamë e gjerë aktiviteteve megjithëse personazhet janë përfshirë në çdo fushë të kurrikulës që ofron informacione lidhur me gjininë në përmbajtje. Prandaj është e rëndësishme të dihet se *kush dhe në çfarë frekuence janë të përfshirë në aktivitete të caktuara*.

Aktivitetet në përgjithësi mund të radhiten si profesionale, politike, shoqërore, shkollore, familjare dhe bazohen në fushën e performancës së tyre përmes përdorimit të foljeve. Ato mund të kategorizohen si të njëanshme dhe të paanshme. Anshmëria mund të identifikohet si në vijim; së pari, në aktivitete të veçanta, *cila është përfshirja edhe e grave edhe e burrave, vajzave dhe djemve në aktivitete; së dyti, në cilat aktivitete janë të përfshirë*. Shumë shembuj

mund të gjendet pavarësisht fushës dhe lëndës së kurrikulës, siç vijon:

- *gratë vetëm në aktivitete vartëse,*
- *burrat vetëm në aktivitete të profilit të lartë,*
- *vajzat në aktivitete të caktuara shoqërore në shkollë,*
- *djemtë në aktivitete të matematikës,*
- *aktivitetet politike të paraqitura vetëm nga burrat,*
- *aktivitetet në sferën publike vetëm për burrat,*
- *në aktivitetet familjare janë aktive vetëm gratë dhe vajzat,*
- *aktivitetet e caktuara të lojërave vetëm për vajzat,*
- *aktivitetet e caktuara të lojërave vetëm për djemtë etj.,*
- *ose edhe aktivitete për të dy gjinitë por vetëm burrat/djemtë performojnë mirë.*

⁸⁰ The Georgia Department of Education (1996) Gender Biased Language. Marrë nga from <http://academics.smcvt.edu/writingctr/gender%20bias.htm>

Aktivitetet dhe ndërveprimet e individëve dhe grupeve zënë një hapësirë të madhe në përmbajtje (pjesën kryesore të tekstit, ushtrimet, shembujt) të secilit kapitull dhe mësim. Prandaj pavarësisht nga lënda, rekomandohet të shqyrtohen aktivitetet në mënyrë më të detajuar dhe të merret parasysh

shpeshtësia e tyre dhe natyra e njëanshme ose e paanshme duke përdorur tabelën më poshtë dhe ku shënohen si të njëanshëm ose të paanshëm si dhe ofrohen shënime duke u bazuar në vëzhgimin e përgjithshëm të rezultateve.

Tabela 9. Aktivitetet me specifikim gjinie në fragmentin e tekstit

AKTIVITETET NË FRAGMENTET E TEKSTIT			
	Gjithsej	Meshkuj	Femra
<i>p.sh. 50 aktivitete profesionale 35 të njëanshme me orientim nga meshkujt</i>			
Nuk ka aktivitete profesionale			
Të njëanshme			
Të paanshme			
Nuk ka aktivitete politike dhe shoqërore			
Të njëanshme			
Të paanshme			
Nuk ka aktivitete shkollore			
Të njëanshme			
Të paanshme			
Nuk ka aktivitete familjare			
Të njëanshme			
Të paanshme			
Aktivitete tjera të kohës së lirë (sport, lojëra, etj.)			
Të njëanshme			
Të paanshme			
GJITHSEJ			
Shënime (bazuar në analizën cilësore) <i>(p.sh. mungon përzierja e racës në lojëra, prania e grave të komuniteteve RAE në aktivitetet më të ulëta shtëpiake, nuk përmendet grupi LGBT)</i>			

vi. Shqyrtimi i gjuhës

Gjuha ka fuqinë jo vetëm të formoj këndvështrimin tonë për botën. Madje ajo ndikon në këndvështrimin tonë se si e shohim veten dhe cili është vendi ynë në shoqëri. Vëmendja në gjuhë nga perspektiva gjinore po rritet gjithnjë e më shumë pasi që po shfaq anshmëri dhe pabarazi gjinore që janë mirë të fshehura në gjuhë përmes dialogëve, ndërveprimit, përshkrimit të tipareve të personazheve dhe përfshirjes së tyre brenda fjalëve dhe shprehjeve në përmbajtjen e teksteve shkollore.

Konsiderohet se gjuha nuk *pasqyron vetëm mënyrën se si mendojmë*, por gjithashtu e *sfidon edhe më tej mënyrën tonë të menduarit*. Për shkak se bart një sërë qëndrimesh, vlerash dhe besimesh, përdoret si mjet për të ruajtur statusin gjinor të individëve në shoqërinë tonë dhe riprodhon pabarazinë shoqërore. Kështu, nëse përdoren fjalët dhe shprehjet që tregojnë se gratë ose burrat janë inferiorë, supozimi i inferioritetit tenton të bëhet pjesë e mentalitetit tonë e mentalitetit tonë (Menegati dhe Rubini, 2017).⁸¹

⁸¹ Menegati, M. & Rubini, M. (2017) Gender Bias and Sexism in Language. Oxford Research Encyclopedia. Marrë nga

<http://communication.oxfordre.com/view/10.1093/acrefore/9780190228613.001.0001/acrefore-9780190228613-e-470>

Si mjet, gjuha mund të jetë një bartës i fuqishëm i anshmërisë, qoftë në forma të dukshme dhe delikate, por gjithashtu edhe bartës i barazisë nëse i kushtohet vëmendje. Me fjalë të tjera gjuha dekodon përmbajtjen sepse përmbajtja pasqyrohet në gjuhë. Rrjedhimisht, roli i shqyrtuesit të teksteve shkollore është t'i kushtojë vëmendje të veçantë përdorimit të gjuhës

me vëmendje të shtuar në gjuhën e përdorur për përshkrimin e burrave dhe grave në shoqëri. Duke e bërë këtë, gjuha mund të eliminojë stereotipet gjinore dhe të sjellë ekuilibrin në termat gjinorë. Ka disa karakteristika të gjuhës që shqyrtuesi i teksteve shkollore duhet të marrë parasysh gjatë analizës gjuhësore.

vii. Termat mashkullor për përshkrimet e përgjithshme

Vëmendja më e madhe për shqyrtimin e gjinisë është përdorimi ekskluziv i termeve dhe përemrave mashkullor, duke filluar nga paraardhësit tanë të hershëm, njerëzimi, biznesmenët e deri tek ajo më e përgjithshme e cila mohan më shumë pjesëmarrjen dhe njohjen e gruas. Shumë shpesh emrat dhe përemrat mashkullor përdoren kur gjinia e subjektit të tyre është e paqartë ose e ndryshueshme ose edhe kur mund të sqarohet (p.sh. nxënës në vend të nxënësve meshkuj dhe femra). Pra, përdorimi i përgjithshëm i emrave dhe përemrave mashkullor pasqyron dhe kontribuon në

margjinalizimin e grave. Shqyrtuesi duhet të sigurohet që ta shmangë atë ose të detajojë më tej përfshirjen e të dy seksve ose të përdorë forma të shumës varësisht nga konteksti. Ka shumë shembuj ose terma për të shmangur termat e përgjithshëm në mënyrë që të shmanget diskriminimi. Shembulli më poshtë tregon se si mund të shmangen termat e përgjithshëm dhe në vend të kësaj të përdoren terma më përfshirës dhe specifik kur lejohet në gjuhën e teksteve shkollore.

Tabela 10. Shembuj të termave mashkullor për përshkrime të përgjithshme

Arritjet njerëzore (arritjet e burrave dhe grave) kryesisht varen në paradigmat e paraqitura nga individët.
Nëse një person (ose shofer) (një burrë apo një grua ose shofer i të dy gjinive) ka kaluar një distancë prej 50 miljeve me një shpejtësi 60milje/orë në një rrugë të lakuar, (ai ose ajo) ai mund të arrijë në destinacionin...
Personi më i mirë (ose kandidati) për këtë punë është personi (grua ose burrë) i cili ka diplomë doktoranture.
Punëtorëve (burrë dhe grua) u lejohen të kenë pushim tre javor brenda vitit.
Adoleshentët rriten dhe kalojnë në moshën madhore (burrërohen ose grunohen) me shumë ndryshime në strukturën e tyre fizike, psikologjike dhe emocionale.
Votuesve u është kujtuar që të votojnë për kandidatin më të mirë (kandidati burrë ose grua)
Vepruesit janë zakonisht burrat që kanë njohuri të duhura dhe janë shumë të guximshëm.
Njeriu më i mirë për këtë punë është ai që ka kompetenca dhe kualifikime të larta. Ne duam të punësojmë njerëzit më të mirë që mund të gjejmë për këtë vend pune.
Ashtu sikurse kafshët e tjera, njeriu e ushqen fëmijën më qumësht.
Të gjithë njerëzit janë të vdekshëm, (Julia është një njeri. Prandaj Julia është e vdekshme) (Menegati and Rubini, 2017) ⁸²
Kaq shumë njerëz, kaq shumë mendje / Lërin njerëzit të dinë se ata munden (Brusokajte, 2013, p.41) ⁸³

⁸² Menegati, M. & Rubini, M. (2017) Gender Bias and Sexism in Language. Oxford Research Encyclopedia. Marrë nga <http://communication.oxfordre.com/view/10.1093/acrefore/9780190228613.001.0001/acrefore-9780190228613-e-470>

⁸³ Brusokaite, E. (2013) Gender Representation in EFL Books. MA Paper. Marrë nga <http://gs.elaba.lt/object/elaba:1868784/1868784.pdf>

Pavarësisht arsytimit se po ofrojmë një term të përgjithshëm ose një formë të shumësit, përdorimi i termave mashkullorë për t'i përshkruar të gjithë brenda këtij termi mund të flasë vetëm për nxënësit meshkuj dhe përjashton nxënëset femra. Gjuha e teksteve shkollore duhet të zëvendësojë termin "ai" me termin më specifik "ai ose ajo", ose termin "raca e njeriut (mankind)" me termin "njerëzimi (humankind)" (termi "njerëzimi" në gjuhën shqipe nuk

implikon asnjë gjini) në mënyrë që ta vërë në pah edhe kategorinë femërore (Hussain & Mattu 2003).⁸⁴

Ekziston një mori fjalësh që duhet shqyrtuar dhe shmangur për ta bërë gjuhën më përfshirëse dhe të barabartë, ose duke përdorur terme për të dyja gjinitë ose duke shtuar fjalët femër dhe mashkull si në listën kontrolluese të paraqitur në vijim:

Tabela 11. Lista kontrolluese e termave mashkullorë për përshkrime të përgjithshme

Shmangia e fjalëve	Fjalët që duhet përdorur si zëvendësim
Fëmijët	Djemtë dhe vajzat
Njeri	Grua dhe burrë
Student/nxënës	Nxënës në versionin femëror dhe mashkullor
Etërit	Gjyshërit dhe gjyshet
Bashkëshort	Bashkëshort dhe bashkëshorte
Zotërinj	Zonja dhe zotërinj
Perëndi	Vetëm mashkull, por perëndia (ginia femërore, trajta e shquar) perëndeshë mund të përdoret në kontekst të caktuar
Njerëzim	Burra dhe gra
Njerëz	Burra dhe gra
Të drejtat e njeriut	Të drejtat e burrave dhe grave
Qenie njerëzore	Gjinia mund të specifikohet në shembuj të caktuar
Raca njerëzore	Gjinia mund të specifikohet në shembuj të caktuar
Fuqia njerëzore	Të dy termet gjinore mund të përdoren
Madhor	Të dy termet gjinore mund të përdoren
Moshë madhore	Grua dhe burrë/mashkull dhe femër
Fuqia punëtore	Të dy termat femërore dhe mashkullore
Fëmijë	Të dy termat femërore dhe mashkullore
Krijues	Të dy termat femërore dhe mashkullore
Vendimmarrës	Të dy termat femërore dhe mashkullore
Veprues	Të dy termat femërore dhe mashkullore
Udhëheqës	Të dy termat femërore dhe mashkullore
Arritja njerëzore	Të dy termat ose njeriu
Qenie njerëzore primitive	Të dy termat mund të përdoren varësisht nga konteksti
Shok	Të dy termat ekzistojnë, mund të përdoren varësisht nga konteksti

⁸⁴ Hussain, N. & Mattu, A. (2003) Gender Bias and Stereotypes in School Texts. The Subtle Subversion—The State of Curricula and Textbooks in

Pakistan. Marrë nga www.sdpi.org.

Shqyrtuesi i teksteve shkollore duhet t'u kushtojë vëmendje të veçantë termave të përgjithshme (gjenerike) të dhënë në tabelën e mësipërme si bazë për vlerësimin e këtyre termave në përmbajtje dhe sugjeron zëvendësimin e termave të përgjithshëm me termat gjinor kurdo që është e mundur

(ekzistojnë mundësitë çdo herë kur ato duhet të mbeten të përgjithshme dhe pa specifikime gjinore). Mund të sigurojë edhe numrin për të treguar shpeshtësinë e termave të përdorura dhe sugjeron reduktimin duke u mbështetur në tabelën më poshtë.

Tabela 12. Përmbledhje e termave mashkullor për përshkrime të përgjithshme

Termet mashkullor për përshkrime të përgjithshme	
Gjithsej numri	
Komentet e përgjithshme	
Shënimi 1. p.sh. në lëndën e historisë, dëshmorët janë emëruar me terma të përgjithshëm.	
2.	
3.	
4.	
5.	

viii. Përdorimi i mbiemrave për profesionet/vendet e punës me gjini të përcaktuar

Profesionet me gjini të përcaktuar shihen nga perspektiva e pjesëmarrjes së meshkujve dhe femrave dhe shqyrtimi i ilustrimeve. Megjithatë, nga perspektiva gjuhësore, profesionet shpesh bëhen specifike për njërin gjini. Shpesh, vetëm termat mashkullor përdoren për të treguar profesionet edhe kur ato mund të tregohen duke përdorur të dy termat ose të shtojnë termin femëror ose mashkullor me qëllim që të bëhet dallimi. Stereotipat mund të grupohen në kategori të ndryshme profesionale si në sferën private ashtu edhe në atë publike, siç janë shembujt në tekstet shkollore, p.sh. drejtorët e shkollave paraqiten si burra, shumica e mësimitdhënësve në shkolla fillore paraqiten si gra, shumica e profesorëve të universiteteve paraqiten si burra, etj. Mbiemrat që i përshkruajnë *cilësitë profesionale* duhet të ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet seksve në të gjitha fushat e jetës familjare, profesionale, shoqërore dhe politike.

Pozitat profesionale të nivelit të lartë duhet gjithashtu të shpërndahen në mënyrë të barabartë midis grave dhe burrave nëpërmjet përdorimit të mbiemrave në pozita si drejtorët e kompanive, spitaleve, institucioneve kërkimore, ndërmarrjeve tregtare dhe bankave, të cilat shumë shpesh përshkruhen me mbiemra që nënkuptojnë vetëm pozitë për burra dhe si të tilla shihen si pozita të udhëhequra vetëm nga burrat. Gratë gjithashtu duhet të jenë në gjendje t'i zgjedhin profesionet dhe të mbajnë pozita menaxheriale, të kenë përgjegjësisë dhe autoritet. Për ta arritur këtë, shqyrtuesi duhet të sigurojë që tabela në vijim merret parasysh gjatë shqyrtimit të gjuhës nga perspektiva profesionale dhe të përpiqet të sjellë barazi. Ky ndryshim do t'i bëjë nxënësit të kuptojnë se nuk ka fusha të rezervuara për një gjini dhe se gratë ashtu si burrat janë të afta të arrijnë sukses në çdo fushë të shoqërisë.

Tabela 13. Lista e termave të njëanshëm të profesioneve

Shmangni përdorimin e një gjinie	Në vend të tyre përdorni
Mjekët	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Infermier	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Udhëheqës	Udhëheqëse grua dhe udhëheqës burrë
Dhjetor	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Asistent administrativ	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Industrialist	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Bankier	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Elektricit	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Afarist	Afarist dhe afariste
Kryesues	Kryesues dhe kryesuese
Policë	Policë dhe police
Stjuardesë	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Inxhinier	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Kirurg	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Arkitekt	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Shitës	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Hulumtues	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Menaxher	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Mësimdhënëse	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Kryefamiljar	Përcaktojeni grua dhe/ose burrë
Arkëtar	Jo vetëm gjinia femërore (përdorni të dyja)
Model	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Bibliotekar	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Prezantues në radio ose televizion	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Sekretar	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Daktilografist	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Kamerier	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Furrtar	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Kasap	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Rrobaqepës	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Kuzhinier	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Shofer treni, autobusi, kamioni	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Mbikëqyrës	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Menaxher i fermës	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor

Nxënës	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Student	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Mësues	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Autor	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Poet	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Artist	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor
Punonjës i pakualifikuar	Të dy termat në gjuhën shqipe, femëror dhe mashkullor

Shqyrtuesi duhet ta rishqyrtojë tekstin dhe të shkruajë të gjitha termat që tregojnë profesionet bazuar në kategoritë e mësipërme. Mbledhja e informatave duhet të shënohet në tabelën e mëposhtme për të siguruar që gjuha ose më

saktësisht termat e mbiemrave mbi profesionet përfshijnë si gratë ashtu edhe burrat, djemtë dhe vajzat në kushte të barabarta.

Tabela 14. Përmbledhja e termave të profesioneve

Përmbledhje e termave të profesioneve	
Numri i përgjithshëm	
Numri i përgjithshëm i atyre të njëanshëm	Numri i përgjithshëm i atyre të paanshëm
<i>Shënim 1. p.sh. termi mjek gjatë gjithë kohës përdoret në trajtën e gjinisë mashkullore</i>	

ix. Mbiemrat për tiparet personale

Ekzistojnë shembuj të tjerë të gjuhësor që gjatë përdorimit të tyre i theksojnë stereotipet gjinor. Elementet e anshmërisë nuk marrin parasysh gamën e gjerë të kapaciteteve individuale të burrave dhe grave, dhe kështu më shumë se kurrë tiparet psikologjike të grave dhe burrave nuk përshkruhen njësoj në përmbajtjen e teksteve shkollore. Nëpërmjet përdorimit të mbiemrave, gratë dhe burrat bëhen dy personalitete të ndryshme dhe ekskluzive dhe dallimet arsyetohen sipas identitetit të tyre gjinor. Megjithatë ekziston një debat i vazhdueshëm mbi atë se çka është e

natyrshme dhe çka është krijuar nga shoqëria, tendenca për t'i ndarë me terma ekskluziv dëmton të dy gjinitë. Ekziston një tendencë e përgjithshme që gratë të përshkruhen më shumë me *mbiemra shoqëror* p.sh. të sjellshme, simpatike, ndërsa burrat me *orientim në aspekt të arritjeve*, të fokusuar në sukses personal (Menegati and Rubini, 2017) ⁸⁵. Tiparet shoqërore që i atribuohen grave janë po ashtu tipare të mbrojtjes që në përdorimin e përditshëm i vendosin ato në një pozitë nënshtruese dhe më të pafuqishme. Në vijim janë paraqitur shembuj që ilustrojnë dallimet.

⁸⁵ Menegati, M. & Rubini, M. (2017) Gender Bias and Sexism in Language. Oxford Research Encyclopedia (shqip: Menegati, M. & Rubini, M. (2017) Ndarja gjinore dhe Seksizmi në gjuhë. Enciklopedia Hulumtuese e Oxford-

it). Marrë nga <http://communication.oxfordre.com/view/10.1093/acrefore/9780190228613.001.0001/acrefore-9780190228613-e-470>

Tabela 15. Lista e tipareve të njëanshme psikologjike për orientim gjinor

GRATË – orientim shoqëror	BURRA – orientim në aspektin arritjeve
Bashkëshortë	Sigurojnë të hyrat
Fëmijë	Fitojnë
Bashkëshorte	Sukses
Bebe	Mendjehollë
Familje	Mendojnë
Kolegë	Dinë
Fëmijë	Veprojnë

Përdorimi i gjuhës së mësipërme për t'i përshkruar atributet gjinore i ndan edhe më shumë gratë dhe burrat. *Kjo gjuhë i përshkruan burrat si më aktivë dhe gratë më shpesh në role të pafuqishme ose të viktimës, më pasive dhe emocionale.* Burrat në përgjithësi përshkruhen si ekspertë shumë të dijsëm dhe inteligjentë, kurse gratë përshkruhen si të adhureshme, të pëlqyeshme dhe shumë të përkushtuara në punën e tyre. Edhe terminologjia që përdoret për t'i përpiluar

nekrologjitë për menaxherët burra dhe gra të vdekur i pasqyron stereotipat gjinor p.sh. një burrë i madh, një grua e dashur (Menegati and Rubini, 2017)⁸⁶. Përshkrimi i tillë i tipareve përmes përdorimit të gjuhës bën që statusi i grave dhe burrave të mbetet i padiskutueshëm, ku gratë mbahen në një status më të ulët, si dhe tekstet shkollore vazhdojnë të përforcojnë pabarazinë ekzistuese gjinore të treguar në tabelën e mëposhtme.

Tabela 16. Lista e termave të njëanshëm psikologjik për gratë dhe burrat

GRATË	BURRA
Të sjellshme	Dominuesë
Të dobishme	Të fortë
Dashamirëse	Të pavarur
Të dashura	Të sigurtë
Të këndshme	Të hapur
Pasive	Aktivë
Jo intelektuale	Intelektualë
Emocionale	Ambiciozë
Të qeta	Agresivë
Të frikësuara	Të ftohtë
Të pavendosura	Të ditur
Të palogjikshme	Ekspertë
Të pëlqyeshme	Të ashpër
Të ndjeshme	Me përvojë

⁸⁶ Menegati, M. & Rubini, M. (2017) Gender Bias and Sexism in Language. Oxford Research Encyclopedia. (shqip: Menegati, M. & Rubini, M. (2017) Ndarja gjinore dhe Seksizmi në gjuhë. Enciklopedia Hulumtuese e Oxford-

it) Marrë nga <http://communication.oxfordre.com/view/10.1093/acrefore/9780190228613.001.0001/acrefore-9780190228613-e-470>

Të dobëta	Të suksesshëm
Pasive	Të vendosur
Të varura	Heroikë
Të buta	Të pakujdesshëm
Të kujdesshme	Ngatërrestarë
	Të zhurshëm
	Kompetent
	Të përkushtuar
	Të etur për të mësuar

Megjithatë, në të gjitha fushat e kurrikulës nuk ekziston asnjë lëndë, ku nuk dalin në pah atributet psikologjike me stereotipat se burrat janë më të logjikshëm dhe objektiv ndërsa gratë emocionale dhe subjektive. Në përshkrime gruaa apo vajza duhet të portretizohen si personi më i zgjuar, më i guximshëm ose më i suksesshëm po aq shpesh sa burrat apo djemtë. Gratë duhet të paraqiten si të interesuara për punën e tyre, që ndjekin një sërë qëllimesh të karrierës dhe marrin njohje publike për arritjet e tyre. Në përgjithësi, karakteristikat negative ose pozitive duhet të ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet të dy seksëve, ku gratë përshkruhen se posedojnë mprehtësi, shkathtësi dhe aftësi në të njëjtën masë si burrat në të njëjtat vende pune, situata, pozita, përvoja, etj.

Shqyrtuesi duhet të përpiqet të sjellë barazinë duke i portretizuar burrat dhe djemtë si dhe gratë dhe vajzat gjatë përdorimit të mbiemrave si të pavarur, aktiv, të fortë, të guximshëm, kompetentë, të vendosur, këmbëngulës, serioz dhe të suksesshëm. Si burrat ashtu dhe gratë duhet të paraqiten si të logjikshëm, zgjidhës të problemeve dhe vendimmarrës. Burrat nganjëherë duhet të portretizohen nga mbiemrat si: të qetë dhe pasivë, ose të frikësuar dhe të pavendosur, ose të palogjikshëm dhe të papjekur gjithashtu,

mbiemra këta që përdoren për të portretizuar vetëm gratë. Në mënyrë të ngjashme, gratë, nëse është e nevojshme dhe relevante për një kontekst të caktuar, ndonjëherë duhet të tregohen si të ashpra, agresive dhe të ftohta.

Për më tepër, shqyrtuesi duhet të synojë që të sjellë numra të barabartë të vajzave, djemve, grave dhe burrave që cilësohen si aktivë, të pavarur, të patrembur, me vetëbesim, të vendosur, këmbëngulës, guximtarë dhe heroik; ose, në të kundërtën, si pasiv, të varur, të ndruajtur, të pasigurt, të pavendosur, hezitues dhe frikacak. Këto tipare të karakterit, si ato negative ashtu edhe ato pozitive, duhet të shpërndahen në përmasa të barabarta ndërmjet të të dy seksëve në çfarëdo konteksti që gjenden; familje, shoqëri, arsim, karrierë, shoqëri, kohë të lirë, sport, politikë, etj. Rekomandohet të ketë shembuj të *djemve që shprehin emocione si ps.sh. të ndijshëm, qajnë, etc., grave të forta dhe të guximshme, burrave të ndjeshëm, burrave që shmangin konfliktin, etj.* Për ta arritur këtë, shqyrtuesi duhet të marrë parasysh shpërndarjen e attributeve midis burrave dhe grave, djemve dhe vajzave në përmbajtje bazuar në elaborimin e mësipërm dhe vlerësimin e anshmërisë së tyre për t'i shënuar ato në tabelën më poshtë.

Tabela 17. Përmbledhja e tipareve psikologjike

TIPARET PSIKOLOGJIKE	
Numri i përgjithshëm	
Numri i përgjithshëm i atyre të njëanshëm	Numri i përgjithshëm i atyre të paanshëm
Shënim 1. <i>p.sh. termi aktiv përdoret për t'i përshkruar burrat dhe djemtë, termi i qetë përdoret për t'i përshkruar gratë dhe vajzat</i>	1.
2.	2.
3.	3.
4.	4.

x. Barabarësia në përshkrime - Paralelizmi

Siç u përmend më lart, shqyrtimi duhet të mundohet t'i trajtojë gratë dhe burrat me respekt, dinjitet dhe seriozitet, si dhe si qenie njerëzore të barabarta. Tekstet nuk duhet të përmbajnë stereotipa gjinorë dhe asnjëra gjini nuk duhet të portretizohet si më pak e rëndësishme. Asnjëra gjini nuk duhet të vendoset në pozicion superior dhe as inferior. Në kuptim të gjuhës, kjo konvertohet në një përdorim të paralelizmit në përshkrimin e tyre në tekst, p.sh. gratë nuk duhet të përshkruhen vetëm në bazë të attributeve fizike përderisa burrat përshkruhen në bazë të attributeve mendore ose pozitës profesionale. Këshillohet që të shmanget përdorimi i përshkrimeve dhe pozicionimi i grave si gjinia më e dobët, nevojtare dhe pasive, po ashtu edhe vetëm si objekt i bukurisë, si gjysma më e mirë, si dhe objektifikimi i grave krahasuar me burrat që paraqiten në terma të kundërt. Përdorimi i gjuhës duhet të sigurojë që gratë të paraqiten paralelisht me burrat si subjekte, të pavarura dhe individë të formuar mirë. Gjithashtu, përdorimi i gjuhës duhet të sigurojë që nënkategoritë janë pjesë e përmbajtjes. Në vend të kësaj, të dy gjinitë duhet të trajtohen në terma paralelë.

Në vijim është paraqitur një shembull për ilustrim.

Shembull 1.

Z. Fazliu është avokat mendjemprehtë dhe gruaja e tij Hana është një zeshkane mbresëlënëse.

Çifti Fazliu janë një çift tërheqës. Antoni është biond i bukur dhe Hana është zeshkane mbresëlënëse.

Çifti Fazliu janë shumë të respektuar në fushat e tyre. Hana është muzikante e kualifikuar dhe Antoni është avokat mendjemprehtë.

Çifti Fazliu janë një çift interesant. Antoni është avokat mendjemprehtë dhe Ana është shumë aktive në çështjet e komunitetit (Mani, 1995)⁸⁷

Shembull 2.

Shtegtarët u shpërngulën drejt perëndimit duke marrë gratë dhe fëmijët e tyre me vete.

Familjet e shtegtarëve u shpërngulën drejt perëndimit. Shtegtarët burra dhe gra (ose çiftet pionierë) u shpërngulën drejt perëndimit së bashku me fëmijët e tyre.

⁸⁷ Mani, A. Gender Bias in School Textbooks (shqip: Mani, A. Ndarja gjinore në Tekstet Shkollore). (1995). Marrë nga <https://doi.org/10.14217/9781848595484-EN>

xi. Dialogët

Tekstet përbëhen nga lloje të ndryshme dialogësh. Ka dialogë të përzier gjinor dhe të njëjtë, si dhe dialogët mes një karakteri asnjës dhe një karakteri femëror apo mashkullor. Dialogët e përzier gjinore përfshijnë karaktere më shumë se një gjini, ndërkohë që dialogët e njëjtë gjinor përfshijnë karaktere vetëm të një gjinie. Lloji i tretë i dialogut, i cili përfshin një karakter asnjëanës, llogaritej si dialog i përzier gjinor. Karakteri asnjës gjithmonë do të përfaqësojë diçka që nuk është as femër as mashkull dhe prandaj mund të argumentohet të jetë një tjetër gjini. Analiza e dialogëve mund ta zbulojë edhe përfaqësimin gjinor. Shqyrtimi duhet t'i kushtojë vëmendje të folurit me radhë në dialog duke pasur në mendje të tij/saj disa pika (Malmsjo & Johansson, 2009, p.21)⁸⁸

- *Barazia në fillimin e dialogut (kush do të fillojë dialogun)*
- *Barazia në numrin e personazheve të përfshirë në komunikim dhe radha në të folur (sa burra /gra janë*

të përfshirë në një bisedë specifike)

- *Barazia në përfshirjen në tema (p.sh. gratë nuk duhet të flasin vetëm për tema private, ndërsa burrat të flasin për biseda zyrtare)*
- *Barazia në mjediset e dialogut (privat kundrejt publik).*

Duke pasur parasysh atë që u tha më lart, gjuha duhet të jetë në gjendje të shqyrtojë të gjitha përshkrimet e situatave në tekst dhe të shohë nëse ekziston një paralelizëm apo barazi në përshkrimin e burrave dhe grave për të analizuar dhe për të përfunduar nëse janë të njëanshme apo jo. Biseda dhe dialogët në tekstin shkollor gjithashtu ekspozojnë marrëdhëniet gjinore dhe prezantimin. Shqyrtuesi duhet të bëjë një analizë duke pasur parasysh pyetjet e mësipërme. Duhet të përfundojë në bazë të gjetjeve nëse ato janë të njëanshme ose jo dhe t'i shënoni në pyetjen e mëposhtme. Ju lutem, jepni komente mbi gjetjet ose trendet specifike.

Tabela. 18. Përmbledhje e gjuhës në përmbajtje

Përmbledhje e dialogëve		
Numri i përgjithshëm		
Kategoritë	I anshëm	I paanshëm
Dialogët (fillimi, përfshirja, tema)		
Komentet		
Paralelizëm		
Komentet		

⁸⁸ Malmsjo. B.K. & Joahnsson, S. (2009) Gender Bias in EFL Textbook Dialogues (shqip: Malmsjo. B.K. & Joahnsson, S. (2009) Ndarja gjinore në

Dialogët e Teksteve Shkollore EFL). Malmo Hosklola. Marrë nga <http://muep.mau.se/handle/2043/8217>

Shqyrtuesi duhet të bëjë një përmbledhje të të gjitha tabelave të mësipërme për t'i përmbledhur gjetjet. Tabela në vijim është një përmbledhje për analizën e përmbajtjes.

Tabela.19. Përmbledhje e analizës së përmbajtjes

PËRMBAJTJA		
PREZANTIM INDIVIDUAL		
TOTALI	I anshëm	I paanshëm
Shënimet përmbledhëse: <i>p.sh. mungesa e vajzave RAE, mungesa e LGBT</i>		
PREZANTIM NË GRUP		
TOTALI	I anshëm	I paanshëm
Shënimet përmbledhëse		
PËRMBLEDHJE E PËRMBAJTJES		
PASAZHET E TEKSTIT (titujt, trupi, shembujt, ushtrimet)		
Numri i përgjithshëm i mësimeve	I anshëm	I paanshëm
AKTIVITETET NË TEKST		
Totali	I anshëm	I paanshëm
GJUHA E TEKSTIT (përshkrimi cilësor)		
I anshëm	I paanshëm	

II. ILUSTRIMET

i. Shpërndarja gjinore në ilustrime

Ilustrimet në formë të fotografive tregojnë shumë për përfaqësimin e grave dhe burrave si dhe djemve dhe vajzave. Për të kuptuar më mirë se si ilustrimi mund të forcojë apo zbusë dallimet në baza gjinore, ngjashëm sikurse teksti, ilustrimet tregojnë shpërndarjen e grave dhe burrave, djemve dhe vajzave në fotografi. Shumë shpesh, shpërndarja është jo e barabartë. Për të pasur një pasqyrë të qartë të

përmbajtjes, shqyrtuesi duhet të bëjë një shqyrtim nga afër dhe të hollësishëm të shpërndarjes së individëve dhe grupeve në ilustrime. Duke përdorur tabelën më poshtë, shqyrtuesi duhet të marrë parasysh shpërndarjen e bazuar në numërimin e thjeshtë në të gjitha ilustrimet që kalojnë nëpër çdo kapitull dhe mësim.

Tabela 20. Shpërndarja gjinore e individëve dhe grupeve në ilustrime

PËRFAQËSIM INDIVIDUAL						
TOTALI	Gratë	Burrat	Djemtë	Vajzat	Pa përcaktim gjinor	
<i>p.sh. gjithsej 800 gra, 150 të bardhë 200 rural etj.</i>						
Nënkategoritë						
Të vjetër/të rinj						
Shumicë/pakicë						
Të bardhë/Jo të bardhë						
Urban/Rural						
Shënime përmbledhëse: <i>p.sh. mungesë e vajzave nga komuniteti RAE, mungesa e LGBT</i>						
PËRFAQËSIM GRUPOR						
Totali	Gratë	Burrat	Djemtë	Vajzat	Të përzier	Pa përcaktim gjinor
Nënkategoritë						
Të vjetër/të rinj						
Shumicë/pakicë						
Të bardhë/Jo të bardhë						
Shënime përmbledhëse: <i>p.sh. grupe të përziera të grave në kuzhinë</i>						

Megjithatë, anshmëria në ilustrime është me shumë shtresa. Ka shumë elemente që duhet marrë parasysh për të kuptuar përfaqësimin dhe ndërveprimin e karaktereve si aktivitetet, pozicionimi dhe ndarja e hapësirës, shpërndarjen dhe pamjen e tipareve. Shqyrtuesi duhet të marrë parasysh përfshirjen në aktivitete duke shtruar pyetjet e mëposhtme:

- Cilat aktivitete dhe kujt i caktohen në sferën private dhe publike? Cilat aktivitete përfshijnë një grup dhe përjashtojnë tjetrin?
- Cilat aktivitete shumicën e përfaqësuesve e kanë burra dhe cilat gra?
- Në aktivitete ku janë të përfshira të dy grupet, deri në çfarë masë përfshihen burrat dhe gratë? Kush është i përfshirë në aktivitete të vogla dhe të mëdha?
- A ka përfshirje të barabartë? A caktohen rolet në mënyrë të barabartë?
- Kush ka rol periferik dhe kush ka rol qendror në të njëjtat aktivitete?
- Kush ka rol periferik dhe kush ka rol qendror në të njëjtat aktivitete?
- Kush është heroi dhe kush i panjohuri?
- Kush është vendosur si karakter kryesor dhe kush si dytësor?

- Kush paraqitet statik dhe kush paraqitet aktiv?
- Kush paraqitet si vrojtues dhe kush si veprues?
- Kush përfaqëson grupet e pa përcaktuara gjinore? A mund të caktohen në baza gjinore?

Lista e aktiviteteve e dhënë më poshtë paraqet përfshirjen në sferën private dhe publike. Për të pasur një pasqyrë më të qartë të elementeve të përmendura më sipër, shqyrtuesi duhet të identifikojë se si janë të përfshirë në aktivitete gratë dhe burrat si dhe vajzat dhe djemtë. Ai ose ajo duhet të sigurohet që aktivitetet më poshtë janë gjithëpërfshirëse dhe jo të bazuara në stereotipe gjinore.

- Si janë gratë dhe burrat të përfshirë në aktivitete profesionale (p.sh. pozita dhe rolet)?
- Si janë gratë dhe burrat, djemtë dhe vajzat të përfshirë në aktivitete politike dhe sociale?
- Si janë gratë dhe burrat, djemtë dhe vajzat të përfshirë në aktivitete shkollorë?
- Si janë gratë dhe burrat, djemtë dhe vajzat të përfshirë në aktivitete familjare?
- Si janë gratë dhe burrat, djemtë dhe vajzat të përfshirë në aktivitete të kohës së lirë (p.sh sport, lojëra etj.

Tabela 21. Shpërndarja e aktiviteteve sipas gjinisë në ilustrime

AKTIVITETET NË ILUSTRIM			
	Gjithsej	Meshkuj	Femra
<i>p.sh. 50 aktivitete profesionale 35 të njëanshme të orientuara drejt meshkujve</i>			
Asnjë aktivitet profesional			
I anshëm			
I paanshëm			
Asnjë aktivitet politik dhe social			
I anshëm			
I paanshëm			
Asnjë aktivitet shkollor			
I anshëm			
I paanshëm			
Asnjë aktivitet familjar			
I anshëm			
I paanshëm			
Aktivitete të tjera të kohës së lirë (sport, lojëra etj.)			
I anshëm			
I paanshëm			
TOTALI			
Shënime (bazuar në analizën cilësore) <i>p.sh. ekziston mungesë e racës së përzier në lojëra, prania e grave të komunitetit RAE në aktivitete më të ulëta familjare, mungesa e LGBT)</i>			

Duke i kushtuar vëmendje aktiviteteve nuk është e mjaftueshme për të kuptuar dhe analizuar pabarazinë. Vëmendje e mëtijshme duhet t'i kushtohet hapësirës dhe madhësisë, që të identifikohet pozicioni në hapësirë dhe madhësi duke pasur parasysh pyetjet më poshtë në lidhje me gratë dhe burrat, djemtë dhe vajzat në imazhe.

- Kush gjendet në qendër dhe kush në periferi?
- Kush përfaqësohet në madhësi më të madhe dhe kush në më të vogël?
- Kujt i jepet më shumë hapësirë dhe kujt më pak?
- Kush paraqitet në figura simbolike (p.sh. histori, politikë, letërsi)?

Për më tepër, shqyrtuesi duhet të marrë parasysh pamjen e burrave dhe grave, djemve dhe vajzave duke shtruar pyetjet e mëposhtme.

- A janë duke u paraqitur vetëm gratë në veshje dhe paraqitje konvencionale (edhe kur nuk është e përshtatshme për pozitën dhe situatën)?
- A janë duke u paraqitur vetëm burrat në veshje dhe paraqitje formale, moderne, elegante?
- A janë duke u paraqitur gratë dhe burrat me fytyra, shprehje dhe qëndrime të ndryshme në situata të ndryshme apo si stereotipet e zakonshme me karakteristika 'mashkullore' dhe 'femërore' të paraqitjes)?

- A janë paraqitur gratë shprehjen e zakonshme ('femërore') prej gruas së dashur, të këndshme, të qetë dhe dashamirëse, mes tjerash?
- A janë paraqitur burrat shprehjen e zakonshme arrogante, aktive, nxitëse ('mashkullore'), mes tjerash?

Përveç kësaj, duhet të shqyrtojmë tiparet e mëposhtme të cilat në imazhe përshkruajnë grupet.

- A paraqiten vetëm gratë si dashamirëse, nëna të dashura, bartëse të fëmijëve, kujdestare?
- A paraqiten vetëm gratë si të varura nga diçka dhe dikush?
- A paraqiten vetëm gratë në marrëdhënie dhe aktivitete me fëmijë?
- A paraqiten gratë në publik si një zgjatje e privates (p.sh. një nënë që bëhet mjeke)?
- A paraqiten gratë si aktive dhe të lumtura në kornizat e zakonshme të familjes tradicionale (p.sh. gratë pa fëmijë, pa burra, në lidhje etj.)?
- A paraqiten gratë si aktive, të lumtura dhe të suksesshme (p.sh. në biznes, politikë, ekonomi, sipërmarrësi etj.)?

Të mësipërmet duhet të analizohen njëkohësisht. Për të sqaruar të mësipërmet, ka edhe shembuj të imazheve të dhëna më poshtë.

ii. Përfaqësimi gjinor i fëmijëve në lojëra dhe aktivitete

Lojërat dhe aktivitetet shkollore për fëmijë ndahen në baza gjinore. Lojërat dhe aktivitetet ndahen sipas gjinisë (vetëm vajzat luajnë me kukulla, vetëm djemtë luajnë futboll, vetëm djemtë bëjnë eksperimente në laboratorë shkollorë). Qoftë brenda apo jashtë shtëpisë, lojërat e fëmijëve nuk duhet të ndahen në baza gjinore. Si vajzat, ashtu edhe djemtë do të kenë kukulla dhe të luajnë në festa të fëmijëve, të dy gjinitë mund të marrin pjesë në lojëra me top, lojëra elektronike, ngjitje në pemë, qepje, kopshtari, thurje e kështu me radhë. Grupet duhet të përfaqësohen nga djemtë dhe vajzat në të gjitha lojërat. Të gjithë fëmijët duhet të paraqiten si

aventurier dhe lozonjar. Përveç kësaj, “udhëheqja” në lojëra duhet të ndahet barazi mes dy gjinive. Kjo duhet të kërkohet në ilustrime por edhe të pasqyrohet në përmbajtjen e përgjithshme. Ilustrimet e mëposhtme japin shembuj të lojërave dhe aktiviteteve të njëanshme dhe të paanshme të fëmijëve. Balanca gjinore në lojëra dhe aktivitete të djemve dhe vajzave do të ketë një ndikim pozitiv tek nxënësit jo vetëm në pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse dhe ndërveprimin brenda dhe jashtë shkollës. Kjo do të ndikojë edhe në të menduarit e tyre rreth aktiviteteve me baza gjinore.

Stereotipet

Lojrat

Fillon që në fëmijëri...
ndarja gjinore



Vajza duke luajtur me një kukull,
djali me blloqe ndërtimi.



Vajza dhe djem duke luajtur
veçmas në lojëra të ndryshme



Vajza në këmbë



Djali duke vozitur, vajza duke
parë e përqëndruar përreth




Djali duke ngarë biçikletën

⁸⁹ Michel, A. (1986) Down With Stereotypes. (Poshtë Stereotipet) Eliminating Sexism from Children's literature and School Textbooks. (shqip: Eliminimi i seksizmit nga literatura e fëmijëve dhe tekstet shkollore) UNESCO, Paris. Marrë nga <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000070590>

Ilustrimi 2. Shembuj të imazheve të lojërave pa përcaktime gjinore (djemtë/vajzat ndajnë të njëjtat lodra dhe janë të lirë të zgjedhin lojërat) (f. 37)⁹⁰

Drejt barazisë së gjinive



⁹⁰ Michel, A. (1986) Down With Stereotypes. (Poshtë Stereotipet) Eliminating Sexism from Children's literature and School Textbooks. (shqip: Eliminimi i seksizmit nga literatura e fëmijëve dhe tekstet shkollore) UNESCO, Paris. Marrë nga <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000070590>


a) Përfaqësimi gjinor në familje

Pavarësisht temës së teksteve shkollore, gjithnjë ka përfaqësim gjinor në sferën e brendshme. Teksti shkollor që nuk përmban anshmëri gjinore gjithsesi se do të tregojë një numër të barabartë të vajzave dhe djemve që kryejnë detyra familjare dhe që kujdesen për vëllezërit dhe motrat. Të dy prindërit do të paraqiten (gratë dhe burrat) duke bërë punë shtëpiake, duke edukuar dhe duke u kujdesur për fëmijët. Nëna dhe babai duhet të portretizohen si prindër të barabartë, duke pasur kështu të njëjtat përgjegjësi. Fëmijët në ilustrime duhet të paraqiten barazisht të afërt me prindërit dhe në shoqërinë e baballarëve dhe nënave të tyre. Me ilustrime të tilla shmangim sugjerimin të rinjtë se vetëm gratë angazhohen në rritjen dhe kujdesin për fëmijët. Për më

tepër, ne paraqesim familjen si një njësi pa bazë gjinore ku secili, pavarësisht gjinisë, ka një rol, përgjegjësi dhe hise.

Shqyrtuesi duhet të sigurojë që paraqitja e familjes nuk bazohet vetëm në aspekt tradicional, përkatësisht si një familje që ka babën, nënën dhe fëmijët. Tekstet shkollore duhet të ofrojnë lloje të tjera të mundshme të familjes, duke filluar nga familja e zgjeruar, në të cilën prindërit dhe fëmijët jetojnë me gjyshërit, të afërmit dhe jo të afërmit, deri tek familjet me një prind (të udhëhequra nga gratë dhe burrat), gratë kryefamiljare ose gratë që janë shtylla të familjes. Përderisa kjo duhet të pasqyrohet në ilustrime, duhet të jetë edhe pjesë e përmbajtjes së përgjithshme

Ilustrimi 3. Shembuj të imazheve të paraqitjes së njëanshme gjinore të familjes dhe ndarja e roleve familjare (f. 38)⁹¹



⁹¹ Michel, A. (1986) Down With Stereotypes. (Poshtë Stereotipet) Eliminating Sexism from Children's literature and School Textbooks. (shqip: Eliminimi i seksizmit nga literatura e fëmijëve dhe tekstet shkollore) UNESCO, Paris. Marrë nga <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000070590>

Ilustrimi 4. Shembuj të ilustrimeve të balancës gjinor në familje (p. 39-41)⁹²

Drejt barazisë së gjinive

Aktivitetet e kohës së lirë dhe rolet në familje ndahen pa diskriminim



Babai dhe nëna kujdesen së bashku për fëmijët e tyre



Babai duke lexuar me vajzën, nëna duke lexuar me djalin

Drejt barazisë së gjinive

Fëmijët dhe të rriturit e të dy gjinive që bëjnë punët e shtëpisë



Babai duke shtruar tryezën me vajzën



Djali duke bërë punët e shtëpisë



Një djalë dhe një vajzë duke përgatitur ushqimin


⁹² Michel, A. (1986) Down With Stereotypes. (Poshtë Stereotipet) Eliminating Sexism from Children's literature and School Textbooks. (shqip: Eliminimi i seksizmit nga literatura e fëmijëve dhe tekstet shkollore) UNESCO, Paris. Marrë nga <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000070590>

iii. Prezantimi i gjinisë në sferën publike (profesionet)

Në sferën publike, zgjedhja e profesionit/punës në masë të madhe përcaktohet në baza gjinore. Përderisa në realitet mund të jetë e vërtetë, është shumë e rëndësishme që tekstet shkollorë të sfidojnë këtë dhe shqyrtuesi të bëjë përpjekje për të shmangur profesionet në baza gjinore. Në tekstin shkollor që nuk përmban paragjyime gjinore, gratë nuk përshkruhen vetëm si infermiere dhe mësuese, por edhe si profesioniste të fushave të ndryshme. Hulumtimet tregojnë se në të gjithë botën në tekstet shkollorë, shumica e profesioneve shkencore janë profesione të identifikuar vetëm për meshkujt. Profesionet me përcaktimet e tilla

gjinore e cenojnë lirinë e përzgjedhjes së profesioneve për nxënësit. Pasi të jenë të ekspozuar ndaj paragjykimeve gjinore, ata mund të fillojnë të besojnë se profesionet tashmë janë të përcaktuara. Ndikimi në vendimet e ardhshme të djemve dhe vajzave mbi profesionin e tyre nëpërmjet informacionit të njëanshëm mund t'i bëjë nxënësit të marrin rrugët e gabuara të karrierës. Me vetëdije ose pa vetëdije, vendimi ndikohet në bazë të njohurive që ata marrin dhe besimeve që paraqiten si realitet. Megjithatë, pikërisht ky nuk është roli i arsimit. Më poshtë janë dhënë shembuj të profesioneve me dhe pa anime në baza gjinore.

Ilustrimi 5. Shembuj të profesioneve në baza gjinore (Mani, 1995, f. 6)⁹³



⁹³ Mani, A. Gender Bias in School Textbooks. (Paragjykimet gjinore në tekstet shkollorë) (1995). Marrë nga <https://doi.org/10.14217/9781848595484-EN>

Ilustrimi 6. Shembuj të profesioneve që nuk janë në baza gjinore (f. 43)⁹⁴



⁹⁴ Michel, A. (1986) Down With Stereotypes (Poshtë stereotipet). Eliminating Sexism from Children's literature and School Textbooks (Eliminimi i seksizmit nga literature dhe tekstet shkollore të fëmijëve). UNESCO, Paris, France. Marrë nga <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000070590>

Në bazë të shpjegimeve të dhëna më lart dhe sqarimeve me ilustrime, shqyrtuesi duhet të shikojë të gjitha pjesët e analizës së ilustrimit dhe të nxjerrë një përfundim duke përdorur tabelën e mëposhtme.

Tabela 22. Prezantimi gjinor në ilustrim

ILUSTRIMI		
HAPËSIRA DHE MADHËSIA		
GJITHSEJ	KONVENCIONALE	JO KONVENCIONALE
PARAQITJA		
GJITHSEJ	KONVENCIONALE	JO KONVENCIONALE
TIPARET		
GJITHSEJ	KONVENCIONALE	JO KONVENCIONALE

Bazuar në shembujt dhe kriteret e mësipërme, shqyrtuesi mund të kalojë të gjitha fotografitë e të gjitha ilustrimeve në tekstin shkollor, së pari duke kaluar përmes ballinës dhe pastaj çdo njësie mësimore të teksteve shkollore. Me një analizë të detajuar të kategorive kryesore, por edhe me vëmendje ndaj nënkategorive, rekomandohet të përmbliidhen shpërndarjet e individëve dhe grupeve. Përmbledhja duhet të vlerësojë imazhet (fotografitë, vizatimet, ilustrimet, pikturat) bazuar në aktivitetet dhe rolet, pozicionimin në madhësi dhe hapësirë, paraqitjet dhe tiparet dhe gjetjet në tabelat e mësipërme. Duke i marrë parasysh të gjitha këto, shqyrtuesi duhet t'i shënojë ato si të anshme dhe të paanshme në aspektin gjinor.

Tabela 23. Përmbledhje e prezantimeve gjinore në ilustrime

PËRMBLEDHJE E PREZANTIMEVE GJINORE NË ILUSTRIME		
PREZANTIM INDIVIDUAL		
GJITHSEJ	E ANSHME	E PAANSHME
PREZANTIMI GRUPOR		
GJITHSEJ	E ANSHME	E PAANSHME
PËRMBLEDHJE KUALITATIVE		
GJITHSEJ nr.	E ANSHME	E PAANSHME
Shënimet: <i>p.sh, mungon përzierja në bazë të racës në lojëra,</i> <i>Gratë e komuniteteve roma, ashkali dhe egjiptas përfshihen vetëm në aktivitetet më të ulëta shtëpiake,</i> <i>burrat kryesisht zënë pozicionet qendrore</i> <i>gratë paraqiten të jenë pasive</i>		

III. PËRMBLEDHJA PËRFUNDIMTARE DHE REKOMANDIMET

Shqyrtimi i një teksti mësimor duke përdorur mjetet, tabelat dhe përmbledhjet, si dhe listat kontrolluese të dhëna më lart, do të japë informata të mjaftueshme për shqyrtuesin që të arrijë në një përfundim të caktuar mbi nivelin e paragjytimeve gjinore në tekste dhe ilustrime. Kjo do të shpalosë sistemin gjinor në tekstet shkollore dhe nivelin e paragjytimeve në bazë të informacioneve të mbledhura. Rishikuesi duhet të sigurohet që të gjitha elementët (përmbajtja dhe ilustrimet) të përafruara. Ja disa nga hapat që duhen ndjekur:

- Të gjitha tabelat në dokument duhen të plotësohen me

informacion dhe të dhëna të detajuara. Pas përfundimit, ato duhet t'i ofrohen autorit të tekstit shkollor për një rishikim shumë të detajuar.

- Informacioni i grumbulluar nga tabelat dhe shënimet duhet të përmbledhet në tabelë mëposhtme në një tabelë të formatuar. Në secilën kategori, ekziston gjithashtu një hapësirë për rekomandime konkrete për çdo kategori bazuar në mendimin e shqyrtuesit.
- Në përfundim, duhet të bëhet një vlerësim përfundimtar nëse libri përmbush standardin e barazisë gjinore apo jo.

Table 24. Summary Table for Textbook Evaluation

PËRMBLEDHJE E PRESENTIMIT GJINOR NË ILUSTRIME		
TEKSTI		
	Rezultatet sasiore (ju lutem përmendni vetëm ato të anshme)	Rezultatet cilësore
Shpërndarja e individëve		
Shpërndarja e grupeve		
Individët e papërcaktuar sipas gjinisë		
Grupet e papërcaktuar sipas gjinisë		
Citimet		
REKOMANDIMET: (ju lutem shkruani rekomandimet për autorin dhe MASHT) <i>p.sh më tepër përfaqësim të grave të moshuara në të gjithë takstin aty ku konteksti e lejon</i>		
FRAGMENTET E TEXTIT		
	Rezultatet sasiore	Rezultatet cilësore
Gjetjet e titujve		
Teksti me shembuj dhe ushtrime		
Aktivitetet		
REKOMANDIMET:		

GJUHA		
	Rezultatet sasiore	Rezultatet cilësore
Shprehje mashkullore		
Mbiemra (profesional)		
Mbiemra (psikologjik)		
Gjuha në dialog		
Gjuha në paralelizëm		
REKOMANDIMET:		
ILUSTRIMET		
	Rezultatet sasiore	Rezultatet cilësore
Shpërndarja e individëve		
Shpërndarja e grupeve		
Individët e papërcaktuar sipas gjinisë		
Grupet e papërcaktuar sipas gjinisë		
Aktivitetet		
Hapësira dhe madhësia		
Paraqitja		
Tiparet		
REKOMANDIMET:		
VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR: <i>p.sh. Libri i plotëson/nuk i plotëson kriteret e barazisë gjinore. Duhet të rishikohet duke pasur parasysh komentet e mësipërme dhe tabelat që i janë dhënë autorit.</i>		

SHTOJCA 1 - KONCEPTET KRYESORE GJINORE

GJINIA

Fjala gjini i referohet atribuimeve shoqërore që lidhen me të qenurit femër ose mashkull, marrëdhënieve midis burrave dhe grave, marrëdhënieve midis djemve dhe vajzave, si dhe marrëdhënieve mes grave dhe marrëdhënieve mes burrave. Këto atribuime, marrëdhënie dhe mundësi krijohen nga shoqëria dhe mësohen përmes proceseve të socializimit. Gjinia është një identitet që mësohet, ndryshon në kohë dhe ndryshon përgjatë kulturave. Gjinia nuk i referohet thjesht një burri a një gruaje, por më tepër lidhjes mes tyre. Gjinia nuk përshkruan karakteristikat biologjike dhe seksuale që identifikojnë burrat dhe gratë, por shërben për të përcaktuar rolet sociale të qëndrimeve dhe vlerave që komuniteti social i paraqet ata si të përshtatshme për njërin apo tjetrin seks.

SEKSI

Seksi përshkruan ndryshimet biologjike midis burrave dhe grave, të cilat janë universale dhe përcaktohen në lindje.

IDENTITETI GJINOR

I referohet përkufizimit si një konceptim personal dhe shoqëror i subjektit dhe kategorisë mbi veten në marrëdhëniet midis seksit dhe gjinisë.

SEKSUALITETI

Është një model i qëndrueshëm i tërheqjes romantike ose seksuale (ose një kombinim i këtyre dyve) për personat e gjinisë ose seksit të njëjtë, ose më shumë se një gjinie. Këto tërheqje përgjithësisht përfshihen nën emrat e heteroseksualitetit, homoseksualitetit, biseksualitetit.

HETEROSEKSUAL

Një person i cili ka tërheqje fizike dhe emocionale vetëm nga persona të një seksit tjetër.

HOMOSEKSUAL

Një person që ka tërheqje fizike dhe emocionale nga personi i të njëjtit seks.

LEZBIKE

Një femër që ka tërheqje fizike dhe emocionale për një grua tjetër.

GAY

Një mashkull që ka tërheqje fizike dhe emocionale për një burrë tjetër.

I DYGJINISHËM

Një person i cili tërhiqet fizikisht nga të dyja gjinitë.

TRANSGJINOR

Një person gjinia ose identiteti i të cilit nuk përputhet me seksin e lindur.

INTERSEKSUAL

Është një term i përgjithshëm i përdorur për të emëruar shumëllojshmërinë e kushteve në të cilat një person lind me një anatomi riprodhuese ose seksuale që nuk duket e përshtatshme për përkufizimet tipike të femrave dhe meshkujve.

ROLET GJINORE

Komunitetet dhe shoqëritë krijojnë norma shoqërore të sjelljes, vlerave dhe qëndrimeve që mendojnë se janë të përshtatshme për gratë dhe burrat, si dhe për marrëdhëniet midis tyre. Këto role përcaktohen sipas kritereve sociale, jo biologjike. Rolet gjinore ndahen sipas seksit; ata janë një klasifikim social dhe jo biologjik. Për shembull, nëse kujdesi për fëmijët klasifikohet si rol i gruas, atëherë ky është një rol shoqëror, jo një rol i përcaktuar në bazë të seksit biologjik, sepse edhe burrat edhe gratë mund ta bëjnë këtë.

STEREOTIPET GJINORE

Ky është një portretizim konstant në media dhe publikim i roleve sociale të grave dhe burrave të përcaktuara sipas ndarjes tradicionale të roleve dhe detyrave në një shoqëri specifike. Këto role gjinore ndajnë detyrat dhe përpjekjet duke forcuar më tej ndarjen gjinore të punës dhe duke i portretizuar ato si ndarje “normale” dhe “natyrore” të detyrave.

VERBËRIA GJINORE

Kjo shprehje përshkruan aktivitetet ose shërbimet që ofrohen pa marrë parasysh gjininë e pjesëmarrësve. Prandaj, verbëria gjinore në një kontekst negativ nënkupton ndër të tjera se një person, politikant ose institucionet nuk marrin në konsideratë dhe injorojnë çështjet gjinore dhe barazinë si një përcaktues themelor gjatë hartimit të politikave, programeve dhe projekteve të ndryshme.

NDARJA E PUNËS SIPAS GJINISË

Kjo nënkupton shembuj shoqërorë (modele) ku një sërë rolesh gjinore janë caktuar për gratë dhe një sërë tjerash për burrat. Ndarja e pabarabartë e punës gjithashtu i referohet shpërblimit të pabarabartë për punë. Diskriminimi ndaj grave në këtë kuptim në disa vende nënkupton që gratë mbajnë ngarkesën e punës së papaguar dhe burrat marrin pjesën më të madhe të të ardhurave dhe shpërblimeve si rezultat i punës së tyre. Në disa shoqëri, kjo shpjegohet me shembuj klasikë të ndarjes së punës në baza gjinore, ku gratë në shumicën e rasteve bëjnë punë shtëpiake të papaguar dhe punë të papaguar në bujqësi, hortikulturë dhe blegtori dhe burrat në shumicën e rasteve përfitojnë dhe kontrollojnë fitimin financiar nga shitja e këtyre produkteve.

BARAZIA GJINORE

Nënkupton që gratë dhe burrat kanë kushte të barabarta për realizimin e të drejtave të tyre të plota të njeriut dhe për kontribuimin dhe përfitimin nga zhvillimi ekonomik, social, kulturor dhe politik. Prandaj, barazia gjinore është vlerësimi i barabartë i ngjashmërive dhe dallimeve midis burrave dhe grave, dhe roleve që ata luajnë. Ajo bazohet në gratë dhe burrat si partnerë të plotë në shtëpi, në komunitetin dhe në shoqërinë e tyre.

EKUITETI GJINOR

Nënkupton procesin e të qenit të drejtë ndaj burrave dhe grave. Për të siguruar drejtësi, shpesh duhet të krijohen masa për të kompensuar mangësitë historike dhe sociale që pengojnë gratë dhe burrat të veprojnë në një fushë të barabartë të lojës. Ekuiteti është mjeti. Barazia është rezultati.

DISKRIMINIMI GJINOR

Nënkupton trajtimin e ndryshëm të individëve bazuar në gjininë e tyre. Diskriminimi gjinor, i njohur edhe si diskriminim në bazë të seksit ndodh edhe në rastet kur një personi i mohohet e drejta për punë, avancim ose privohen nga mundësitë për përfitime të tjera vetëm për shkak se i përkasin seksit tjetër. Ky lloj diskriminimi mund të ndikojë në mënyrë të barabartë si burrat ashtu edhe gratë.

NDËRGJEGJËSIMI GJINOR

Nënkupton aftësinë për të njohur dhe identifikuar problemet që dalin si rezultat i pabarazisë dhe diskriminimit, edhe kur ato janë të fshehura dhe nuk janë në sipërfaqe, që nënkupton se problemi në shikim të parë nuk është i dukshëm. Me fjalë të tjera, ndërgjegjësimi gjinor nënkupton një nivel më të lartë dhe më të sofistikuar të ndërgjegjësimit gjinor.

FUQIZIMI

Kjo në veçanti nënkupton veprimet e përbashkëta të grupeve në pozita të pafavorshme ose të marginalizuara, me qëllim të tejkalimit të pabarazisë strukturore, e cila ishte shkak i pozitës së pafavorshme të këtyre grupeve.

MUNDËSITË E BARABARTA

Nënkupton që secili person ka mundësi të barabarta, veçanërisht në qasjen e barabartë. Me fjalë të tjera, mundësitë e barabarta nënkuptojnë mungesën e diskriminimit të strukturuar që pengon grupin individual ose social të jenë të barabartë në shoqëri. Mundësitë e barabarta për gratë nënkuptojnë çrrënjosjen e çdo forme të diskriminimit gjinor.

ANALIZAT GJINORE

Këto janë metodat sistematike që përdoren në planifikimin e politikave për të siguruar që çështjet gjinore janë pjesë e këtij planifikimi. Qëllimi i analizave gjinore është më i gjerë se koncepti i mundësive të barabarta i cili synon të rrisë numrin e grave pjesëmarrëse në zonat ku ato janë më pak të përfaqësuara. Analizat gjinore synojnë të fokusohen në mënyrat në të cilat duhet të hartohen politikat e integritetit gjinor. Analizat gjinore janë vendimtare për hartimin efektiv të treguesve gjinorë. Analizat gjinore ndihmojnë në strukturimin e politikave kyçe lidhur me rolin e burrave dhe grave si dhe marrëdhëniet midis tyre.

KONVENTA PËR ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT NDAJ GRAVE

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave u miratua në vitin 1979 dhe është konventa ndërkombëtare më e detajuar sa i përket të drejtave të grave. CEDAW parasheh të drejtat e grave të cilat në të kaluarën konsideroheshin si çështje private që i përkasin familjes. CEDAW i referohet veçanërisht mbrojtjes së të drejtave të grave për riprodhim dhe të drejtave specifike të grave në zonat rurale.

DEKLARATA E PEKINIT DHE PLATFORMA PËR VEPRIM

Konferenca që hapi rrugën për integrimin e çështjeve gjinore në bashkëpunimin për zhvillim e njohur si GAD u mbajt në vitin 1995 në Pekin. Më pas shumë vende filluan të hartojnë planet e tyre kombëtare të veprimit, të cilat parashihnin hartimin e strategjive dhe programeve për zbatimin e zotimeve të Konferencës së Pekinit.

DEKLARATA E MIJËVJEÇARIT – OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË MIJËVJEÇARIT

Deklarata që u përqendrua në tetë qëllime zhvillimore u hartua në Samitin e Liderëve Botërorë që u mbajt në vitin 2000 në OKB në Nju Jork. Këto qëllime janë çrrënjësia e varfërisë, arsimi fillor universal, promovimi i barazisë dhe fuqizimit të grave, ulja e vdekshmërisë së foshnjave, përmirësimi i shëndetit të nënave, luftimi i HIV/AIDS, malarisë dhe sëmundjeve të tjera, sigurimi i qëndrueshmërisë mjedisore dhe zhvillimi i partneritetit global për tregti dhe asistencë. Këto angazhime janë dëshmi e lidhjes së ngushtë dhe të ndërvarur midis rritjes ekonomike, zbutjes së varfërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm dhe të njëjtat parashihen të arrihen deri në vitin 2015. Këto angazhime kërkojnë që zhvillimi të bazohet në qeverisje të mirë, transparente dhe demokratike, sundim të ligjit dhe respektim të të drejtave të njeriut.

1. Çrrënjësia e varfërisë
2. Arsimi fillor universal
3. Promovimi i barazisë dhe fuqizimit të grave
4. Ulja e vdekshmërisë së foshnjave
5. Përmirësimi i shëndetit të nënave

6. Luftimi i HIV/AIDS, malaries dhe sëmundjeve të tjera
7. Sigurimi i qëndrueshmërisë mjedisore
8. Zhvillimi i partneritetit global për tregti dhe asistencë

KORNIZA ZBATUESE E UNESCO PËR INTEGRIM GJINOR, PËRKUFIZIMET BAZË TË KONCEPTVE DHE TERMAVE KYÇ TË MARRA NGA

<http://www.unesco.org/new/fileadmin/MULTIMEDIA/HQ/BSG/GENDER/PDF/1.%20Baseline%20Definitions%20of%20key%20gender-related%20concepts.pdf>

SHTOJCA 2 – PËRMBLEDHJE E LIGJEVE DHE POLITIKAVE TË KOSOVËS MBI GJININË

Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008, neni 7 [Vlerat] thotë

“Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.”⁹⁵

Ligji për Barazinë Gjinore 2015⁹⁶ neni 21 thotë

1. Në shkollë dhe institucione të tjera arsimore mjetet mësimore të përdorura duhet të bazohen në barazinë gjinore dhe edukimin për barazinë gjinore duhet përfshirë në kurrikulat shkollore në të gjitha nivelet.
2. Përgatitja, miratimi dhe zbatimi i programit arsimor – edukativ, hartimit të materialeve, teksteve shkollore dhe rishikimit të materialeve dhe teksteve ekzistuese duhet të bëhet me përfshirjen e perspektivës gjinore dhe eliminimin e stereotipeve negative, paragjyqimeve, praktikave zakonore dhe praktikave tjera, që janë në kundërshtim me parimin e barazisë gjinore.
3. Përfshirja në programet e shkollave aktivitete edukative dhe trajnuese që synojnë sensibilizimin e të rinjve për barazinë gjinore dhe përgatitjen e tyre për qytetari demokratike.
4. Të ketë përfshirje të barabartë të femrave dhe meshkujve në trajnime të arsimit profesional dhe joprofesional dhe këshillimit për ato profesione të cilat konsiderohen tradicionalisht vetëm për femra dhe vetëm për meshkuj.

Ligji për Arsimin Parauniversitar⁹⁷

Neni 1 Qëllimi

Neni 4 paragrafi 2.5. përgatitja e nxënësit për jetesë të përgjegjshme në frymën e mirëkuptimit, të paqes, tolerancës, barazisë gjinore dhe në miqësi me pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës, e më gjerë;

Neni 3 Parimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar

4. Gjatë planifikimit, menaxhimit dhe zbatimit të sistemit të arsimit parauniversitar, Ministria, komunat, si dhe institucionet arsimore dhe ato aftësuese do të marrin parasysh normat e miratuara ndërkombëtare për arsimin për të gjithë, të drejtat e fëmijëve, mbrojtjen e grupeve të ndjeshme në shoqëri dhe për avancimin e barazisë gjinore.

Neni 4 Mbrojtja e grupeve të cënueshme

3. Ndalohen aktivitetet promovuese jashtë Kornizës së Kurrikulumit të Kosovës në përfitim ose në dëm të çfarëdo partie politike, gjinie, përkatësie racore a etnike, feje ose pozite sociale nëpër institucionet arsimore dhe aftësuese. Kur çështjet relevante paraqiten para nxënësve gjatë procesit mësimor, nxënësve duhet t’u ofrohet prezantim i balancuar i pikëpamjeve të kundërta.

Ligji për Botimin e Teksteve Shkollore, Mjeteve Mësimore, Lektyrës Shkollore dhe të Dokumentacionit Pedagogjik

Neni 3 Kërkesat që duhet t’i përmbushin tekstet shkollore, mjetet mësimore, lektyra shkollore dhe dokumentacioni pedagogjik,

3.2. Nuk lejohen tekstet shkollore, mjetet mësimore, lektyrat shkollore dhe dokumentacioni pedagogjik⁹⁸ që bëjnë propagandë kundër Kosovës, që cenojnë të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore dhe që nxisin urrejtje politike, nacionale dhe fetare.

⁹⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008 marrë nga <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>

⁹⁶ Ligji nr. 05/L-20 për Barazinë Gjinore, marrë nga <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/05-L-020%20a.pdf>

⁹⁷ Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, marrë nga <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Laë%20on%20preuniversity%20education.pdf>

⁹⁸ Ligji nr. 02/L-67 për Botimin e Teksteve Shkollore, Mjeteve Mësimore, Lektyrës Shkollore dhe të Dokumentacionit Pedagogjik, marrë nga <https://masht-rks-gov.net/uploads/2015/06/01-ligjim-1.pdf>

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021⁹⁹ objektivi kryesor strategjik.

1. Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja

“Arsimi, përveç tjerash, është mjet për parandalimin e varfërisë, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, për fuqizimin e femrës dhe për integrimin e secilit në shoqëri. Sipas UNESCO, arsimi gjithëpërfshirës shihet si proces që adreson dhe i përgjigjet nevojave të ndryshme të të gjithë nxënësve, përmes rritjes së pjesëmarrjes në të nxënë duke reduktuar përjashtimin në arsim dhe nga arsimi.

Arsimi gjithëpërfshirës ofron mjedis mësimor që mundëson qasje, akomodim dhe mbështetje për të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë që shkollat duhen përshtatur për të gjithë fëmijët, pavarësisht gjendjes së tyre fizike, intelektuale, sociale, emocionale, gjuhësore ose faktorëve të tjerë. Gjithëpërfshirja ka për synim minimizimin e pabarazive në shoqëri, luftimin e diskriminimit, shmangien e marginalizimit dhe të përjashtimit, si dhe sigurimin e mirëqenies për të gjithë pjesëtarët e shoqërisë. Prandaj, është e domosdoshme të zbatohen politika dhe praktika arsimore që synojnë procese gjithëpërfshirëse, në veçanti në raport me grupet shoqërore të marginalizuara, siç janë personat me nevoja të veçanta arsimore, komunitetet pakicë, të varfrit, si dhe disa kategori të tjera shoqërore.”¹⁰⁰

Standardet për tekstet shkollore¹⁰¹

Standardi 11

Teksti shkollos të kontribuojë në edukimin për barazinë e gjinive dhe në shmangien e diskriminimit lidhur me gjininë, si dhe të roleve gjinore. Në mënyrë të drejtpërdrejtë, kjo ndihmesë mund të jepet nga tekstet shkollore të disa lëndëve (libra leximi, tekste shkollore të etikës, historisë, të shkencave shoqërore) nëpërmjet zgjedhjes së përshatshme të shkrimeve, pyetjeve dhe detyrave. Në mënyrë të tërthortë, të gjitha tekstet shkollore mund dhe duhet ta plotësojnë këtë standard duke u kujdesur a) që nga ana gjuhësore të respektohen të dy gjinitë (përdorimi i trajtave femërore dhe mashkullore; p.sh. nxënës/e) dhe b) që në tekstet, ilustrimet, detyrat etj. femra dhe meshkuj të jenë përfaqësuar në mënyrë të barabartë dhe jo të mos jenë stereotipe sipas roleve tradicionale.

TREGUESIT

11.1 Gjuha e tekstit shkollos është adekuate për të dy gjinitë, duke u drejtuar të dyjave (përdorim i trajtave mashkullore dhe femërore p.sh. në udhëzime, detyra etj.).

11.2 Në tekstet e njësive mësimore, ilustrimet, detyrat, pyetjet etj., meshkujt dhe femrat janë përfaqësuar në mënyrë të barabartë dhe po aq të shpeshtë, kur e lejon natyra e temës.

11.3 Në tekstet e njësive mësimore dhe në detyrat, ushtrimet dhe pyetjet, teksti shkollos u referohet në mënyrë të barabartë dhe po aq të shpeshtë përvojave dhe interesave të femrave sa atyre të meshkujve.

11.4 Teksti shkollos u shmang stereotipeve gjinore në lidhje me ndarjen e roleve, si dhe pamjeve të njëanshme, duke treguar dhe duke paraqitur femra dhe meshkuj në aktivitete dhe kontekste të ndryshme e jo të klasifikuara.

11.5 Të dy sekset portretizohen, pasqyrohen dhe kanë role në mënyrë të barabartë si në jetën private (në familje), ashtu edhe në të gjitha sferat e jetës shoqërore (në sferë publike, në kontekst historik etj.).

11.6 Përdorimi i gjuhës është i drejtë dhe i barabartë për të dy gjinitë, sidomos kur përdoret forma femërore dhe mashkullore në emërtimin e personave.

⁹⁹ Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë Plan 2017-2021 2016, marrë nga <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/201>

¹⁰⁰ Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë Plan 2017-2021 2016, marrë nga <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/201>

SHTOJCA 3 - NDRYSHIMET NË SISTEMIN E ARSIMIT ME POLITIKËN E RE TË KURRIKULËS

Korniza e Kurrikulës për Arsimin Para-universitar në Republikën e Kosovës

SYNON KOMPETENCAT DHE PARIMET	Qëllimi i arsimit parauniversitar		Zhvillimi i identitetit personal dhe kombëtar, shtetësisë dhe përkatësisë kulturore		Promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare		Zhvillimi i përgjegjësisë për veten, për të tjerët, për shoqërinë dhe për mjedisin		Përgatitja për jetë dhe punë në kontekste të ndryshme shoqërore dhe kulturore		Zhvillimi i sipërmarrësisë dhe përdorimi i aftësive të teknologjisë		Përgatitja për të nxënit gjatë gjithë jetës									
	Kompetencat e nxënësve		Komunikues efektiv		Mendimtar kreativ		Nxënës i suksesshëm		Kontribues produktiv		Individ i shëndetshëm		Qytetar i përgjegjshëm									
	Parimet e kurrikulës		Përfshirja		Zhvillimi i kompetencave		Mësimdhënie dhe të nxënit koherent dhe i integruar		Autonomia dhe fleksibiliteti në nivel shkollor		Përgjegjësia dhe llogaridhënia											
ZBATIM NË SHKOLLË	Fushat e kurrikulës		Gjuha dhe komunikimi		Artet		Matematika		Shkencat natyrore		Shoqëria dhe mjedisi		Shëndeti dhe mirëqenia		Jeta dhe puna							
	Mësimdhënia dhe të nxënit		Qasjet e ndryshme në klasë		Bazuar në njohuritë praktike		Klasat gjithëpërfshirëse		Lidhjet midis teorisë dhe praktikës		Pjesëmarrja aktive		Me nxënësin në qendër		Përdorimi i teknologjive të reja							
	Çështjet ndër-kurrikulare		Edukimi Demokratik Shtet		Edukimi për paqen		Edukimi i globalizimit dhe ndërvlerësimit			Edukimi i medias			Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm për arsimin									
VLERËSIMI	Vlerësimi i arritjeve		I integruar në mësimdhënie dhe të nxënit		Së bashku me nxënësit		Përdor të dhëna nga burime të ndryshme		I përditshëm, i rastësishëm, në fund të një teme/njësie		Promovon kurrikulë të gjerë dhe të balancuar		Kuptohet nga nxënësit		Ndihmon përparimin e nxënësve		Ofron informata kthyesë		Ndihmon për të identifikuar fushat për ndërhyrje		Ofron vlerësim të ndërsjellë dhe vetëvlerësim	
	Masat për llogaridhënien			Arritjet			Sjellja			Pjesëmarrja qytetare			Kujdesi shëndetësor			Punësueshmëria			Përfshirja në arsimin e mëtejshëm			
	Masat për llogaridhënien				Vlerësimi i brendshëm			Vlerësimi në nivel klasor			Vlerësimi në nivel shkollor			Vlerësimi i jashtëm			Provimi i maturës					

SHTOJCA 4 – LËNDËT DHE FUSHAT E TË NXËNIT TË KURRIKULËS SIPAS KLASËVE

Fushat e të nxënit	Fushat e të nxënit nëpër fazat kryesore (FK) të kurrikulës								
	Parashkollor	FK1	FK2	FK3	FK4	FK5		FK6	
Fushat e kurrikulës	Grup moshat: 0-3 vjeç 4-5 vjeç	Klasat: Para-fillor 1-2	Klasat 3, 4 dhe 5	Klasat 6 dhe 7	Klasat 8 dhe 9	Klasat 10 dhe 11 (Arsimi i përgjithshëm)	Klasat 10 dhe 12 (Arsimi dhe aftësimi profesional - AAP)	Klasa 12 (Arsimi i përgjithshëm)	Klasa 12 (Arsimi dhe aftësimi profesional - AAP)
Gjuha dhe komunikimi	Aktivitete që nxisin komunikimin gjuhësor	Gjuha amtare Gjuha angleze	Gjuha amtare Gjuha angleze Gjuha e dytë	Gjuha amtare Gjuha angleze Gjuha e dytë	Gjuha amtare Gjuha angleze Gjuha e dytë	Gjuha amtare Gjuha angleze Gjuha e dytë Gjuhët e tjera	Gjuha amtare Gjuha angleze Gjuhët e tjera	Gjuha amtare Gjuha angleze Gjuha e dytë Gjuhët e tjera	Gjuha amtare Gjuha angleze Gjuhët e tjera
Artet	Aktivitete që nxisin aftësitë e komunikimit dhe shprehjen artistike	Arti figurative Edukata muzikore	Arti figurative Edukata muzikore	Arti figurative Edukata muzikore	Arti figurative Edukata muzikore	Arti figurative Edukata muzikore	Artet aplikative	Arti figurative Edukata muzikore	Artet aplikative
Matematika	Aktivitetet që nxisin aftësitë e arsytimit dhe të numërimit	Matematika	Matematika	Matematika	Matematika	Matematika	Matematika	Matematika	Matematika
Shkencat natyrore	Aktivitetet që nxisin hulumtimin dhe zbulimin e mjedisit	Shkencat natyrore	Shkencat natyrore	Shkencat natyrore	Shkencat natyrore	Biologjia Fizika Kimia Astronomia	Shkencat natyrore	Biologjia Fizika Astronomia	Shkencat natyrore
Shoqëria dhe mjedisi	Aktivitetet që nxisin vetëdijësimin, ndërgjegjësimin e të tjerëve dhe aftësitë sociale	Shoqëria dhe mjedisi	Shoqëria dhe mjedisi	Shoqëria dhe mjedisi	Shoqëria dhe mjedisi	Histori Gjeografi Edukata qytetare Sociologji Psikologji Filozofi	Shoqëria dhe mjedisi	Histori Gjeografi Edukata qytetare Sociologji Psikologji Filozofi	Shoqëria dhe mjedisi
Edukata fizike, sportet dhe shëndeti	Aktivitetet që nxisin zhvillimin e shprehive të	Shëndeti dhe mirëqenia Edukata fizike	Shëndeti dhe mirëqenia Edukata fizike	Shëndeti dhe mirëqenia Edukata fizike	Shëndeti dhe mirëqenia Edukata fizike	Shëndeti dhe mirëqenia Edukata fizike	Shëndeti dhe mirëqenia Edukata fizike	Shëndeti dhe mirëqenia Edukata fizike	Shëndeti dhe mirëqenia Edukata fizike

	higjienës dhe aftësi fizike								
Jeta dhe puna	Aktivitetet që nxisin kapacitetet për të kuptuar dhe ndjekur procedurat dhe rregullat, kuriozitetin, kreativitetin dhe të nxënit në mënyra të ndryshme	Jeta dhe puna	Jeta dhe puna	Jeta dhe puna	Jeta dhe puna	Jeta dhe puna	Jeta dhe puna	Jeta dhe puna	Jeta dhe puna

BIBLIOGRAFIA

Basturkmen, H. (2010). *Developing Courses in English for Specific Purposes (Zhvillimi i kurseve në gjuhën angleze për qëllime të veçanta)*. New York: Palgrave Macmillan

Blumberg R.L. (2007). Gender bias in textbooks: A hidden obstacle on the road to gender equality in education (Paragjykimet gjinore në tekste shkollore: Një pengesë e fshehur në rrugën drejtë barazisë gjinore në arsim). UNESCO, Paris. Marrë nga <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000155509>

Blumberg, R. L. (2007). "Gender Bias in Textbooks: A hidden obstacle on the road to gender equality in education (Paragjykimet gjinore në tekstet shkollore: Një pengesë e fshehur në rrugën drejtë barazisë gjinore në arsim)". UNESCO, Geneva EFA-GMR. quoted on Hanoi et al., (2010) *Guidelines for Textbook Reviews and Analysis from a Gender Perspective (Udhëzime për shqyrtime dhe analiza të teksteve shkollore nga perspektiva gjinore)*, UNESCO, Geneva. Marrë nga <https://docs.iiep.unesco.org/peic/2748.pdf>

Boissiere, M.X. (2004/01/01). Determinants of primary education outcomes in developing countries (Përcaktuesit e rezultateve të arsimit fillor në vendet në zhvillim). Marrë nga: <http://documents.worldbank.org/curated/en/111011468162550538/Determinants-of-primary-education-outcomes-in-developing-countries>

Bruning, Roger H.; Schraw, Gregory J.; Ronning, Royce R. (1999). *Cognitive Psychology and Instruction* (3rd ed.) (Psikologjia kognitive dhe udhëzime (edicioni i 3). Prentice-Hall, Inc. ISBN 978-0-13-716606-0 – as cited in Committee on Developments in the Science of Learning (2000) *How People Learn: Brain, Mind, Experience and School: Expanded Edition (Si mësojnë njerëzit: Truri, Mendja, Përvoja dhe Shkolla: Edicion i zgjeruar)*. Marrë nga shtypi i akademisë kombëtare: <http://www.nap.edu/catalog/9853.html>

Brugeilles, C., & Cromer, S. (2009) Promoting Gender Equality Through Textbooks, A Methodological Guide (Promovimi i barazisë gjinore përmes teksteve shkollore, një udhëzues metodologjik), UNESCO, Paris. Marrë nga https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000158897_eng

Brusokaite, E. (2013) Gender Representation in EFL Books (Përfaqësimi gjinor në librat e EFL). MA Paper. Marrë nga gs.elaba.lt/object/elaba:1868784/1868784.pdf

Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women (Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundrejt grave) (2003) UN WOMEN. Marrë nga <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/text/econvention.htm#article10>

Convention on the Rights of the Child (Konventa për të drejtat e fëmijëve) (1989). Marrë nga <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.asp>

Constitution of the Republic of Kosovo (Kushtetuta e Republikës së Kosovës) 2008. Marrë nga <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>

Curriculum Framework of the Pre-University Education of the Republic of Kosova (Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Kosovës) (2011) Marrë nga <https://masht.rks-gov.net/korniza-e-kurrikules-e-arsimit-parauniversitar>

Dakar Framework for Action (Korniza e Dakar për Veprim) (2000) UNESDOC, UNESCO. Marrë nga <http://unesdoc.unesco.org/images/0012/001211/121147e.pdf>

Fehrler, S., Michaelowa, K., Wechtler, A. (2009). The Effectiveness of Inputs in Primary Education: Insights from Recent Student Surveys for Sub-Saharan Africa. *Journal of Development, Volume 45/9*. (Efektshmëria e Inputeve në Arsimin Fillor: Vështrime nga Studimet e Fundit të Studentëve për Afrikën Sub Sahariane. Gazeta e Zhvillimit, Vëllimi 45/9) <http://www.informaworld.com/smpp/pwreset?id=916960109&dt=4013467207843&ck=45D4B817970C96B072AD8BDBB7DD5A10>

Fourth World Conference on Women in Beijing (Konferenca e katërt botërore për gratë në Pekin) (1995) Marrë nga <http://www.un.org/womenwatch/daw/daw/index.html>

Gak, DM (2011). Textbook – An Important Element in the Teaching Process. *НАСТАВА СТРАНИХ ЈЕЗИКА, Novi Sad*. Marrë nga <https://www.epub.ff.uns.ac.rs/index.php/MV/article/download/771/781>

Georgescu D. et al (2010) Guidelines for Textbook Reviews and Analysis from a Gender Perspective. (Udhëzime për shqyrtimin dhe analizimin e teksteve shkollë nga një perspektivë gjinore) UNESCO Hanoi, IBE and MOET, Geneva. Marrë nga <https://docs.iiep.unesco.org/peic/2748.pdf>

Georgia Department of Education (1996) Gender Biased Language (Gjuha e paragjytimeve gjinore). Marrë nga <http://academics.smcvt.edu/writingctr/gender%20bias.htm>

Graves, K. (2000). *Designing Language Course, A Guide for Teachers (Dizajnimi i kurseve të gjuhës, udhëzues për mësuesin)*. Boston. Heinle. Cengage Learning.

Gharbavi, A. (2012, March). The Application of Functional Linguistics in Exposing Gender Bias in Iranian High School English Textbooks (Aplikimi i gjuhësisë funksionale në ekspozimin e paragjytimeve gjinore në tekstet e shkollës së mesme iraniane). *English Language and Literature Studies*, 2(9), 85-93.

Giaschi, P. (2000). *Gender Positioning in Education: A Critical Image Analysis of ESL Texts (Pozicioni gjinor në arsim: Një analizë kritike e fotografive në tekstet e ESL)*. Marrë nga ERIC database (EJ616535)

Hartman, P., & Judd, E. (1978, December). Sexism and TESOL Materials (Seksizmi dhe materialet e TESOL). *TESOL Quarterly*, 12(4), 383-393. Marrë nga http://203.72.145.166/teso/|TQD_2008/VOL_12_4.PDF#page=17

Halimi, S. et al (2007) Gender Audit of the Education System, Kosovo Center for Gender Studies (Auditimi Gjinor i Sistemit të Arsimit, Qendra Kosovare për Studime Gjinore). Marrë nga <http://www.kgscenter.net/site/assets/files/1466/auditimiiceshtjevegjinorenesisteminarsimor.pdf>

Hameed, A. (2014). Language and Gender: An Analysis of English Textbooks Produced by Punjab Textbook Board for Elementary Level in Pakistan (Gjuha dhe Gjinia: Një analizë e teksteve Angleze të prodhuara nga bordi i teksteve shkollë të Punjabit për nivelin fillor në Pakistan). *Journal of Education and Practice*, 5(11). Marrë nga iiste.org/Journals/index.php/JEP/article/download/12380/12695

Hussain, M. N., & Afsar, A. (2010). Language and Gender: Linguistic Analysis of Intermediate English Textbooks in Pakistan. *Language in India*, 10, 26-36. Marrë nga <http://www.languageinindia.com/nov2010/gendertextbookpakistan.pdf>

Hussain, N. & Mattu, A. (2003) Gender Bias and Stereotypes in School Texts (Paragjykimet dhe stereotipet gjinore në tekstet shkollë). The Subtle Subversion—The State of Curricula and Textbooks in Pakistan (Gjendja e kurrikulës dhe teksteve shkollë në Pakistan). Marrë nga www.sdpi.org.

Hyseni, H. et al (2007). Gender equality in the reading textbooks during the nine years of compulsory education in Kosovo. Kosova Education Center (Barazia gjinore në tekstet shkollë gjatë nëntë viteve të arsimit të detyrueshëm në Kosovë. Qendra për Arsim e Kosovës). Marrë nga

<http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2016/03/Gender-equality-in-the-reading-textbooks-during-the-nine-years-of-compulsory-education-in-Kosovo-1.pdf>

Kosovo Education Strategic Plan (Plani strategjik i arsimit në Kosovë) 2017-2021 (2016) Marrë nga <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-kesp-2017-2021.pdf>

Ligji nr. 05/L-20 për Barazinë Gjinor, Marrë nga <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/05-L-020%20a.pdf>

Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (2011), Marrë nga <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20preuniversity%20education.pdf>

Mani, A. Gender Bias in School Textbooks (Paragjykimet gjinore në tekstet shkollore). (1995). Marrë nga <https://doi.org/10.14217/9781848595484-EN>

Malmsjö, B.K. & Joahansson, S. (2009) Gender Bias in EFL Textbook Dialogues (Paragjykimet gjinore në dialogun e teksteve shkollore të EFL). Malmö Högskola. Marrë nga <http://muep.mau.se/handle/2043/8217>

Mustedanagic, A. (2010). *Gender in English Language and EFL Textbooks (Gjinia në tekstet shkollore të gjuhës angleze dhe të EFL) lib.* (Bachelor dissertation). Marrë nga <http://www.diva-portal.org/>

Millennium Development Goals (Qëllimet e zhvillimit të mijëvjeçarit) (2000) WHO. Marrë nga http://www.who.int/topics/millennium_development_goals/about/en/

Meyer-Bisch, P. (1995) Culture of Democracy, A Challenge for Schools (Kultura e demokracisë, një sfidë për shkollat). UNESCO, Paris. Marrë nga <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000099812>

Menegati, M. & Rubini, M. (2017) Gender Bias and Sexism in Language (Paragjykimet gjinore dhe seksizmi në Gjuhë). Oxford Research Encyclopedia. Marrë nga <http://communication.oxfordre.com/view/10.1093/acrefore/9780190228613.001.0001/acrefore-9780190228613-e-470>

Michel, A. (1986) Down With Stereotypes. Eliminating Sexism from Children's literature and School Textbooks (Poshtë stereotipet. Eliminimi i seksizmit nga literatura e fëmijëve dhe tekstet shkollore). UNESCO, Paris. Marrë nga <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000070590>

Pingel, F., (2010) Guidebook on Textbook Research and Textbook Revision (Udhëzues për hulumtimin dhe shqyrtimin e teksteve shkollore). 2nd and Revised Edition. UNESCO, Paris. Marrë nga <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000117188.pdf>

Porreca, K.L., (1984). Sexism in current ESL textbooks (Seksizmi në tekstet shkollore aktuale të ESL). TESOL Quarterly, 18(4), 705-724.

Porta, E. and Laguna, J.R. (2007). Monitoring Education for All in Guatemala. Country Profile (Monitorimi i arsimit për të gjithë në Guatemalë, Profili i vendit). *Education for All Global Monitoring Report 2008. Education for All by 2015: will we make it?* (Arsimi për të gjithë Raportin e Monitorimit Global 2008. Arsimi për të gjithë deri në vitin 2015: a do ta bëjmë?) Marrë nga <http://unesdoc.unesco.org/images/0015/001555/155575e.pdf>

Reddy, V., Zuze, T.L., Visser, M., Winnaar, L., Juan, A., Prinsloo, CH., Arends, F., Rogers, S. (2015). Beyond the Benchmarks: What Twenty years of TIMSS data tell us about South African education? (Përtej standardeve: Çfarë na tregojnë rreth 20 vjet të të dhënave të TIMSS për arsimin në Afrikën e Jugut?) *Human Sciences Research Council. National Report*. Marrë nga http://pub.iaea.nl/fileadmin/user_upload/Publications/National_reports/TIMSS_2011_report_SouthAfrica.pdf

SACMEQ (2011, September) Quality of Primary School Inputs in Swaziland (Cilësia e inputit të shkollës fillore në Zvicër). *Policy Paper Nr.2*. Marrë nga http://www.sacmeq.org/sites/default/files/sacmeq/reports/sacmeq-iii/policy-brief/swa_school_inputs_15oct2011_final.pdf

Slade, S. (2016). *What Do We Mean by a Quality Education?*(Çfarë nënkuptojmë me arsim cilësor) Marrë nga https://www.huffingtonpost.com/sean-slade/what-do-we-mean-by-a-qual_b_9284130.html

Srivastava, G. (2012). *Gender and Peace in Textbooks and Schooling Processes; The Maldivian Experience (Gjinia dhe paqja në tekstet shkollë dhe në proceset shkollë)*. New Delhi. Concept Publishing Company. Marrë nga https://books.google.com/books?id=19xfkgfuapAC&pg=PA22&dq=textbooks+as+main+vehicle+of+gender+values&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEwiCzsnop-_eAhVEp4sKHcm5AKAQ6AEITjAH#v=onepage&q=textbooks%20as%20main%20vehicle%20of%20gender%20values&f=false

Sustainable Development Goals (Qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm) (2016) UN. Marrë nga <https://www.un.org/sustainabledevelopment/sustainable-development-goals>

Standardet për Teskte Shkollore (2001) MASHT. Marrë nga <http://masht.rks-gov.net/uploads/201>

Universal Declaration of Human Rights (Deklarata universale e të drejtave të njeriut) (1984) United Nations. Marrë nga <http://www.un.org/en/univUNESCO> (2005). A Comprehensive Strategy for Textbooks and Learning Materials (Strategjia gjithëpërfshirëse për tekstet shkollë dhe materialet e të nxëniet). UNESCO, Paris. Marrë nga <http://unesdoc.unesco.org/9FB996AB-07EB-4976-A187-CBEB1586D8B8/FinalDownload/DownloadId-3661A0B70AF2BDFCBED724081007B56C/9FB996AB-07EB-4976-A187-CBEB1586D8B8/images/0014/001437/143736eb.pdf>

UNESCO (2016). Every Child Should Have a Textbook (Çdo fëmijë duhet të ketë një tekst shkollor). Policy Paper. UNESCO, Paris, France. Marrë nga: <http://unesdoc.unesco.org/images/0024/002433/243321E.pdf>

UNESCO Education and Gender Equality (Arsimi dhe barazia gjinore). Marrë nga <https://en.unesco.org/themes/education-and-gender-equality>

Van Kemenade, E., Pupius, M. & Hardjono, T. W. (2008): More Value to Defining Quality. Quality in Higher Education (Më shumë vlera në përcaktimin e cilësisë. Cilësia në Arsimin e lartë), 14(2), 175-185.

Veriava, F. (2015, November 9). Why textbooks are a crucial part of every child's learning journey? (Përse tekstet shkollë janë pjesë thelbësore e rrugëtimit në të nxëniet e çdo fëmije?) *The Conversation*. Marrë nga: <https://theconversation.com/why-textbooks-are-a-crucial-part-of-every-childs-learning-journey-50252>

World Programme for Human Rights Education (Programi botëror për edukimin rreth të drejtave të njeriut) (2005) UNHCR. Marrë nga <https://www.ohchr.org/en/issues/education/training/pages/programme.aspx>